

INTERVISTË ME VJOSA DOBRUNËN

Prishtinë | Data: 3 dhe 11 korrik 2013

Kohëzgjatja: 267 minuta

Të pranishëm:

1. Vjosa Dobruna (E intervistuar)
2. Mimoza Paçuku (Intervistuesja)
3. Donjetë Berisha (Kamera)
4. Jung Chao (Kamera)

Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i/e intervistuari/a shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje

Mimoza Paçuku: A mundesh me na tregu për fëmijërinë tënde?

Vjosa Dobruna: Mendoj se si çdo fëmijëni kam pasë një fëmijëni relativisht të lumtur. Së paku sa mbaj në mend, besoj që mbaj në mend shumë. Fëmijëninë e kam kalu në Gjakovë ku kam lind edhe ka qenë mjaft e plotë sepse jam rritë në mes dy prindërve të mi të cilët kanë [pasë] punë shumë, dytë kanë punu edhe gjyshit tim me katër axhat edhe hallën, kështu që ka qenë mjaft një fëmijëni e plotësime edhe gjithmonë e kam ndi vetën shumë të dashun shumë të përkdhelun. Mandej kanë ardhë motrat, e me të cilat më është plotësu jeta edhe më shumë, tri motra mas meje, kur jemi bo katra, mandej në fund motra e vogël ka lind unë kom qenë në shkollë të mesme, prandaj ma shumë e ndjej si fëmijë se sa si motër. Ka qenë e plotësime, unë kam qenë fëmiju i parë në familje ku me gjenerata e gjenerata dikur, flitet, s’di a është mit po flitet, që diku kanë qenë njëmbëdhjetë gjenerata që ka pasë një ose dy vajza. Për tri gjeneratat e kalume e di që kanë qenë vetëm një vajzë, e gjenerata e ime unë jom kon e para e lindur në familjen Dobruna vajzë. Kështu që një farë mënyre kam qenë e privilegjume se si kom lind kom lyp plot dashni plot. Katër axhët e mi, halla, gjyshi, gruja e gjyshit, s’ka qenë gjyshja e jeme po gruja e gjyshit, gjithë kanë qenë përreth meje, kështu që edhe pse prindërit e mi, t’dytë kanë punu edhe në atë kohë nëna ime ka punu.

Në atë kohë është punu në dy ndrrime, po mendoj, mama tregon që e ka pas klasën e parë edhe dytë paradite, klasën e tretë dhe katër si mësuese ka punu masdite. Kështu që gjatë, gjatë tanë kohës nuk ka qenë aty, edhe babi qashtu, kështu që ma shumë jam rritë të gjyshi. Edhe bile kur kanë lind motrat e mija prapë kam qenë shumë te gjyshi, edhe më duket se gjyshi im, axhët e mi kanë pasur ndikim ma të madh sesa prindërit e mi n’dua. Kështu që gjithë femijnia ka shku ashtu deri diku në moshën gjashtë vjeçare, gjashtë e gjysë... kur kom shku.

Shka më kujtohet për fëmijëni në atë kohë që ka qenë, që e përshkrun edhe Kosovën shumë, është... kur gjyshi jem, dikun ka qenë prill ‘69 edhe... gjithë e ka pas një fotografi në dhomë... një mashkull, një fotografi të madhe që une nuk e kom ditë kush është. Edhe gjithë thojke, "ky është axha i yt, ky është axha yt". Unë e kqyrsha, "a osht axha i jem, axha i jem". Po thotë, "Ky, ti ke qenë shumë e vogël, ky ka hi në burg... por kur ke lind ti ta ka dhonë emrin Vjosë." OK. Kur një ditë edhe vjen gjyshi edhe po thotë tha "Nesër kemi me shku diku e do të hypim, do të hypim në pajton. E n’pajton do të shkojmë prej Gjakovës në Pejë. E në Pejë do të hypim në tren do të shkojmë në Prishtinë, e në Prishtinë do të

flejme një natë, edhe nesrit do të nisem për Nish¹.” Unë po thom, “Ça ka në Nish?” “Do ta shohësh këtë njeri, axhën!” Edhe shkuam mandej në Prishtinë, hypem në një autobus, dhe shkum n’fillim n’fillim të, para se me hi në Nish, është një vend quhet Deligrad² edhe nga ona e djatht ka pas, ka pas një vend si si të stacionet e autobusave, që është një vend i mbulum. Ana tjetër ka qenë një ndërtesë me mure të nalta edhe him, him mbrena po menoj policia me mu na kontrolloi krejt edhe him mbrena ku e e pash... stop!

Ai ish aty, na shtin na kontrollun edhe na shtin aty mbrenda, aty edhe dul një njeri mbrapa telave e gjyshi jem e kish pregaditë një kremë. E përgaditke vazhdimisht prej yndyrës së gusave edhe e pytsha gjithmonë “Pse?” tha “Këta punojnë në shkritore të burgosunit, e i çahen dur të.” E po dur të mujsha me ia prekë pi telave edhe kjo ka qenë hera e parë që e kom pa.

Prej asaj dite mandej gjithë e mbaj ndërmend bisedën me gjyshin tem, se nejtëm dytë edhe e pashë, edhe mandej u kthyem me... Në autobus kur u kthyem krejt ishin shqiptarë se komplet njerëzit që ishin për me pa në burg ishin shqiptarë, komplet autobusi, vetëm shoferi ish që flitke serbisht. Edhe gjatë tanë kohës e mbaj në mend atë kohë t’u e pytë gjyshin tem “E pse është ky n’burg?” Ai thojke “Ka punu kundër shtetit.” Unë po thom “Çka ka punu? Ka vjedhë? Ka mbytë dikond?” Thojke “Jo, jo. Ky ka qenë profesor i matematikës dhe ka dashtë që fëmijët në shkollë të flasin shqip edhe ky të ligjëron shqip në shkollë. Ani jonë bo bashkë me disa shokë edhe kanë kërku.” “Po pse është e ndalume me fol shqip? Na flasim shqip!” “Po, na flasim shqip n’shpi, po n’skollë s’kanë guxu.”

Kjo ka qenë hera e parë që kom shku në burgje, në burg të Nishit, mandej kom vazhdu me shku me do ndërprerje të vogla. Diku prej atij viti, viteve ‘60-ta, herën e fundit që kam shku mi pa axhët e mi në burg, se njëri mas tjetrit kanë qenë, ka qenë 16 dhjetori i 1996-it. Kur kom shku herën e fundit kur ka dal axha i tretë prej burgut Sokoli, Sokol Dobruna, do me thonë prej Hydajes, Skenderit, Sokolit dhe Myslymit. Unë i kom vizitu burgjet, në shtunën e tretë të mujit prej viteve ‘60 deri me 16 Dhjetor 1996, diku 30 vjet. Edhe, po nuk i vizitojshe vetëm axhat, mandej mbas një kohe kur veq u rrita i vizitojshe edhe ... po mendoj, i përcjellsha ose i vozitsha anëtarët e familjes të burgosurve tjerë politikë. Shkojshe edhe kështu që kom shumë për ato vjet, shumë anekdota, shumë gjana. Njëherë, njëherë shkum në vitetet e ‘80-ta, shkum në në Leskovc³ edhe burgu ka qenë rruga Car Dushanit No. 1. Edhe të gjithë të burgosurit ishin.... s’pranojshe mo me fol serbisht me anëtarët e familjes, se kur shkojshe në burg me i pa ata u dushke me fol serbisht, jo shqip. Edhe ata i kishin vnu do kasetofona në dy anët e telave që me fol shqip e këta kishin... s’dojshe, s’pranojshe me fol serbisht. Edhe isha unë me... isha shku afër Karaqevës⁴ me marrë një plak që e kish djalin në burg, babën e ni Emin Krasniqit. Ai e kish

¹ Qyteti më i madh në Serbinë Jugore ku njëri prej burgjeve më të mëdha është i vendosur. Të tjerët janë në Pozharevaq dhe Sremskë, Mitrovicë.

² Fshat në komunën e Aleksinacit në Serbi

³ Qytet në Serbinë Jugore.

⁴ Vendbanim në komunën e Kamenicës.

thy komën [këmbën]. Unë shkojsha me marrë plakun çdo herë prej Prishtinës me marrë atje në shpi, edhe me çu në burg.

Edhe kur shkum aty s'na lanë me hi se i kanë thënë atyne "A pranoni me fol serbisht?" Ata i kanë thonë "Jo". Na pytën neve "A pranoni me fol serbisht?", i thamë "Jo!" edhe kur dulëm jashtë i kishim do jogurta edhe qepë të reja se ish maj. I kishim ble, kur dulëm jashtë po i thom "baca Hazir, shumë jom idhnu." Ani, ani bacë çka ki me bo. I thashë "A bon qëto jogurta me i gjujtë prej dritares së burgut". Tha, "Qe bacës edhe keptë e reja". Edhe m'i dha, i kishim pru ka dy jogurta tonve, dy jogurtat në dorë edhe plaki, na himë e kishim parku automobilin para burgut atje para hymjes, edhe m'i dha dy jogurta edhe dy tuba kepë të reja edhe me krejt mllefin t'i kom gjujtë në dritare. U shlirova, edhe keptë e reja edhe jogurtat. Hina në kerr, edhe vazhdum me vozitë mu kthy afër Karaqevës, me kthy bacën Hazir. E plaki shumë ma bojke qefin, sa herë shkojsha me marrë diçka, thojsha "çka të bojmë tash?" "Duhet mllefin Vjosa me e zbrasë bëjmë diçka tjetër," kështu që..... Kom shumë, shumë, shumë tregime,

anekdota për këto vjet të burgut, 30 vjet t'u i vizitu burgjet.

Njëherë kom pas shku kur veç isha mjek, i rrefshin shumë, edhe para, pas fazës që ishin, që u bojshin hetimet. I rrahshin edhe ma vonë, gjithë të burgosurit. Kështu që pata vendosë, s'disha çka me bo: fillova me mbledhë qetësues edhe me i qitë në sheqer. Mi shtyp edhe mi qitë në sheqer. Edhe secili ka pas të drejtë kater kilogramë peshë në mujt, kështu që iu qitsha një kilogram sheqer iu qitsha mjaft qetësues, i shtypsha ose i merrsha kapsulla, i derdhsha edhe iu qitsha në sheqer. Edhe ajo, në muajt i shkojshin teshat e brendshme, një qind paketa duhon edhe pak ushqim që qëndrojke, gurabija, mish të terme e sende edhe një kilogram sheqer. Unë e mbusha sheqerin me qetësues kështu që këta e shpërndajshin mes veti, sa herë t'i thirrshin në... "dhomat speciale" ku i bojshin...ku i torturojshin. E hajshin ka një lugë, dy lugë sheqer.

E niher na kthynë ushqimin se kishin qenë në shtrajk [grevë] të gjithë, edhe u kthyem në Prishtinë. Kur u kthyem në Prishtinë, u ulëm me gruan e një të burgosurit tjetër politik edhe filluam me bo një ambëlsinë të pa zine edhe hiq pa e vretë, tap... atë sheqerin, p'i bojmë, po bojmë shllag, i rregullum krejt. E qita në frizhider për m'u ngri. Erdhën do musafirë, pi iu jep, i ndava në kocka edhe pi iu jap, p'i shërbej. Gjithë, ia nisen, ia nisen m'u çu, s'dishim çka osht' puna. Kur, ma vonë po thrrasin "Vjosa gjithë bre na murr gjumi, çka osht, çka osht ai, çka ndodhi? Na ki qitë diçka." "Qysh ju kom qitë diçka?" "Na ki qitë diçka!" Kur p'i thom, "Oj Teutë," "Ha?" "Ku shkoi sheqeri i paketës që e kthym prej Nishit?" Tha, "Qe qaty!" "Po, po ku qaty?" Se u dufshim m'i shti në kuti të kartonit. Tha që e kom nxjerrë prej kutisë së kartonit! Thash, "Kuku, unë e pasna perdorë sheqer me asi"... gjithë njerëzit i ka marrë gjumi

Ose bojsha gjana të ndryshme. Për shembull, nuk i lejshin me lexu gazeta shqip. E atëhere dilke Zëri, Zëri Javor, kështu që 100 paketa duhonit i shkapërderdhsha krejt edhe secilën i mshtjellsha me një faqe të Zërit. Kështu që i shkojshin Zëri i tri javëve, tash javën dy... tri javëve taman, se një herë në

muajt shkojshim. U bojke tamam tri Zëri, u bojshin 100 paketa edhe shkojshin në Nish në Deligrad. Edhe mandej, edhe masi që tash normal ata gardianët i hjekshin gazetatat, i zbrazshin çdo gja, u jepshin paketat e duhonit edhe gjithë ato letra i gjujshin. Njëri prej të burgosurve t'tjerë shqiptarë shkojke i merrke ato fletët e përgadtitshin e bojshin gazetë, edhe e shpërndajshin n' mes të burgosurve politik, gjithë e lexojshin gazetën. Kam shumë, shumë ndodhi. Tridhjetë vjet, kur të shkojsh një herë në mujt m'i pa në burg.

Kom, kom.... Po qajo ka qenë e para kur kam qenë. Mandej vazhdimisht kanë ndodhë qështu qe. E kom pa jo vetëm pjesë të fëmijënisë, po edhe pjesë të rritunit, po edhe pjesë të edukimit tim politik, sepse edhe bajsha fjalë mandej, i përcjellsha informatat prej një grupi në grup tjetër nëpër burgje të ndryshme edhe pse nuk më lejshin me hi, vetëm këtu me leje special te axha jem, e të tjerët me anë të anëtarëve të familjes të ciliët i vozitsha unë, se zakonisht e mbushja automobilin me top pesë njerëz u bojshim në automobil prej dy familjeve, tri familjeve të ndryshme sa kishim vend edhe shkojshim i vizitojshim të burgosurit.

Praktikisht ka qenë krejt jeta ime që kom shku vazhdimisht me vizitu në burg edhe një farë menyre ka determinu mandej të mendumit tim politik... çështjën e të drejtave të njeriut, të drejtave të Shqiptarëve në ish-Jugosllavi. Vonë dikund viteve.... pasi që jom kthy prej Amerikës kur e kryva shkollën e mesme mësova që ekzistojnë organizata që raportojnë edhe mësova çka është avokimi për të drejtat e njeriut edhe sidomos për të drejtat qytetare. Edhe mandej fillova edhe me i mbledhë të dhanat edhe me i mbledhë dëshmitë e ktyne edhe me komuniku me organizata të ndryshme si *Amnesty International*, ma vonë *Human Right Watch*, me, me Kryqin e Kuq Ndërkombtarë në Zhenevë. Edhe raportojsha edhe në vitet diku... vitet '80, edhe në vitet '90. Mandej veç mo, po mendoj edhe popullata në përgjithësi në Kosovë, edhe shtresa e shkollume filloi me, me kuptu rëndësinë e avokimit edhe komunikimit me jashtë për të drejtat e shqiptarëve në Jugosllavi. Po vitet '70, vitetve '80 me të vërtet gati askush në Kosovë nuk dike që egzistojnë organizata të cilave mujshim me raportu. Raportojsha për çka po ndodhë në Kosovë me të drejtat... jo vetëm në Kosovë, po në gjithë Jugosllavinë.

Gjyshi jem nga baba praktikisht nuk ka punu krejt jetën, ka qenë djal i familjës t'pasun kështu që nuk ka punu. Babi im tregon që një kohë, një kohë janë bartë në Mitrovicë edhe atje ka punu por një kohë shumë të shkurtë edhe jonë kthy. Gjyshja jeme ka qenë grua e re, është martu 15 vjet edhe e ka bo babin tem. E ka lind babin tem 16 vjet dhe ajo ka qenë mjaft gru e pasur, kështu që kanë qenë të dytë në atë kohë që nuk kanë punu, kanë jetu nga pasunia deri në Luftën e Dytë Botnore. Luftën e Dytë Botnore gjyshi jem prapë ka qëndru në shpi, e gjyshja jem ka shku ka luftu. Gjyshja jem ka qenë luftare e në Luftën e Dytë Botnore, luftën nacional-çlirimtare, edhe ka mjaft anekdota për to. Ajo ka qenë shumë grua e bukur, shumë edhe e fuqishme. Shumë. Edhe tregohej që pas luftës e kanë ftu....Shefkijën, edhe një rrugë në Gjakovë deri vonë e ka pasë emnin e saj Shefkije Dobrunës. Edhe e kanë pytë, pas luftes, kanë dashtë me e bo një funksion në Gjakovë. "Jo, s' du, nuk du me bashkpunu me ju!" "Po si?! Ti ki luftu me ne!" "Po, po vetëm unë jom antifashist, nuk jom komunist. E ju

komunistat e keni marrë pushtetin. Nuk ju perkrahi.” Kështu që ka qenë mjaft e fortë. Tregohet që kur, tregohet që edhe kur i ka vdekë nana e saj, ajo e ka përgaditë nanën edhe e ka lënë me një dhomë, se ka qenë darsma e motrës saj. Askujt s’i ka tregu. Ka dalë, është rregullu, ka veshë fustan të mirë të darsmës edhe ka dalë në darsëm. Nanën e vet e ka mshelë në dhomë të vdekun. Ka qenë shumë, tregojnë shumë, shumë, shumë, shumë tregime për të që ka qenë gru shumë e fortë. Shumë e fortë dhe ka qenë shumë e bukur edhe shumë krenare. Shumë krenare.

Do të thotë pas Luftës së Dytë Botnore, kur familjes ia kanë nacionalizu gjithë, çdo gja, edhe tokën edhe senet, edhe s’kanë pas asgja, asgja as me hongër. Edhe tregojnë që e ka mushë, e ka mushë një kosh, ku e kanë lonë zakonisht bukën, me gurë edhe e ka mbulu me një mbulesë të bardhë, që nëse dikush vjen prej kushërive ose dikush, me pa edhe me iu dokë e plotë, edhe nëse e prekë me iu dokë e mbushur, që mos mu marrë vesh që s’ka asgja. Se mandej pas luftës, si ka qenë Kosova, pas Luftës së Dytë Botnore nën ligjin *marcial*... represioni. Shumica e shqiptarve, e bile edhe ata të cilët kanë marrë pjesë në Luftën Nacional Çlirimtare, por të cilët nuk kanë qenë pjesë e Partisë Komuniste, kanë qenë të diskriminim deri në pakufi. Kështu që familje të ndryshme, edhe pse kanë qenë pjesë të lëvizjes Nacional Çlirimtare, janë malltretu dhe janë persekutu si me pas qenë kundër Luftës Nacional Çlirimtare, e një ndër ata ka qenë edhe familja jonë edhepse, edhe gjyshja jeme, edhe babi jem, edhe axha jem i cili ka vdekë ditën e fundit të luftës dhe shkolla fillore në Junik edhe shkolla e mesme deri ne këtë luftë e kanë mbajtur emrin e tij.

Por, prapë se prapë pasi që s’kanë qenë me Partinë Komuniste, ka qenë një farë represioni që është ushtru, sidomos ndaj shqiptarëve në ish-Jugosllavi, e sidomos në Kosovë, sepse në Kosovë është pa si një qendër e një lëvizje për identitet nacional që ka qenë ma i fortë, edhe për shkak të koncentrimit të popullatës ma i madh. Kështu që disa familje të cilat kanë qenë të identifikume si të tilla, kanë jetu nën, praktikisht gjithë femënia dhe rinia ime kanë shku e tillë po menoj e kom përjetu si të tillë, sepse gjithmonë i kom përjetu kontrollat e policisë në shpi kur vishin edhe na çojshin... edhe e maj në mend si fëmi vishin shtratin. Edhe ne kur u bomë, kur u bomë katër motra edhe i kshim dy dhoma po i kishim dhomat me dy shtretër kështu... jo në kate, po të ngrehun njëri me tjetrin, edhe e mbaj në mend kur vike policia, i rrxojke krejt, i nxerrke edhe i hekte dërrasat edhe njëhere ish halla jeme aty edhe ish ai... u thirrke qumlek, ka qenë një pjesë në shpi si oxhak për nxemje. Edhe ata ishin hi me kërkë edhe letrat që i dhezshim për me ndezë atë koftorin që ka qenë me pllaka të keramikës ashtu edhe hishin me kqyre edhe halla jeme veq osht irritu. Na ishim të vegjël, ishim frikësu shumë prej policisë, ajo e murr një orë të madhe edhe pi thotë, “Kqyre se edhe këtu mundet me pas diçka, naj material propagandues.”

Për mu ka qenë njëfar mënyre, janë disa... ma vonë t’u u rritë u bo e vështirë. Se njëherë e kom pa si pjesë normale të jetës, që policia vjen në tre e në katër të natës, të zgjon prej gjumit pse axhat të kanë hi në burgje. Unë nuk isha në shpi të axhës. Ose në vitin ’86 për shembull gjithë fëmijët e Dobrunave i kanë largu prej Universitetit, gjithë. Gurakuqi ka qenë në vit të tretë të arkitekturës, Elbasani në të dytin, Shpendi të tretin, Ilirjana pat fillu mjekësinë me studiu, Valbona ka qenë në ndërtimtari, edhe

gjithë i largun. Për '86-tën po flasim, 1986. Edhe unë isha e para atëherë që e qita shtetin në gjyq, Universitetin e Kosovës atëhere, për mohimin e të drejtave për shkollim. Gjithë këta fëmijë që u largun, nuk i kishin babat e vetë në burgje, po e kishin axhën. Për atë të gjithë i largun prej shkollës, gjithë prej Universitetit. Edhe nuk ishin në vitin e parë po ishin në vite të avancume. Profesorat ishin shqiptarë, nuk ish mbyllë Universiteti ende. Por ashtu ishin frikësu edhe sistemi ish i tillë. Tash nga pak më vjen me vjellë kur i shoh të njëjtët profesora universitarë që dalin e të shesin patriotizëm, do janë edhe në parlament. Ku të dalin.... Unë shkojsha edhe bisedojsha me ta "Po pse i largut fëmijët? Pse i largutë fëmijët prej shkolles? Po ku e largove Shpendin, e Valbonën e Ilirjanin nonën s'e kanë shqiptare po kroate e kanë! Pse i largove?" Po të them, unë jam rritë me këto gjana, kështu që mandej kapa e mbledha të dhana për t'tanë, edhe shkova e qita Universitetin në padi për largimin. Edhe në gjyqe kur shkova që tash kur i shoh ata gjyqtarë, që kur i shoh edhe bisedoj normal me ta edhe qeshin njëherit "Eh, Vjosa."

1986-shi ka qenë fundi... fillimi i tetorit kur kom shku, e qita, ngreha padi në gjyqje për largimin e fëmijëve, krejt fëmijëve të axhave edhe ata u shpërndanë, mandej u shpërngulën gjithka nëpër botë për me mujtë me u eduku. Edhe, nuk ish puna vetem që i largojshin, atëherë çdo komunë e çojke listën e fëmijëve të armiqve, ia çojke Universitetit, edhe Universiteti i largojke. Po flas për 1986 nuk po flas për '56. Edhe, zavendës rektori atëhere që ka qenë në Universitet, se rektori ka qenë serb, zavendës rektori ka qenë shqiptar. Edhe më tha, "Po Vjosa, kështu është sistemi. Ata janë fëmijë të familjes iridentiste, nacionaliste." "Po a kanë bo fëmija diçka?" "Jo." "Po pse?" "Kështu na ka ardhë lista prej Gjakovës. Prej që duhet me i largu këta fëmijë prej aty." "Po ju p'i lagoni njerëzit në vit të tretë, vit të katërt, para se me kry fakultetin!?" Po qështu ka ndodhë, qështu ka qenë koha. Edhe prapë po thom, gjithë këto gjana, kanihere mendoj se i kom jetu disa jeta. Kanë qenë pjesë të jetës të shqiptarve në Jugosllavi. Po normal që nuk i ka ataku të gjitha familjet. Disa familje kanë qenë ma të zëshme në kërkesat e të drejtave të tyne dhe në rezistencen ndaj sistemit. Ka qenë ma shumë sistemi. Edhe disa ma pak. Po ne e kemi, ne si familje Dobruna e kemi vujtë, e kemi vujtë mjaft.

Nga familja e mamës nuk kom, kom shumë pak kujtime se mama ka qenë fëmiu i vetëm. I kanë lind po mendoj... dy prindërit i kanë vdekë herët, kështu që mamen e ka rritë gjyshja e vetë edhe hallat e axhët. Edhe çka është e mirë edhe e çuditshme për atë kohë për një fëmijë jetim, nanën teme e kanë shkollu. Nuk ka qenë e zakonshme për atë kohë me shkollu dikond, po e kanë shkollu pse edhe axhen e ka pas të shkollum. Po një farë mënyre edhe ata mandej me politikë kanë qenë të diskriminum sepse axha i mamës, nanës sime, gjatë kohës së okupimit italian, ka qenë, ka punu për Ministrinë e Arsimit, Qamil Benxhija. Ai ka qenë i diplomum në Padova, filozofi, edhe mjekësinë në Sorbonë. Kështu që, nuk ka pas aq njerëz të shkollum.

Italia kur e ka okupu Shqipninë, edhe mandej kur ka hy edhe në Kosovë, ata studentat te cilët kanë studiu në Itali, e axha Qamil ka qenë student i Padoves kanë hi, kanë punu për asi. Kështu që, mandej ai ia ka mundësu nanës sime. Me nanën e vetë e kanë rritë nanën time, kështu që ai e ka çu në shkollë... Kështu që mama ime e ka kry shkollën me kohë edhe është një ndër mësueset e para

shqiptare në Kosovë, ajo me 16 vjet e gjysë, 17 vjet, e kom edhe fotografinë, ka fillu me punu si mësuese në Rahovec. E mandej në Gjilan me këtë axhën e vetë me Qamil Binxhinë, e kanë themelu Gjimnazin e Gjilanit, edhe kështu që kom kujtime të mira.

Kom një mburrje me dy anët e familjes, kah nana edhe baba. Nana ime ka punu si mësuese, babi ka studiu skulpturen deri në vitin 1954; 1954 kur ia kanë burgos për herë të parë vëllaun, e kanë largu prej Universitetit të Beogradit. Ka qenë para diplomimit e është kthi në Gjakovë. Mandej kur i ka pasë vetë tre fëmijë, kur kemi lind unë, Pranvera edhe Aida, babi ka shku me studio prapë ne Beograd për punëtor social. Me tre fëmijë, atëherë nana na ka mbajtë neve, babi ka studiu. Ne udhëtojmë majft shpesh. Shkojmë prej Gjakovës, kanë qenë udhëtime fantastike, hypshim nëpër autobusa, trena, blla-blla për me shku në Beograd, me pa babin çdo dy-tre muaj. Edhe, kështu që kanë qenë do kujtime të mira, atëherë blejshim lodra, gjithë ata gjana që ju bëjnë fëmijëve, iu mundësojnë fëmijëve për me ju kompenzu mungesën e prindit. Kur shkojmë në Beograd te babi, na pritshin mjaft lodra, mjaft tesha, mjaft sene. Unë e kisha edhe një kompenzim tjetër, pasi që mu më çojshin me komunu me të burgosurit politik, m'i pa axhat në burgje.

Unë i kisha edhe nje kompenzim tjetër prej gjyshit tim, se e ndijke veten fajtor, se shumë e re fillova me shku, edhe gjithmonë ma mundësojke gjithëçka. Kur fillova veç, hina në pubertet edhe fillova m'u rritë, kur u kthejmë prej Nishit ose prej Pozharevcit, prej burgjeve në Serbi, thojke, "A këtë muaj ke qenë shumë e mirë, ani çka, çka po don për këtë muaj?" Thojsha, "Po du farmerka italiane." "Në rregull, ke me ble farmerka italiane." Ose thojke, "Mujin tjetër..." Gjithmonë u mundojke me më kompenzu për atë që mendojmë që po ma hupin fëmijëninë. Po jo vetëm gjyshi jem, po edhe nana jem e baba jem e kishin njëfarë dobësie ndaj meje për shkak asaj, se atëherë edhe një axhë për shembull që ish jashtë burgut, me bo me shku me i pa e hupshin punën; kështu që askush s'mujke me shku mi pa në burg, veç gjyshi jem që ish plak ose unë që isha fëmijë. Këta gjithë të tjerët...për shembull ish njonë në burg dhjetë vjet, vëllaun tjetër nuk e shihke dhjetë vjet. Ish tjetri 14 vjet, nuk u shih'shin 14 vjet. Une isha e vetmja që shkojsha m'i pa ata me gjyshin tem. Edhe kta mandej gjithë u mundojshin diqysh... me bo diçka me mu, me m'shti m'u ndi si fëmijë, mos m'u ndi vetëm si e rritun. Edhe... u frikësojmë prej dhembjes, kështu që praktikisht deri sa kom fillu me e kuptu, se edhe në shkollë kur shkojsha fëmijët më ngucshin...

OK, çka më kujtohet prej fëmijënisë një moment i bukur. Ma parë të tregova që unë kam qenë vajza e parë në familje që s'ka pas fort djem, kështu që e kom pas njëfar statusi të privilegjum prej të gjithëve e sidomos prej gjyshit tem. Gjyshi jem, shpija e gjyshit ka qenë një shtëpi e vjetër edhe kati, ajo si podrum, ka qenë me gurë gjysë mandej ka qenë gurë; mandej kanë qenë do shkallë të gurit. Mandej ka qenë kati, po oborri ka qenë, unë besoj rrallë kund ke mujtë me pa. Kanë qenë diku pesedhjetë, njëqind lloje të trandofilave edhe gjithë përreth oborrit, i cili ka qenë tre qind metra i madh edhe ka pas trandofille. Dhe mandej te shpija ka pas një, nje kopsht me trandofille ma të vogla edhe mandej ka qenë pjergulla e rrushit nalt dhe një dru kumbull. Kur fillova me shku në shkollë, gjyshi jem e dijke që prej shkollës shkoj te gjyshi, jo në shpi te prindërit e mi.

Shkojsha te gjyshi, ma boni si një bankë në kumull, e kumlla ishte qaty afër pjergulles. Gjyshi jem rrike qaty me nje tavolinë edhe pikë. Gjyshi jem ka pi, ka pi shumë alkool. E ka jetu jeten, Teki Dervishi⁵ e shkruan një libër, Teki Dervishi shkrimtari, edhe thotë, “Ja kushtoj boemit të parë që e kom njoftë unë në jetë Qazim Dobrunes.” Ka qenë boem, ka pi, ka pas dëshirë me pas shoqëri të madhe, ka lexu shumë, ka qenë Bektashi⁶, edhe unë gjithmonë e ngucsha “Babagysh ti je Bektashi jo pse beson ndonjë religjion, po pse ish klub i leximit.” Bektashit lexojnë shumë edhe Bektashit pijnë. Kështu që gjyshi je “ish” në Klub të Bektashive edhe gjithmonë vijke babai aty kështu që per me m’kontrollu tu i bo detyrat, gjyshi jem ma boni në atë kumbull, u qujke kumbull bardhake. I bënte kumbullat e mdhaja edhe ka qenë druni i trashë. Ma boni një bankë, edhe gjyshi poshtë me shokë pijshin me meze në

tavolinë te pjergulla, unë këtu edhe veç thojke, "A ki diçka me me pyet për detyra." Thojsha, "Jo, jo s'ka nevojë, kur ka diçka të pyes." Edhe aty i bojsha detyrat, verës normal, i kryjsha detyrat. E dimrit prapë te gjyshi, që mbaj në mend e kom pas një kand, edhe atë kur u smu gjyshi, ma shumë ishte në shtrat. Në fund të dhomës së ditës, dhomës të madhe, kanë qenë krejt dollapa në mur ashtu të vjetër, edhe nuk e dallojshin se dyert e dollapave, dikund ka qenë ajo që u thirrke si banjo, pasllom e thirrshin në Gjakovë, si banjo aty, edhe po në fund të dhomës ka qenë krejt me ato dyer të bukura të punume si tavani i shpisë. Knej dhomës unë kërkojsha me ma bo një tavolinë se gjyshi jem s’dojke që unë me u ulë në kauq edhe me bo detyra. Po ma kishin bo një tavolinë prej derës, një pjesë e qasaj pasllomit, edhe ajo u shihke jashtë, mandej ma bonën një tavolinë, si tavolinë, prej një derës qasaj pasllomit, edhe ish ajo e punume. Mandej u duhke me qitë edhe nje karton përsiper për me i bo detyrat, po me ma bo veç tavolinen si shkom. Edhe kur ajo gruja e gjyshit tem, njerka e babës tem, u revoltojke pse pe boj ato. Po thotë, "Po ia mësoj vajzës prej tashtit me pas estetikë, me ditë me dashtë të bukurën." Edhe... ma kanë pas bo tavolinën. Këto dy i kom të lidhun me gjyshin tem.

Edhe diçka me gjyshin tem, kur i bona 12 –13 vjet, nana edhe baba jem ishin mjaft, jo rigorozë, po u mundojshin që me ndiku njëfarë rendi ashtuqë edhe kryesisht “nëse edhe ti gabon diçka, *Sot* motrat tuja ma të vogla gabojnë. Kështu që ti ki obligim jo vetëm ndaj vetëvetes po ki obligim ndaj motrave tuja edhe ti je ma e madhja prej gjithë fëmijëve.” Mandej lindi Shpendi, Ilirjana, Valbona, Nderimi, lindën fëmijët e axhave t’tjerë. “Po ti je ma e madhja, kështu që nëse ti gabon të gjithë gabojnë” e u mundojke... Kisha shumë limitime, shumë kufizime. Te gjyshi jem si kisha ato kufizime hiq. Kur shkojsha te gjyshi e kisha krejt liri. Gjyshi... edhe njëherë gjyshi më thojke, "A din çka? Kemi me dalë." Te qarshija e vogël kanë qenë do kafe që dilke gjyshi jem, edhe po thotë, "Tash kemi me dalë, kom me të mësu diçka." “Çka?” “Po shoh në tavolinë të diellave ata s’po i qesin fëmijëve venë me pi.” Edhe po thotë, "Unë të çoj tashti në kafe me të mësu me pi venë, edhe çka tjetër, edhe duhan." E më murr me veti edhe shkum në kafe në Qarshi të Vogël. U mbledhshin shokët e gjyshit, edhe gjyshi porositi një gotë venë të kuqe për mu. Herën e parë pat porositi Shire ka qenë, e herën e dytë mandej venë edhe

⁵ Teki Dervishi i lindur me 1943 në Gjakovë ishte shkrimtar, publicist dhe dramaturg. Ishte drejtor i gazetës *Bota*.

⁶ Urdhër i islamit Sufi, i themeluar në shekullin e 13---të, i gjetur në Anadulli dhe Ballkan. Më shumë i shpërndarë në Shqipërinë Jugore, po ashtu gjendet edhe në Kosovë, në veqanti në Gjakovë.

cigare. Me dhezë një cigare. Kom pas dikund 13 vjet, 12 – 13 vjet. Për vikend shkova në shpi, nuk shkova te gjyshi edhe po i tregoj prindërve të mi, "A tash më ka mësu gjyshi me pi venë edhe tash kur shtrohet dreka të dieleve në shpi, keni me më qit venë." Ai po thotë babi jem, "Venë? A e din sa vjet i ki?" P'i thom, "Po." Po thotë, "Kush të ka mësu?" Po thom, "Babagyshi, kemi shku në kafe edhe më ka mësu me pi venë." E di që e ndisha një bërtimë mes babit edhe gjyshit. Babi për dore në shpi të gjyshit edhe p'i thotë, edhe p'i ndëgjoj bërtimën. Edhe gjyshi jem p'i thotë, "Unë jam ka e eduko, duhet me mësu me pi venë, duhet me mësu me pi duhan, me qenë e pamvarune, me t'a kthy ty fjalën, se ti nuk ke gjithmonë të drejtë. Kjo duhet me mësu me t'a kthy fjalën, për mu bo e pamvarun. Edhe duhet mi ga gjyshes së vetë. Edhe për ato unë kom me mësu."

Deri sa ka vdekë gjyshi jem e unë i kom pas gati 16 vjet kur ka vdekë, gjithmonë ka pas ky konflikt me prindërit e mi të cilët dojshin me më eduku ndryshe edhe më krijojshin... edhe gjyshi jem i cili mi lejojke gjithëçka, jo gjithëçka po gjithëçka! Edhe çka bojke, e merrke ma vonë pensionin e luftëtarit të '41, qe mandej ia dhanë ma vonë, pasi që vdiq gjyshja jeme, tash ia jepshin gjyshit. E ai pension ishte ma i madh që fitojshin rrogat baba me nanën teme bashkë. Gjyshi jem e ndajke me mu. Gjysën ti thojke e merr, gjysën une. Unë i shpenzojsha kryesisht në ushqim edhe tesha që u çojshim këtyne në burgje, jo për diçka tjetër. Po kish gjithmonë kishte qejf me më dhonë mundësi me qenë sa ma e pamvarun edhe sa ma krenare, që gjithmonë me pas shumë. Edhe, edhe kur ka vdekë, kur e kanë qelë atë testamentin që e ka lonë, krejt qa ka pasë ju ka lonë, na ka lonë vetëm neve vajzave, edhe të axhave të tjerë, veq vajzave. Gjithmonë thojke, "Vajzat duhet me pas shumë, vajzave duhet me iu kriju siguri të madhe. Vajzat duhet me i përkdhelë, vajzat s'duhet me i lonë shumë me punu." Gjithmonë vajzat, gjithmonë ka qenë përkrahës shumë i madh për edhe gjithmonë thojke, "Hec rrugës me kokë lartë, kur mos e ulë kokën".

Kur u kthejshim prej burgut ose diçka, unë pak... edhe me ngucshin fëmijët në shkollë kur shkojsha, sidomos fëmijët e liderëve komunistë, që kjo është nacionaliste, kjo i ka axhat në burg, s'duhet me nejtë me këto, ose disa gjana të tjera. Ose, për shembull kur u bojshin festat, që vijke Tita në Kosovë, ose 25 maji - bakladat, gjithë fëmijët dilshin me baklada ose shkojshin në asi... na fëmijët e Dobrunave nuk guxoishim me shku, se shkolla nuk na lejojke me shku. As në pritje, as me festu 25 majin, se "Ju jeni nacionalista". Ma vonë e kuptojsha e s'u mërzitsha për atë punë, po si fëmijë në shkollë fillore e ndisha veten shumë rond kur të gjithë fëmijët dilshin në rrugë. Asi, vetëm na nuk guxoishim me dalë në rrugë, neve na largojshin. Edhe... po mandej fillova me bo edhe unë, po mendoj edhe dozën teme të fesatit. Për shembull, kur kam qenë në klasën e tetë fillore, ende se patën leju flamurin. Edhe... i organizova krejt klasen, se me... i qitshin krejt flamurat, për mos me e qitë flamurin shqiptar në '28-shin, në '27-shin [nëntor], i qitshin flamurat e Jugosllavisë edhe të Serbisë. Edhe ... mund m'i përmend edhe emrat, do janë gjallë, do jonë vdekë, shokët edhe shoqet e shkollës fillore Mustafa Bakija në Gjakovë. Edhe i organizum. E veta gjyshin tem ku mundna me shku me gjetë flamura shqiptarë. Ai ma tregoi një shok të vetin të Prizrenit, gjakovar i Prizrenit që ish kthy prapë në Gjakovë me jetu, që kepeke flamura tinëz, flamura shqiptarë. Edhe e veta gjyshin ku me marrë pare me u pagu.

“Çka po të vyen?” Thash, "Po më vyen nja nje qind flamura." Tha, "Shko ti te ai edhe thuj unë ia paguj. Edhe s'po të ves për çka po të vyen." “Në rregull.”

Shkova unë me një farë shoku të klasës, shok të bankës që e kom pas, shkum i thamë, edhe ai tha, "Për kur po ju vyen?" “Për 27 nëntor në mbramje mi pas.” “Ani” tha. Shkum na me 27 nëntor, diku ka 11 i natës, dulëm, nëpër bandera ku janë vnu flamurat, nja tridhjetë vetë të klasës, të gjithë. Hypëm, i hekëm flamurat e aty, i vnum flamurat shqiptarë tonë. Edhe të nesërmit, 28 nëntor, u çu krejt Gjakova prej ka hihet prej varreve ka Prizreni deri në Qarshi të Vogël gjitha flamurat shqiptare të vnun. Edhe u mshelëm në shpi se e dishim që tash vjen policia. Edhe erdh... policia u shku i ka mbledhë, po kërkush s'po shkon me më marrë mu se une isha nxanëse shembullore, shumë e sjellshme. Ata e dishin që unë shkojsha mi pa axhat në burg se më përcjellshin, po nuk bojsha kurgjo të jashtëzakonshme, ekstrem. Nana më punojke në të njëjtën shkollë si mësuese. Kështu ...

Okej, kështu... I ndrrum flamurat krejt, edhe të nesërmit policia shkojke i mbledhke çka ishin ma të dyshimtë. Po unë isha shumë, shumë fëmijë i mirë edhe, me të vërtetë isha shumë shembullor në shkollë, kurrë pa problem, kurrë s'iksha prej klasës, detyrat me kohë, shumë, deri në atë masë sa fëmijët tjerë më kqyrshin me dyshim pakëz, tepër, tepër e mirë. Se po të thom më kishin eduku që nëse unë gaboj, krejt fëmijët tjerë gabojnë. Kështu që unë s'jom nxanse e mirë ose sjellna keq, ja marrë ftyrën famijles. Kështu që isha me të vërtetë ashtu. Kështu që te unë nuk erdhën. Po mandej kuptova që s'kishte qenë veq ajo. Profesori kujdestar i klasës që gjithë e merrshin që ka qenë shpijun, po, ka qenë i detyrum. Ai nuk më ka raportu mu. I ka thanë, po gjithë kanë shku...asnjoni s'ka tregu, po asnjoni nuk më ka qitë mu për ai.

Tek diku masi që e kemi kry shkollën e mesme, me të njëjtin profesor kujdestar u mbledhëm gjithë në Deçan kur njëri prej shokëve u çu i tha kujdestarit të klasës, i tha, "Vjosa ka qenë ajo që na ka organizu, Vjosa ka qenë ajo që na ka pru nji qind flamura prej një terzisë të Gjakovës kush i ka kep ato flamura, Vjosa na ka bo." “Unë gjithmonë kom dyshu”, tha “vetëm thojsha që me bo me thirrë Vjosën, mandej jo që e majnë, po del problem ma tepër. Ju masi s'i keni organizu, ma lehtë kanë me ju marrë në pyetje.” Kështu që edhe ata që kanë qenë informatorë të policisë, në njëfarë mënyre i kanë, i kanë mbrojtë fëmijët.

Edhe në shkollë... atë e shoh si njëfar “dreqnije” që e kom bo. Po, ka qenë ma shumë influencë e burgut edhe kur atëhere bash... një vjet përpara patën burgos shumë njerëz për flamur. E kjo ka qenë viti i fundit që ka qenë i ndalum flamuri në Kosovë, flamuri shqiptar. Mandej vitin tjetër është leju flamuri se u bonë ndrrimet kushtetuese të vitit 1971, amandamentet në Kushtetutë, mandej '74 Kushtetuta e re, kështu që me ndrrimet kushtetuese të vitit 1971 u leju përdorimi i flamurit shqiptar në Kosovë. Kjo ka qenë 28 nëntori para kësaj, i fundit kur kam qenë në shkollë fillore, kur i patëm ndrru krejt flamurat, e i gjujtëm flamurat jugosllav nëpër tokë, i qitëm flamurat shqiptar. U bo, kta mandej, ka qenë fantastike sepse babi jem ka dalë në rrugë me 28, se duheshin me dalë me punu. Po babi dilke edhe ma shpesh në rrugë sepse UDB-ja atëhere edhe policia nëse nuk del, nuk je publik gjithmonë vijshin të arrestojshin mos je ka bon naj konspiracion diçka, sidomos për babin që i ka pas vllaznitë në

burgje. Kështu që e kanë pas shprehi me nejtë në kafe, mu pa që janë në publik. Edhe tregon që kanë dalë të nesrit në rrugë edhe p’i sheh krejt flamurat, e tashti policia me Qabrati, ka qenë një organizatë e pastrimit, t’u hypë nëpër bandera nalt. Na fëmijë, lehtë për ne me hypë nëpër bandera m’i ndrru flamurat.

Këta tashti do njerëz ma të vjetër t’u hypë nëpër bandera m’i hekë flamurat e babi t’u keshë e tu thonë, "Kush e paska bo?" Tha, "Më shkoj mendja që e ke bo, po... jo, jo nuk besova." Edhe kur ka ardhë në shpi po thotë, "Qëkjo paska ndodhë." "Aha ...paska ndodhë, mirë." "A di diçka për atë punë?" "Jo!" "Shumë mirë." E di që më ka thënë, "Unë gjithmonë të besoj ty, po thom edhe unë ty". Edhe u kry ajo punë, s’ka dyshu. Shumë, shumë ma vonë, atëherë kur u murr vesh kush i ka organizu, kush i ka pru flamurat, se ne të gjithë hypëm nëpër bandera jo vetëm djemtë, edhe vajzat. Edhe u murr vesh po kalum pa pasoja për atë punë që u ndrrun flamurat, veq u bo shumë e madhe. Edhe Rilindja atëherë gazeta, edhe televizioni lajmëruan që në Gjakovë nacionalistat e irridentistat e kontra-revolucionarët e qysh na thirrshin mo krejt, i kanë ndrru, e kanë hudhë flamurin jugosllav edhe e kanë qitë flamurin shqiptar. U kry ajo punë. I bojme, bojshim qësi, qësi dreqni.

Lexojshim libra tinëz që vishin. E merrshim një libër edhe e lexojshim. Zakonisht unë i gjejsha librat prej axhave të mi, ose qëta ish të burgosurit politik ma jepke naj-njoni një libër. Unë e lexojsha ma së pari librin edhe ju përcjellsha mandej tjerve. Jo libri "Dimri i Madh" i Ismail Kadares, "Gjarpërinjet e Gjakut" të Adem Demaçit. Edhe, kanë qenë do libra, mandej do dokumente që i gjojshin për Qubrilloviqin⁷, e atëhere që kishin... Ne ishim në shkollë fillore, fillimi i shkollës së mesme kur i lexojshim. Po ka qenë shumë rrezik m’i lexu. Po njëni i merrke, zakonisht isha unë ajo që i gjojsha ato libra, mandej ju përcjellsha të tjerve, veq mu kurrë nuk më ka ndodhë, kurrë shokët e mi edhe shoqet e mija, me më tradhtu, me tregu që Vjosa. Edhe kur u zejshin me libra, kurrë nuk ka ndodhë me tregu që Vjosa na ka dhonë librin. Kurrë!

Gjithmonë u gjujshin, u shkyshin, u bojshin diçka, nuk... "E kom gjetë në rrugë," bojshin diçka. Kështu që i fiitojshin disa shuplaka se ishin nën 17 – 18 vjet edhe në fund u lirojshin, po me më tradhtu kurrë. Gjithmonë i kom furnizu me libra, me gjithë librat edhe me gjitha punët tjera që u duheshin m’u bo në atë kohë me tregu njëfarë rezistence, e për mu ka qenë njëfar lloj ventili.

Prej krejt asaj çka përrjetojsha në jetën e përditshme, sepse... për shembull, askush në familje nuk punojke, vetëm nana ime punojke. Mandej, pse ishin axhat në burgje, u largojshin prej punës, edhe babi edhe kush ish jashtë, e qitshin prej punës. Kështu që, unë të vetmin ventil e kisha me bo diçka gjana kështu edhe me lexu. Se shpesh edhe shoqniija ime edhe unë, e mbaj në mend ’85-shin, kom qenë t’u punu si mjek në dispanzerinë e fëmijëve, kur me 5 Tetor, me 5 Mars i burgosën katër axhat e mi, a po kupton?! Unë ndëgjova në televizion se isha në punë, punojsha si mjeke, edhe me 5 Mars në mbramje, në të vërtetë me 6 Mars u murr vesh në televizion, në lajme që ndodhi.

⁷ Vaso Qubrilloviqi ishte aktivist dhe akademik serb nga Bosnja, anëtar i grupit të komplotit Bosnja e Re që vrau Archduke Franz Ferdinandin.

Me 8 Mars u bo, u festojke 8 Marsi atëhere, gjithë dispanzeri i fëmijëve u mbledhën me festu 8 Marsin, mu s'më thirrshin, se gjysa e atyre njerëzve që kanë punë tash janë parlamentarë, patriotë.

Atëherë u thirrshin u mbledhshin me festu 8 Marsin, mu s'më thirrshin, se kjo është... këtë tashti s'guxojmë me thirrë se na bënë sherr, na burgosin ose na marrin pyetje edhe neve. S'guxojmë me thirrë as në solemnitet, askund s'më thirrshin se axhat në burgje. Edhe '85, '86 e lejshin një të sigurimit që rrijke para ordinancës time, gjithë orarin e punës, prej se visha në ora shtatë deri në ora dy, ai u dufke me nejtë. I frikësonte edhe pacientat, i frikësonte.

Po askush prej krejt dispanzerisë së fëmijëve nuk guxojke me ardhë me fol me mu. Po flas '85, '86, asi, para se me shku në specializim, si mjekë t'u punu në dispanzer të fëmijëve, kërkush s'guxojke me folë me mu për shkak se axhat më kishin hi në burg, të gjithë. Tre mujë ditë nuk e dishin ku janë, kështu që unë me katër motrat e mia, hypshim në automobil, u vesh'shim bukur, gjitha këpuca italiane, fustana Jugoexportit se ka qenë top, ose farmerka italiane, edhe u vesh'shim mirë, edhe shkojshim në burg të Gjakovës, "A i kemi axhat këtu?" "Jo." Në burg të Prizrenit - jo, në burg të Gjilanit - jo, në burg të Prishtinës - jo, në burg të Podujevës - jo, të Mitrovicës - jo. Tre muaj ditë nuk e kemi ditë a janë të gjallë, a janë të vdekur. Asnjë burg nuk n'a tregojshin që janë. Gjatë gjithë kohës kishin qenë në burg të Prizrenit. Asnjë herë s'na kanë tregu, tre mujë ditë.

Po na tre mujë ditë e kemi bo, e patëm bo rutinë, të pestat, po duheshim me pritë me shku të premtën masdite. Mu për inatin më qitshin me punu të premtën masdite. Atëherë shkojshe të premtën paradite, i bijsha dy stacioneve të policisë, vijsha me automobil me motrat e mia, u kthejsa për me dalë në ora një me punu, se në një na fillojke ndërimi me punu. Me qëllim më qitshin me punu se u mësuan ata që unë i marr motrat e mia edhe shkoj nëpër burgje m'i vizitu. Babi jem u frikësojke që t'u shku nëpër stacione të policisë, mos po na dhunojnë edhe gjithmonë thojke, "Ma mirë shkoni të pestat, që të mos shkojnë kur shkojshin mashkujt me vete." E kish metë veq babi jem prej majshkujve se të gjithë të tjerët i burgosin, kur shkojke, e fëmijët e tjerë tashti që ishin, gjithë ishin të vegjël, nuk mujshin me shku m'i lypë nëpër burgje, nëpër stacione të policisë. Vetëm ne të pestat. Donika motra jem e vogël, ka qenë mjaft e vogël, edhe po na, sidomos na trija unë, Pranvera dhe Aida ma të mëdhajat, na trija në automobil, të pestat hypshim edhe shkojshim në stacion të policisë. Edhe mo, në stacion të policisë të Pejës, jemi bo qaq të njoftuna, se lejen për me vizitu të burgosunit duheshim me shku m'i marr në gjykatë të Pejës. Kështu që, na shkojshim e marrshim lejen edhe pa e ditë ka jonë, lejen u dufshim me shku me marrë aty. E shkojshim... mas pari të Pejës e mandej shkojshim në burgje, stacione të policisë, tre muaj ditë. Mas tre muaj ditëve e morrëm vesh që janë në Prizren. Mandej ish ma lehtë se i kishim ditët e caktume që shkojshim i vizitojshim.

Edhe, po ia nisin m'i shpërnda. Mandej i dënun. Këtë të voglin e dënun 14 vjet, këta të tjerët ma pak. Kjo ishte hera e sa, jo hera e parë. Edhe po... në punë ishte shumë vështirë, në shpi ishte shumë vështirë se kërkush s'na qilke derën. Kurrë! Kërkush s'guxojke. Vetëm një shoqe e imja atje, një mikeshë, një mjeke, Klara. Ajo e vetmja që ka marrë guxim me ardhë njëherë në shtëpi me na pa, se

kërkush s'guxojke. Na qitën krejt fëmijët prej Universitetit. Gjithë i largun prej punës. Unë... si mjeke, jo edhe Pranvera. Gjithë të tjerët i largun prej punës.

Të gjithë axhat i shtinën n'burg, edhe thojsha "Shyqyr që ka vdekë gjyshi me gjyshen." A din, se gjyshja kishte me thonë, "S'pasna pas për çka me luftu!" Vetëm praktikisht, Pranvera edhe unë atëherë i majshim të gjitha familjet e axhave; njoni i kishte katër fëmijë, tjetri tre fëmijë, tjetri katër fëmijë, ky i vogli asht i pamartum, e na i majshim krejt familjet, edhe i majshim mirë. Për me iu tregu që nuk thehem i merrshim krejt fëmijtë edhe dy javë shkojshim n'Greqi për pushim, se ata i majtën disa ditë n'burg, ose shkojshim e blejshim garderojë t're, blejshim topa t'ri, qësi gjana çka fmitë dojnë ose biçikleta t'reja, ose diçka veç për me tregu që na po rezistojmë, edhe bojshim seleksionim të njerëzve kush vike me i pa. Se vishin shumë, shumë informatorë t'cilët vishin me t'provoku, ose t'lejshin diçka n'shpi e mandej vijke policia mas dy ore kishe po t'a kontrolloj shpinë, edhe t'gjojke naj material, naj material propagandues. Ose, e maj n'men, niher e patëm ly shpinë e gjyshit edhe kish metë ni ngjyrë, që ka metë edhe e lamë se fmijë, e lam mjaft ku zhlyhet diku me e ly gjysë. Kur erdh policia, tha, "Qaty që keni bo Molotov, që keni rujt Molotov" "Po çfarë Molotov-i?" Tha, "Keni rujtë Molotov nër shkallë." "Ani", thash "merre, ngjyrë asht." Tha, "Jo, Molotov asht..." "Merre bre Molotov-in." Tha, "Hajde n'polici." Thash, "Ani po vij n'polici," thash "po mas pari, nuk asht shpija jeme"... Molotov, Molotov e morën.

Shumë, beso shumë m'vjen me qeshë me atë njeri, se e shoh tash atë njeri ni UDB-ash. Edhe kur m'murën n'pytje edhe le që m'morën n'pytje mu, po i murën n'pytje edhe Gurakuqin edhe Sarandën e Lekën që ishin 9 vjeqë, 10 edhe 11. E na nali deri n'11 t'natës t'u na marrë në pytje për ni shishe me ngjyrë e cila ka metë mas t'lymjes. "Ja, keni përgatitë Molotov." Hajde... Krejt fmitë na merrshin, na çojshin në polici, na majshin ka disa orë e shqiptarë, jo serb, shqiptarë... tonë jon asi, tonë jon ende gjallë. Shyqyr që jon gjallë, edhe shyqyr që jon patrioti t'mëdhenj... tash edhe shumë shpesh s'guxoj me i kqyrë n'sy, kur t'i shoh nëpër evenimente të ndryshme ose kur po shkojnë, që po shkrujnë libra për patriotizmin edhe do që m'kanë marrë n'pytje n'polici gjatë, që merrshin n'pytje sa herë shkojsha me i pa xhaxhat n'burg, kajherë që shkojshin ata n'strajk, e kur u kthejsha prej vizitës m'thirrshin n'polici edhe m'merrshin n'pytje ka disa orë. Ka disa orë, mama me babën rrishin para policisë me orë të tana me prit, e asi gjithë me frikë mos po m'ndodh diçka. E normal gjithmonë ishin shqiptarë qita UDB-asha edhe çka m'ka thonë axha n'burg, po jo p'i ndigjojsh, po familjet e atyne t'tjerëve që je taku para Deligradit burgut, "çka t'kanë thonë kta, çka ki thonë?"

S'ka qenë kohë e lehtë, tash po m'doket, edhe atëherë nuk m'u ka dokë shumë vështirë, beso! Kom pas përkrahje t'familjes, qashtu kom qenë e dashtun n'familje, në nifar mënyre që nuk m'ka mungu fort rrethi. Po tash po e shoh që m'paska pas pengu po e kom internalizu, e kom shymë ato. Tash ngandoniher kur i shoh ata njerëz m'kujtohen, edhe iu shoh ma tepër për t'madhe se atëherë. Atëherë e kom marrë si ma normal, ka qenë pjesë e sistemit, u kry ajo punë, duhna me u rujtë se qiky osht UDB-ash, informator e qiky osht qiky; qikjo ose diçka, por nuk kom mendu fort për atë punë, e kom marrë si gjendje normale, e tash kur i shoh ata njerez, tash m'dhem ma shumë, tash e kom nifar

mlefi... nuk jom hakmarrëse, nuk jom ashtu me u hakmarr, por m'pengon, m'pengon që kurrë nuk osht bo ni lustrim n'Kosovë. M'pengon që i japin, rrethi i jep atributet të paqena, e unë krejt i di, krejt i di, i di ata njerëz, i di kush ka shpiunu për kon, i di kush i ka shpiunu t'burgosunit politik, i di kush m'ka marrë n'pytje. Ma mirë i di ata shqiptarë që m'kanë marrë n'pytje se njëmbëdhjetë herë që m'kanë marrë n'pytje gjatë apartheidit edhe luftës n'Kosovë, policia e Serbisë. E aty nuk i di ftyrat e atyne serbëve, nuk i di ftyrat, po veç pasojat i kom kur ma kanë thy shpinën. Po shqiptarët që m'kanë marrë n'pytje sidomos në vitet e 80-ta, kur i kanë burgos xhaxhat, secilin e di, secilin edhe jon plakë, meniren thujse e kom nifar ndjesie kur t'i shoh, n'rrugë ose i shoh, meniren i njof. Osht e pamundun qysh i njof mirë, serbt e kanë hup ato, i kom diqysh gjithë njerëz, i kom marrë si osht apartheid e je me ni konflikt t'madh, domethanë e kom ditë që po boj diçka kundër tyne, ato para luftës që ka qenë UDB-a, shqiptarët kur t'kanë marrë n'pytje, ato kurrë s'muj me nifar mënyre me përbi tamon, se kurrë s'kom mujt me arsyetu. Kto e arsyetoj, ato s'kom mujt me arsyetu kurrë, gjithmonë m'ka lon ni pasojë t'cilën unë e shpreshi kur m'nevojitet me komuniku me kta njerëz për arsye të ndryshme edhe e di që e kom ni ashpërsi, ni ashpërsi... gjithmonë munohna me iu lon me kuptu që e di, që nuk kom harru, e di çka keni bo edhe e di që nëse s'ma keni bo mu diçka, e di kujt ia keni bo. I di rastet për shembull kur jon dhunu të burgosnit n'burgje, i di edhe kur i shoh ata njerëz, unë thjesht nuk muna me qenë e sjellshme, s'muna me qenë ato çka rrethi pret prej meje, kom me thon diçka që me i dhon me kuptu, mos me e lon t'qetë. E maj ato n'veti, e maj edhe m'del si dritë kur i shoh, edhepse munohna m'u majt, m'del se kanë qenë t'dhembshme çka ka hekë kjo popullatë, kanë t'dhembshme, e unë i di, unë e kom përjetu.

Ki pas ni shtresë t'popullsisë që nuk ka pas lidhje me nivel t'edukimit, se rrallë kush ka qenë, ka pas rreth ma t'shkollum ma t'edukum se une, nga dy anët. Po t'thom, axha i mamës teme e ka kry n'Sorbornë edhe n'Padova edhe i kom pas me gjenerata t'shkollum familjen, nuk osht' puna e shkollimit, po ka kriju ni shtresë e shoqnisë të cilët e patën kriju ni mirëqenie për arsye të ndryshme të cilat kanë qenë mjaft gjykuese ndaj tjerve, sidomos nëse ke pas ato, nëse je qujt nacionalist ose irredentist ose e ki dikon në burg. Atëhere t'kanë diskriminu më tepër, une e di kur e kom kry fakultetin e mjeksisë, une kom qenë jo ma e mira, po ndër ma t'mirat në gjeneratë. Edhe m'thojshin, "As mos u lodh me konkurre për asistent. Ti me krejt axhat n'burg, qysh po kujton ti? As mos u lodh." Profesorat e mi, që m'dojshin shumë e m' respektojshin, "Mos konkurro, mos na qit n'pozitë t'keqe. A po don me n'a shti n'burg a?" Thojsha, "Po e kta tjetrt?" "Kta s'kanë lidhje me politikë, ti je Dobrunë, ti rri qaty, shko bonu mjeke." "Po, po du me hi n'arsim." "S'bon, s'guxon ti me hi n'arsim." Ka qenë e zakonshme, tash po i harrojmë gjanat, se osht' ni kohë tjetër, p'i harrojmë sa kanë hekë disa familje, e kjo osht' punë e çuditshme, se zakonisht kanë kshtu familje n'fshatra, ma shumë kanë hekë familjet n'fshatra.

Familja jonë n'Gjakovë, edhe disa familje n'Gjakovë, jo vetëm e jona, me t'vërtetë kemi pas ni "status special" {bën thonjëzat me duar}. Kemi shku... gjithë fëmijët e kanë përjetu atë, e une pse kom qenë ma e madhja, ma shumë, se kom marrë obligime ma shumë. Por besom, gjithë fëmijtë kanë shku nëpër stacione policore, gjithë fëmijtë... edhe pse kanë qenë fëmi. Leka ka qenë tetë vjeç, a nantë vjeç

kur e kanë marrë për herë të parë n'pytje në stacion t'policisë disa orë. Tanë fmitë tonë kanë kalu nëpër... fëmijë, tjetër sen kur jonë rritë, tanë mandej shkun në UÇK. Nantë... t'gjithë iu bashkangjitën UÇK-së. Ish ni vazhdimësi e edukimit familjar, edhe tanë jonë tash pa puna (qeshë). Se asnjoni nuk iu ka bashkëangjitë partive politike, e këtu pa qenë me njonin prej "liderave" {bën thonjëzat me duar} nuk ka punë. T'gjithë jonë pa punë, t'gjithë, t'gjithë, t'gjithë...(buzëqeshë).

Ka qenë pak e çuditshme mandej se shkollën e mesme erdha në Prishtinë, se babin e tem e largun prej punës edhe në Gjakovë. Edhe gjithë të tjerët, edhe babi erdh me punu në Prishtinë. Praktikisht me i hupë pak fërkam edhe filloi me punu në [shkolla] Ramiz Sadik. Mama s'gjejke punë si mësuse ktu, por unë erdha me babën në Prishtinë dhe ka qenë një ambient shumë i mirë se babi e murrë një banesë shumë të madhe edhe aty u bo si ni klub i shokëve, t'gjithë këta që ishin njëfar mënyre *descidenta* edhe rrishin në banesë. Babi e kishte një banesë me tre dhoma të fjetjes, katër dhomëshe atëherë të madhe edhe aty rrike Teki Dervishi, Shaqir Shaqiri, Jusuf Gërvalla⁸ të gjithë u mbledhshin aty. Praktikisht ajo frymë që unë isha rritë edhe vazhdova me ta veç që tash ma shumë edhe me pjesën letrare. Edhe këta me nifar mënyre... unë isha, sa isha kur kom ardhë në Prishtinë, isha katërbëdhjetë vjet në shkollë t'mesme (buzëqeshë). Në nifar mënyre fillova një "edukim" {bën thonjëzat me duar} krejt tjetër, që jo vetëm edukimin që e bojsha n'shkollë, po me këta rrihim gjithë natën t'u lexu, ose këta t'u shkru, e tu shpjegu çka shkruhet. Krejt çka ka shkru Teki Dervishi për shembull, dorëshkrimet origjinale, babi jem i ka. Jusufi ditët e fundit që ka qenë në Kosovë, kur veç e largun prej Rilindjes, jo shkoi n'Shkup e u kthy, vijke u fshehke në atë banesë te babi jem.

E ka qenë shumë e çuditshme, po unë vazhdova me qenë nxanëse e mirë edhe n'gjimnaz. Ishte shumë e çuditshme, që n'vitin e katërt, kur e kreu vitin e tretë n'gjimnaz; vitin e katërt prej gjithë nxansave t'shkollës, i zgjedhën tre nxanës me shku në Amerikë, një vjet për shkollë t'mesme. M'zgjedhën edhe mu. Ishte shumë e çuditshme se atëherë, kush s'i kish prindët anëtarë të Partisë Komuniste, nuk i lejojshin, po m'zgjedhën. Edhe shkova në Amerikë, e kreu shkollën e mesme. Edhe atje isha nxanëse e mirë. Në Amerikë zgjedhen njëqind shkollave t'mesme dhe thirret National Honours Society, thirren njëqind ma t'mirët në Amerikë, edhe unë isha një ndër njëqind ma t'mirët nxansa të atij viti. Kur e kreu shkollën e mesme, ata m'ofrun dhe u regjistrua me studiu në UCLA - arkitekturën. Po me ligje amerikane atëherë, nuk u lejojke pa lejen e prindit që të vazhdojsh me qëndru në Amerikë. Atëhere ka qenë edhe ligji për votim, njëzet e një vjet. Unë isha ende pa i mbushë 18 vjet kur e kryva shkollën e mesme.

Kështu që, duheshin dy prindët me e nënshkru për me qëndru në Amerikë. Babi jem shkoj edhe nënshkrou në Ambasadë Amerikane në Beograd, nana jeme jo. Tha "Le t'kthehet ni kohë n'Kosovë, mandej kqyri." Ajo kohë ishte me qëndru gjatë verës n'Prishtinë, kështu që u ktheva n'Prishtinë. Ni ditë dola, atëherë ka qenë Hoteli Bozhur n'terrasë me u taku me miqtë e mi, isha kthy prej Amerikës, dojsha me pa shokët e shoqet e gjimnazit, me kqyrë kush, çka po regjistrohet. Kur, e maj në mend po vjen ni shoqe, po thotë "O urime, ishe pranë në mjekësi." Atëhere në mjekësi me u pranë, duheshe me

⁸ Poet dhe shkrimtar, udhëheqës i Ilegalja, i vrarë në Gjermani me 1982.

dhonë provimin pranues, po unë isha prej klasës t'parë n'fillore edhe n'Amerikë, krejt pesëshe... kështu që na që ishim, atëherë u thirrshim Vukovca (qeshë). S'e mbani n'mend, e kishim atë shpërblimin e Vuk Karagiç⁹ për nxanësa të mirë, kush ishte gjatë shkollimit kishte veç pesë. Kështu që mu m'kishin pranë në mjekësi pa provim pranues, edhe isha regjistru në mjekësi. U ktheva në shpi edhe po pys, "A din dikush me m'tregu qysh isha shku une në mjekësi?" Edhe e kemi pas traditë, nana e baba jem, në ora tre jemi dashtë të gjithë me qenë n'shpi me hongër drekë. Edhe erdha n'shpi e po pys, pe shiqoj babën tem e po thom, "Si osht e mundun që unë isha regjistru në mjekësi?" Babi po thotë,

"Bisedo me mamën." Pe kqyri mamën, ajo e kish ulë krytë, "Une du që një fëmijë me kry mjekësinë, e pasiqë ti je e para, ti do t'a studiosh mjekësinë." Edhe tha, "Une kom dëshirë ti me studiu mjekësinë." Edhe e dyta, "Nëse ti e refuzon, e nuk shkon në mjekësi, e nuk më dëgjon, katër motrat e tua nuk m'dëgjojnë mandej. Ki obligim, si ma e madhja." "Po mama une nuk e du mjekësinë, une tutna prej gjakut." Tha, "M'fal ky është vullneti jem, ti ende s'i ke 18 vjet. Harro Amerikën." Edhe si çikë e mirë, edhe si obligim që kom ndaj motrave t'mija, dëgjoja.

Po për me bo diçka çka vetë dojsha, jo vetëm mjekësinë, e regjistrova edhe anglishten. Kështu që, paralel shkojsha, atëherë shkojsha mjekësi, anglisht edhe përthejsha gjithë filmat e vizatum për Radio Televizionin e Prishtinës, edhe punojsha si përkthye për Exim Kos-in në t'njëjtën kohë. Edhe fitojsha ma shumë se mama me babën tem bashkë (buzëqeshë). N'fillim përkthejsha vetëm filma t'vizatum për RTP, ma vonë përkthejsha gjithë filmat, se profesorët e mi në Universitet të Anglishtës punojshin për Radio Televizionin e Prishtinës. Edhe ata i merrshin filmat me përkthi, e na jepshin... Prej studentave shumë pak kish që dijshin anglisht, kështu që m'i jepshin mu filmat me i përkthi, ata i merrshin paret, une e merrsha ndonji honorar. Se filmat shkojshin t'përkthym në emën t'atyne. Po m'pagujshin edhe mu. Gjithë studimet që i kom kry, mjekësi, gjatë tanë kohës kom punu. Gjatë tanë kohës kom përkthi, përkthejsha faksa, qysh u ndërto qiky Feronikli, krejt faksa që vishin prej investitorëve, vishin prej... mjetet që u blejshin, gypave. Prej Suedisë vijshin faksat atëhere në Exim Kos, e s'dijshin anglisht. Unë përkthejsha, i shkrujsha faksat, e majsha atë korrespondencën. Krejt kohën e studimeve, gjithë kohën kom punu. Praktikisht kom punu prej 16 vjeçe (buzëqeshë). Edhe kur kom qenë në shkollë të mesme në Amerikë, kom punu gjatë shkollimit maturante, kom punu... Niher punojsha në Burger King, mandej kom punu në Macy's. Mandej kur erdha këtu meniherë e regjistrova fakultetin. Kom punu për Radio Televizionin e Prishtinës, kom punu për Exim Kos deri sa kom diplomu. Kur e kom kry mjekësinë, mandej m'pranun n'punë në dispancer të fëmijëve, edhe ishim grupi i parë, grup i madh i shqiptarëve që u pranun. Krejt... shumica kanë qenë serbë. Edhe grupi i parë i shqiptarëve edhe njëmbëdhjetë vetë u pranun, unë isha një ndër ta, edhe normal që gjithë shefat e drejtorat ishin serbë, vetëm na punëtort ishim shqiptarë. Po në t'njëjtën kohë punojsha edhe në Gllokovc, aty punojsha për qef. Komoran, Glllogovc gjithë fshatëra, edhe ka qenë ni eksperiencë fantastike. Për kurgjo mos me pas dashtë n'luftë, osht' dashtë për Drenicë.

⁹ Linguist dhe akademik i folklorit mbështetës i identitetit kombëtar serb i bazuar në gjuhë.

Drenica ka qenë... une kom qenë aty kur u bo lufta e Tahir Mehës. Kom qenë aty kur, e maj n'mend niher ishin forcat e policisë serbe, jugosllave, jo serbe m'falni [i drejtohet intervistueseve], prej krejt Jugosllavisë u mbledhshin edhe në korrik të vitit 1981, kishin shku e kishin rrethu Bellaqevcin. Edhe ni teknik që punojke me mu, m'thotë, "Vjosa, doktoreshë e kanë rrethu Bellaqevcin." "Ani çka osht n'Bellaqevc?" Tha, "Osht ni shaptelograf." Atëhere që i shkrujshim materialet propaganduse. Unë sa isha në Itali, shkova me ble garderobë (buzëqeshë). Edhe isha shku n'punë, ish nxehtë po isha shku me do çizme përmbi gu, antillop dhe shorts, të shkurta. Unë isha 25 vjet mjeke, edhe çka me bo me shku me i nxerrë, ky tekniku, "Çka me bo?" "Me shku me i nxerrë." Tash po i thom drejtorit që po shkojmë me vaksinu, ku e di policia kur osht kalendari i vaksinimit. Thash, "Qitash e lypi xhipin," atëhere kanë qenë ata xhipat pa dyrë. Edhe hypëm e veshëm mantillin, hypëm n'xhip edhe shkum n'Bellaqevc edhe i mledhëm e thamë "Kena me bo vaksinim." Edhe këta djemtë teknikë që I kisha, motrat medicinale shkun e gjetën ku osht shaptelografi, edhe i morën materialet. I morën këta djemtë, i shtimë n'kerr duheshim me i kqyrë se me iu bo analizat e gjakut se s'po mujme me iu bo vaksinat pa analizë t'gjakut. I majshim n'automobil se u duhke me i bo do vaksina (buzëqeshë), mos me na rrehë policia (qeshë).

Edhe i morëm këta djemtë dhe i kthym në Glllogovc. Mandej, prej Glllogovcit lehtë e kishim me i largu, po prej Bellaqevcit me i nxerrë edhe me pshtu këta djemtë që punojshin shaptelografë, po djemtë ishin pas mundu këta teknikët tonë, teknikët e mi.... e kishin pas fshehtë edhe shaptelografin. Policia e ka kuptu që na diçka kishim bo, edhe na nali në kryç mes Komoranit edhe asi... edhe na qiti krejt mjekët që udhëtojmë prej Prishtinës jashtë. Edhe, qashtu e rrehi ni koleg tonin se ai tha, "A e dini kush jom unë? E kom babën anëtar të Komitetit Krahinor të Partisë Komuniste." Ata t'a fshinë dajak, e t'a rrehën para nesh, s'guxojshim me dalë. Kerri i ndihmës së shpejtë, aty shtrati {tregon me duar}, Liria edhe unë, dy mjeke që kemi qenë femra, ajo stomatologe, unë mjeke. Edhe, na rrijshim mrapa, e problemi osht që dikush kish tregu që kanë shku mjekët kishe me vaksinim, edhe e kanë fshehtë ose kanë bo diçka me shaptelograf edhe e kemi largu... Qita djemtë e ri të Bellaqevcit, veç qato eksperiencia m'kanë ndihmu shumë.

Mandej gjatë luftës, se kudo n'Drenicë mujsha me shku, i dijsa rrugët, i dijsa familjet, e disha prej cilës ka me u rujtë. Edhe i kemi pas, edhe te Guri i Plakës gjatë luftës, edhe n'Shalë, Sëdllar edhe në Pjetërshticë, edhe në Vasilevë, edhe në Bukosh, osht ni Bukosh tjetër ka Novolani anej mrapa që dilet ka Vuçitërrna, i kemi pas qendrat ku i lejshim barnat, edhe i lejshim mjetet tjera. Ajo experience e 81-shit, 82-shit, që kom punu në Drenicë m'ka nihmu se i dijsa rrugët, i dijsa njerëzt. Edhe pse, mas shumë vjete po e kisha nifar njohurie për Drenicë. Edhe mujsha lehtë, edhe gjatë luftës ajo punë e atyne vjetëve m'ka ndihmu gjatë luftës, se çdo rrugicë t'fshatrave të Kosovës i kom njoftë, rrallë kush ka ditë me shku do rrugë që shkojsha unë gjatë luftës me hi anej ku u kon Ramushi, e Jabllanicë nëpër Shaptem, me shku anej mrapa. Ose me shku me hi në Drenicë, do rrugë, do rrugica që shkojshim na që hijshim, që kërkush nuk i dijke. Ajo eksperiencë e 81-shit, 82-shit të punës në Drenicë, m'i patën msu mjaft mirë.

Kurgjo... punova mandej gati 10 vjetë si mjeke, në 86-ën n'tetor shkova për specializim në Zagreb, edhe zakonisht ka qenë me ligj që duhet me shku ni vit diku jashtë, une nejtja 3 vjet e gjysë, deri me 23 qershor të 89-shit. Edhe, ku i krega edhe studimet post-diplomike, vetëm me mbrojtë temën e magjistraturës edhe e krega specializimin, pediatri. Edhe ajo ish ni kohë shumë e mirë se filloi me u aktivizu rrjetet e grave, edhe m'u krijn nifar lëvizje për të drejtat e grave. Unë meniher kisha veç shoqe në Zagreb, edhe fillum me nifar radio stacioni 101, me fol për të drejtat e grave, si të drejta njerëzore. Edhe krijum ni rreth të mirë që ai *network* ai rrjet, mandej ka vazhdu gjatë gjitha luftave, jo viteve 80-ta, viteve 90-ta, edhe pas luftës me grupet e grave që e formun kah Sllovenia, Kroacia, Bosnia, Serbia edhe Kosova, Maqedonia, edhe Mali i Zi nuk ka qenë pjesë e atij rrjetimi, nuk ka pas gra aktiviste që kanë punu për të drejtat e grave. Kosova ka qenë mjaft e fortë aty. Unë kom qenë një ndër të parat që ka *network*-u, bashkëpunu me grupet e grave, e praktikisht ka qenë pasojë, rezultat i jetës sime në Zagreb, specializimit edhe magjistraturës në Zagreb. Kështu që kemi vazhdu me to, ende bashkëpunojmë në projekte të ndryshme që jonë të Mediterranit, Ballkanit, Evropiane... e nuk thirren mo Ex-Jugosllavi, ni kohë u thirrshin Ex-Jugosllavi po, kemi vazhdu me bashkëpunu, kryesisht në çështje të të drejtave të grave. Gjatë luftërave në Kroaci, Bosnie edhe në Kosovë kemi bashkëpunu mjaft, edhe jemi mundu me i përkrahë edhe me avoku për të drejtat e grave, me avoku kundër dhunimeve, sidomos në Bosnie dhe në Kosovë, po atë avokim dhe raportim si cënim i të drejtave të njeriut, ne e kemi bo edhe më përpara.

I kemi pas të dhënat e para kur, edhe gjatë viteve të apartheidit në Kosovë, të burgosurit politikë... kemi pas raste e dëshmi që disa prej tyre, janë dhunu. Kështu që veç osht vazhdu ajo punë, praktikisht e kemi dit që trupat serbe, në çfarëdo forme, jo vetëm tash që flitet paramilitarë, po edhe policia e rregullt e në disa raste edhe ushtria, po ma pak ushtria, e kanë shfrytëzu dhunimin si mjet të luftës. N'Bosne ka qenë ma drastike, në Kosovë jonë eduku pak, jonë shkollu edhe eksperiencat e Bosnës kur i kanë apliku në Kosovë, i kanë apliku në mënyrë ma t' sofistikume. Tash po jom cinike sepse kanë dit me i fshehë ma mirë. Edhe shumicën e grave që i kanë dhunu, i kanë mytë. Në Bosne ka ma shumë raste kur i kanë lon të gjalla.

Kështu që sikur të vdekurit, të mbyturit në Kosovë, që i kanë bart me frizhidera, edhe iu kanë ndrru vorrezat prej Kosovës i kanë bart në Serbi, ashtu edhe çështjen e dhunimeve jonë mundu me e fshehë. Të gjitha këto janë, se në Bosne i kanë bo kshtu ma haptaz; në Kosovë e kanë ndërru strategjinë e jonë bo pak ma, kushtimisht, {bën thonjëzat me duar} "ma të menqëm" me fsheh.

Por, dhunimi i grave shqiptare ka qenë ni praktikë që osht zhvillu me vite në stacione policore. Kur i kanë marrë në pytje, biseda informative që jonë thirrë ose që i kanë dënu, ka qenë ni praktikë e cila osht denoncu shumë vonë. Mandej në vitet e 90-ta, për shembull, kom punu si aktiviste për Këshill për të Drejtat e Njeriut, kishim raportime për raste të tilla. Por, politika e përgjithshme, qëllimi ka qenë që mos me bo shumë atë punë të madhe... Kryesisht, mashkujt e Këshillit për Mbrojtjen e Lirive dhe të Drejtave të Njeriut rezistojshin që na gratë, aktivistet të publikojmë rastet. Por, njëkohësisht edhe familjet e grave dhe vajzave të dhunime ishin ata të cilët nuk dëshirojshin fort me bisedu për atë

punë. Kështu që ka qenë ni praktikë e cila edhe sot e kësaj dite, na kemi problem, jo me i identifiku, na e dijme cilat jonë, po me nihmu që ato të dalin publikisht edhe me mbrojtje të tregojnë çka iu ka ngja.

Kur e kryva fakullutetin e mjekësisë fillova me punu në dispancerin e fëmijëve qaj grupi prej njembdhieteve që u punësum, e punojsha edhe në Drenicë në Glllogovc një kohë, mandej edhe në Komoran. Do të thotë '81-shin, '82-shin kom punu edhe në Drenicë edhe në Prishtinë, deri në '86-tën. Në '86-tën në tetor shkova në Zagreb, jom kthy me 23. Atë vit ndodhën ndërrimet e dhunshme kushtetuese dhe normal rezistenca e atyne ndërrimeve se i dijshim cilat jonë pasojat, ishte në çdo nivel të shoqënisë kosovare dhe shqiptare. Kështu që me 15 gusht 1990, e maj n'mend në ora tetë e njëzetë... e maj n'mend jo krejt çka ka ndodhë, po ishte përvjetori i martesës së prindërve të mi, me 15 gusht. Edhe motrat e mia edhe unë kishim përgatitë me ditë në ni restorant të ni mikut tonë në Prishtinë me iu bo ni ndejë, me i befasu mamën e babën (buzëqeshë). E kishim përgatitë me lule me sene, kish metë vetëm edhe ni buketë lule që unë kisha me ble rrugës edhe me e çu për tavolinë, edhe pritsha kur kryhet orari i punës, edhe i babës e kthehem n'shpi. Se unë zakonisht e merrsha babën me kerr se me ni rrugë e kishim, babi punojke në Ramiz Sadik, unë punojsha në dispanceri të fëmijëve, edhe u kthehshim në shpi bashkë.

E dojshim me i befasu që mos me u kthy me babën në shpi bashkë, po me shku në atë restorant ku kishim përgatitë se ish përvjetori i martesës, 15 gushti. Po, në tetë e njëzet erdhën diku njo 15 policë edhe e rrethun. Unë isha në katin e parë, atëhere e udhëheqësha repartin për zhvillim të fëmijëve dhe çrregullime neurologjike nëse kishin fëmija të posalindur, në vitin e parë. Edhe e kisha ni fmi, t'u e kontrollu, se orari i punës fillojke në shtatë, kjo ishte ne tetë e njëzetë edhe disa javë përpara, gjithë serbët mjekë edhe motrat e lshun punën. Të gjithë e lshun, edhe nuk erdhën në punë. Edhe kur erdha atë ditë në punë, pe shoh një motër serbe e cila e kishte burrin ni shef në polici afër dispancerit, kish ardhë në punë. Edhe unë u befasova, e kqyra i thash "A je lajmru? Se, kur s'vjen n'punë tri ditë e hup." Ajo m'tha "Ajo vlen për ju shqiptarët, s'vlen për ne. *Za vas šiptari...*" S'bona zo, thash e rregulloj ma vonë, e rahatoj ma vonë, hina se kish shumë pacienta.

Edhe hina, ma prunën ni pacient, ai ni ish-i burgosun politik i Gjilanit, e kish pru nipin, djalin e djalit me kontrollu. Edhe une t'u e kqyrë, kur hini policia tha, "Lsho fëminë, dil prej ktuhit." I thash, "Pse?" Tha, "Duhesh me lshu punën" në serbisht. I thash, "S'e kom dit që policia tash po qitka prej punës." Tha, "Dil jashtë." Thash "Jo, s'po dal jashtë, qitu kom me nejtë. Le të m'vjen vendimi që m'keni largu prej punës, edhe jo prej policisë. Ju dilni jashtë, po m'i tutni fëmitë." Qështu t'u u shty... qikjo Zorica serbja thojke, "Çka iu kom thonë, këta shqiptarkat që punojnë ktu jonë qështu." Shajke diçka, Samka motra tjetër që ish, ajo e zuni derën edhe thojke, "Kjo s'del, kot e keni." Nisëm me u shty kot, do fjalë t'ronda edhe n'fund qëndrova unë. Erdhën do mjekë tjerë shqiptarë, iu thash "Fotografoni" se ishin ardhë me do shlema, t'përgatitun me pushka, ti thu po dojnë me qitë naj terrorist prej atyhit. Thash, "Le t'rrin naj njoni prej mjekëve me m'fotografu, nëse m'çesin," po t'gjithë u frigun, asnjoni s'fotografoi. Kështu që unë qëndrova aty deri n'ora dy, qysh ish orari i punës, ndërkohë m'a prunën vendimin. E n'vendim shkrujke që m'kanë largu prej punës që s'kom qenë tri ditë në punë (qeshë), a

unë isha n'punë. Dhe unë t'nesërmit në ora shtatë... normal ajo ditë, shkova e mora babin prej punës me automobil edhe shkum në atë restorant ku e kishim bo. U ulëm, fillun tash kta me festu. U mbledhën motrat, axhat, të gjithë ishin ardhë edhe po thojnë, "Çka ki ti diçka?" Thash, "O kurgjo, m'largun prej punës me polici." E kishin ndodhë vetëm prej Radio Televizionit të Prishtinës kishin largu, deri atëhere s'kishin largu mjekë. Po n'mramje në televizion dëgjum që s'isha e vetme, kishin pas largu edhe në Klinikë të Kirurgjisë kishin qenë, unë isha e para aty poshtë. Të nesërmen unë u rregullova, prapë shkova n'punë, polici ishte para derës edhe filloi... njo tre-katër policë fillun me më ndjekë. Edhe masnesër prapë, une e bona si shprehi tash u bo argëtuese, çdo mëngjes në ora shtatë u veshësja, u rregullojsha e shkojsha n'punë.

Para derës dilke polici, thojshin "Na t'rrafim" deri diku kur kolegët e mi, qata që ishin në punë, nuk e largun askënd, veç mu prej punës, m'thanë "Mos eja me na bo fesatë." Kur u bonë protestat sindikale të tre shtatorit, mandej edhe ata i largun prej punës. E prej 15 gushtit deri me tre shtator, vetëm mu. E nuk e dijsa nihere pse, pata çu disa peticione që fëmijëve, aty u bojke regjistrimi i emrave të fëmijëve se si osht gjendja shëndetësore e fëmijëve. Prej atyhit e merrshim vaksinën, e shkojshin në Komunë me u regjistru. Edhe motrat serbe kishin marrë urrdhnesë iu edhe shkrujshin në sirilicë fëmijëve, iu deformatojshin. Kështu që, une protestova për atë, kërkova që emrat e çdo fëmiju me i shkru në origjinal, nuk përmena as gjuhë veç thash në origjinal. Drejtoresha ma çoi policinë edhe shefi i cili ishte shqiptar, drejtoresha ish serbe, e shefi i repartit të fëmijëve ishte shqiptar. Erdh policia ni ditë e malltreti aty para pacientave, para se me më largu prej punës. Për shkak t'saj, n'fund edhe shefi shqiptar edhe kjo m'thanë, "Po kjo osht e familjes anti-jugosllave, kjo osht nacionaliste," blla-blla, kështu që edhe mjeku shqiptar që ish shef u bo dyfish. S'guxojke me më kqyrë në sy e thojke {ndërron tonin e zërit}, "Nëse gabon edhe nihere e largojmë. Nihere veç po ia nalim këtë mujë rrogën."

Kështu që i erdh fundi, më largun prej punës, m'largun me 15 gusht, mandej me tre shtator i largun edhe të tjerët për shkak të protestave, kështu që unë meniherë në nëntor fillova me punu si vullnetare për Nënë Terezë. Fola me Don Lushin e bacën Jak edhe shkova me punu atje, por një ditë punojsha si pediatre, e tri ditë punojsha ma shumë logjistikë. Mbledhsha mjete, iu shkrujsha projekte për me nxjerrë të holla, i shkrujsha raporte çka vijshin, bojsha gjithëçka. U lidhsha me Caritas-in e Vienës, me Caritas-in e Firences, me krejt botën për me pru... Në t'njëjtën kohë, një ditë punojsha në Këshill për të Drejtat e Njeriut, një ditë punojsha si pediatër, në Nënë Terezë punojsha si gjithëçka. Kështu që, praktikisht prej nëntorit '90-shit deri '92-shin kur e kom nisë Qendrën për Mbrojtjen e Grave e të Fëmijëve, kom punu vullnetarë në kto vene. Praktikisht, punojsha dikur prej shtatëve derisa bijke terri, se me bo me nejtë ma vonë, s'guxojshim me dalë në rrugë. Në Këshill për të Drejtat e Njeriut shpesh ndodhke që duhej me nejtë ma vonë, me shkru raporte kur ndodhke diçka. Mas pari një informatë për një cënim të të drejtave të njeriut, duheshim me shku me marrë dëshminë origjinale, se shumë raste vijshin aty. Por kur nuk vijshin aty, për shembull ishin të ndonjë fshati, ose kur e shihshim që osht një tendencë, që nuk osht rast i izolium, po osht një kampanjë, një territor, atëhere u shpërndajshim e merrshim dëshmitë direkt. Mandej, duhej ni ditë me i përpunu dëshmitë, me i qitë në kompjuter, mandej me i raportu kështu që, ishin kto punë.

Gjatë asaj kohe, me të vërtete kemi përjetu gjithëçka, kemi pa gjithëçka, po çka maj në mend... mu m'bojshin përshtypje jo vetëm dhuna që ushtrojke Serbia, po m'bojke përshtypje me nifar mënyre edhe mohimi i të drejtave që e bojshin popullata tjetër ndaj grave. Për shembull, raportet që i bojshim për Këshill për të Drejtat e Njeriut, kurrë nuk n'a lejojshin me e shkru emrin e gruas, po e shkrujke filan fisteke... jo emrin, po NN gruja e dikujt, ose NN vajza e dikujt. Me vjet na që kemi punu në Këshill, sidomos femrat që kemi punu, gratë kemi luftu me të tjerët që me shkru emrin, ajo ka identitet, e dojshim, të ia shkrujmë emrin... Vjosa, jo Vjosa vajza e Musa Dobruna, po Vjosa Dobruna, jo dikush tjetër. Ajo ka qenë asi rezistence me l emënu gratë për çkado, jo vetëm për rrafje e plagosje, jo vetëm për dhunime, po për çfarëdo mohimi ose cënimi i të drejtave të grave. Gjithmonë u merrke, u shënojke në raport mashkulli, nëse ishte femra ishte një kolaterale një dëmtim kolateral, edhe që dhunimi ose cënimi i së drejtes nuk iu bojke asaj, por iu bojke këtij mashkullit. Kështu që ishte një kohë që unë e ndisha shumë të vështirë, une e bojsha raportin ditën që e kisha caktu, e që jom kujdestare e bojsha raportin. Shkojsha e merrsha dëshminë e ia shkrujsha emrin gruas, kur vijsha ma hekshin emrin. Po jo vetëm unë, të gjitha gratë që ishin në Këshill, që ishin vullnetare në Këshill, të gjitha e kemi pas të njëjtin problem, të gjitha luftojshim. Kështu që ky rast, edhe në Nënë Terezë e shihsha që unë pe boj një punë, unë jom mjeke osht obligim i jemi, unë jom pediatre, unë duhna me i bo. Po, na nuk bojshim kurgjo me i ngritë vetëdijen atyne grave. E bojshim ni punë rutinë, i kqyrshim fëmity, i kqyrshim gratë edhe i lshojshim me shku në shpi, po na nuk bojshim kurgjo për gjithë dhunën që u ushtrojke ndaj tyne.

Për shembull, mu m'ka ndodhë me m'vdekë fëmity në dorë, e unë kurrë, unë jom 31 vjet mjek tash, mu kurrë nuk m'ka ndodhë me më vdekë fëmity, e unë mos me qajtë. S'kom mujtë me u msu, kurrë! Ose, me e pa fëminë që osht në dhimtë të madhe, e une mos me qajtë, nganiherë më nevojitet ma shumë ndihmë mu. E maj në mend ni rast kur erdh ni gru e cila e kishte burrin në Gjermani, ato e kish kthi Gjermania s'ka pas dokumente. Ajo kish qenë e martume shumë vjet, e mas nëntë vjete ka mbet shtatzanë. Kur ka mbetë shtatzanë, e ka kthi Gjermania, ajo rrike me vjehrritë. E kish bo një vajzë shumë të bukur, kish lind po fëmity ish smu. Vjehrritë nuk e kanë lon me dalë prej fshatit, me ardhë me pru te mjeku, "Se po t' dhunojnë policia serbe." Dhuna e cila u ushtrojke në përgjithësi, te gratë ishte dyfish, sepse dhuna serbe tash u manifestojke edhe ish ni arsytim tjetër për me limitu, kufizu lëvizjen e grave, edhe pse gratë e majshin këtë vend, e majshin këtë Kosovë, burrat ishin jashtë. Kështu që ajo gru e pruni fëminë para vdekjes, e pruni veq me m'vdekë në dorë. Unë qashtu u tmerrova kur më tregoi pse s'e ka pru. I thashë, "Pse s'e ke pru me vakt?" Tha, "Nuk m'lshojshin vjehrritë me dalë." Aq shumë u tmerrova, sa ma shumë qajsha se ajo gruja që i vdiq fëmity edhe nuk ia lshojsha fëminë prej dorës. Ksi raste ka pas të shumta, sa iu kufizu liria e lëvizjes grave prej familjeve, jo vetëm për shkak të patriarkatit në familje sidomos në familje rurale. Por, tash t'u e shfrytëzu represionin serb, e betonun gruan. E për atë kërkush nuk dojke me raportu, askush s'dojke ne me punu në atë punë, kto ishin arsytet pse unë vendosa me hap Qendrën. Se, na po iu ofrojmë servise, po i ofrojmë mjekim, po i ofrojmë një prehje, po i ofrojmë ndihma me Nënë Terezë, po na nuk i ofrojshim nifar përkrahje, nuk shkojshim nëpër fshatëra me folë me ata njerëz nëse qito gra po e majnë qit shoqni, po e majnë

n'komë, po e majnë gjallë këtë shoqni, atëhere... edhe nëse nuk e majnë gjallë, e kanë të drejtën e lirisë. Nuk mundesh me e shfrytëzu represionin serb, me e thellu ose me betonu patriarkalizmin të cilin ishte në familje.

Ndoshta, nuk ishte aq vështirë me e bo, ishte vështirë me e nisë; mandej me e zhvillu nuk ka qenë problem i madh. Me nisë ka qenë vështirë se partitë politike ekzistente atëhere të gjykojshin. "Kush mirret me të drejtat e grave, kur na kemi represionin e po na vrasin për çdo ditë..." Edhe e kishim shumë vështirë, unë e mbaj nërmend disa biseda, ni seri të bisedave me Ibrahim Rugovën. Presidenti thojke, "Çka je ka bon? Ti je ka e ndanë shoqinë. Në vend që ne me qenë fronti i përbashkët kundër Serbisë, ti po hin e po bisedon për të drejtat e grave." Thojsha, "Të drejtat e grave nuk po cënohen vetëm prej Serbisë, na e largojmë Serbinë. Po, po cënohen edhe prej familjeve tona e po cënohen prej gjithkujt. Po i vdesin grave fëmitë, ose po vdesin gratë... A din sa gruja ka vdekë me vjetë prej gjakderdhjeve!" Nuk osht puna pse nuk kanë pas ku me shku, se ki pas plot klinika që kanë mujtë me i ofru ndihmë, po nuk mujshin me dalë. Sidomos prej fshatërave, ajo ka qenë katastrof, une për ato po thom Drenica edhe Llapi jonë çliru dyfish, trefish mas kësaj luftime. Pas luftime iu dha ni liri tjetër, iu çliru edhe familja edhe fitun disa të drejta të cilat kanë qenë natyrale me ekzistë, por ato të cilat nuk kanë mujtë me i përjetu për shkak të patriarkalizmit kosovar. Askund [në botë] nuk ka qenë gruja e shtypun edhe e dënume, edhe nuk kanë faj, në fshatëra i kanë thirrë gratë "rob," "rob të shpisë."

Edhe ato kanë qenë "rob" kështu që idea për Qendër, kto gjana kanë qenë që m'kanë pru... po menoj nuk ka qenë ni klik [kërcet gishtat]. Gjitha këto eksperiencia që i shihsha, edhe ishin dy alternativa, ose t'a hapi një ordiancë private edhe t'boj pare. Kjo ish ni alternativë. Tjetra ishte, ajo që ishte më afër natyrës time, t'a hapi një qendër ku mund edhe të iu ofroj qito shërbime që po i ofroj në Nënë Terezë, ose po i ofroj t'u shku në terren. Po, në t'njejtën kohë t'a dokumentoj këtë, t'a bojmë një vetëdijësim, një edukim të grave, sidomos, në pjesët rurale për të drejtat e tyre. Na e dijmë që dikur kjo luftë ka me u kry. E dijmë që dikur Kosova s'ka qare pa u çliru. Pavarësia osht diçka tjetër. Po me u çliru... Unë e dijmë që qato gra nuk kanë me u çliru nëse dikush nuk iu ndihmon. Kjo ka qenë idea mrapa hapjes së Qendrës, që gratë të kenë një vend prej të cilit na kemi me zhvillu aktivitete, edhe prej atyhit kemi me shku dikah edhe ato kanë një vend ku mujnë me ardhë. Ka raste kur ato as nuk kanë qenë të vetëdijshme që po iu cënohen të drejtat e njeriut. [Gratë thonin,] "Ah, domethanë me m'a ndalu, s'ka të drejtë a?" "Po, jo nuk ka t'drejtë me t'tregu ty kur me dalë prej shpisë, ose kur don me i çu fëmitë e smutë te mjeku, ose ti ki gjakderdhje e don me shku te mjeku. Nuk osht marre! E ki të drejtë me shku me u mjeku." Domethanë këto kanë qenë problemet që në atë kohë, po flas fillimi i viteve të '90-ta. Kanë qene aq akute, aq te akumulume, që ka qenë çudi që dikujt tjetër nuk i ka ra nërmen me bo. Po qe, pasi që unë veç isha t'u punu, m'u kujtu edhe e realizova fillimin, e themelova Qendrën për Mbrojtjen e Grave e të Fëmijëve dhe fillim me punu me ta. (Buzëqeshë)

Pasi që më largun prej punës si pediatre në dispancerin e fëmijëve, fillova me punu edhe për Nënë Terezë, si ju thashë. Edhe punojsha në Qendër me Dom Lushin edhe të tjerët në Nënë Terezë. Po, njëkohësisht punojsha edhe për Këshillin për [Mbrojtjen e] të Drejtat e Lirive të Njeriut. Fillova me i

vërejtë dallimet që u bojshin në raportime për gra, por vazhdojsha me bashkëpunu me grupet e grave dhe individë prej ish-Jugosllavisë. Pretendojshim, besojshim se nëse njëfemi ma shumë, nëse bashkëpunojmë ma shumë, e kishim bashkëpunu mjaft gjatë luftërave të ndryshme që fillun në Kroaci, e mandej në Bosnje, që mujmë së paku me prevenu, së paku luftën në Kosovë.

Në Kosovë ekzistojke një lëvizje paqësore e udhëhequr nga zoti Rugova, presidenti Rugova pastaj, e cila rezistencë sa ishte e bukur nga jashtë. Edhe për herë të parë ndodhke në Ballkan që ndaj një represionit të shkallës të tillë, të cilën e kish ushtru pushteti serb ndaj shqiptarëve në ish-Jugosllavi... ishte shumë e bukur si ide dhe si lëvizje në Kosovë ishte shumë e randë.

Personalisht për mu ishte lufta kur filloi, ishte nifar... fatkeqësisht, nifar çlirimi. Ato vite të apartheidit kanë qenë shumë të mundimshme. Për shkak se, ishte në kambë edhe dinjiteti i çdo personit në Kosovë. Beso, nuk ishte vetëm frika se në një moment fillum me hupë atë frikën, se praktikisht s'kishim çka me hupë mo. Po dinjiteti që të nënçmojshin çdo herë, për çdo gja. E maj në mend në Lakrishte dy fëmijë janë përta, ni fëmijë shqiptar e ni fëmijë serb. E murën babën e fëmijës shqiptar, e fëmija shqiptar s'kish ba asgjë, veç ish mbrojtë. E murën, e burgosën, e malltretun, edhe ne raportojsim për Këshillin e të Drejtave të Njeriut. Ose shumë raste të tjera, une e mbaj në mend, njëhere e kisha mbesën time në automobil edhe e dijsha që sa here të më ndalë policia me automobil, pa ta mshu me pendrek në kokë, ka qenë e pamundun diçka me bo. Edhe e luta policin pasi që më ndali, "T'lutna mos ma msho në kokë ose diçka se e kom mesën mrapa. Edhe mos ta përjeton gjuhën, mos ta përjeton keq, mos të krijohet një urrejtje te ajo." Edhe e befasova policin, edhe për herë të parë që m'kanë ndalë edhe nuk ma mshoj me pendrek në kokë {lëvizë kokën mrapa si të ishte goditur}, ose në qafë ose diku. E luta që mos... "Qe dokumentat, t'lutem."

Po thom, ka qenë qaq e padinjitetshme me jetu në Kosovë në ato vite, që nuk ka fjalë që mundet me e shpjegu, nuk ka fjalë. Prapë po mendoj, përderisa nga jashtë na adhurojshin për durimin, mrena në Kosovë kishte nevojë për një aktivitet i cili do t'i jepte nifar ventili frustracionit të popullatës. Se ish bo e padinjitetshme me punu në Kosovë dhe fatkeqësisht u vërejt se vetëm gjaku kur derdhet, komunitet ndërkombëtar do të fillojë me u marrë me Kosovën. Edhe pse, gjithë konflikti në ish-Jugosllavi kish fillu me protestat e shqiptarëve për liri edhe për barazi, jo për pavarësi, po për barazi me popujt tjerë të Jugosllavisë. Mandej, edhe në vitin 2001-2002 me partinë parlamentare kishim organizu shumë protesta, të cilat çojshin mesazh se na jemi për ni rezistencë, po jemi për ni rezistencë aktive. Jo rezistencën pasive të cilën presidenti Rugova e promovojke se erdh ni moment kur u paralizum krejt prej asaj frike, kur nuk u ndërmerrike asgjë mo. Kur u bo legjitime për çdo individ serb me vra, me dhunu, me ta marrë pronën, edhe ti mos me guxu me reagu. Jeta në Kosovë ishte shumë e padinjitetshme, shumë e padinjitetshme dhe grupet e para të UÇK-së veç ishin formu, po nuk ishin të lidhura, po u ndëgjojke nëpër popull, edhe iu dha zemër qytetarëve. Duhet me thanë se edhe grupet e para edhe ma vonë, me formimin e UÇK-së, UÇK-ja kurrë nuk i sulmoi individët, civilët serbë.

Të gjithë ata që jonë sulmu me sulmet e para, ishin njerëz të lidhur me pushtetin, njerëz që ushtrojshin represion ndaj popullatës shqiptare të Kosovës. Bile, ne me grupet e grave të ndryshme ishin ardhë

disa mikështa tona prej Izraelit, prej Jerusalem me të cilat bashkëpunojsha unë. Shkun niherë në Beograd, mandej erdhën me na vizitu në Kosovë. Po thojnë, "Si është e mundun?" se e panë vetë çka po ndodhë. "Si është e mundun që gjithë kjo popullatë, e asnjë nuk u zhvillu terrorizmi në Kosovë? Si nuk po dilni, shiptarët e Kosovës, jashtë Kosovës e me zhvillu aksione, si është e mundun?" Ashtu, ka ekzistun nifar dicipline edhe homogjenizimi në popullatën shqiptare në Kosovë dhe përreth në Serbi Jugore, a si po i thojnë tash Kosovë Lindore.

Në Maqedoni ka qenë e pamundun. Ka qenë një diciplinë edhe ka qenë një vullnet. Nuk osht frika, se tash flitet që ka qenë frika prej ushtrisë serbe, se ka qenë e katërta ma e zhvillume në Europë. Jo, jo. Ma shumë ka qenë ni diciplinë edhe ni vetëdije se kështu po i thejmë disa tabu. E ni tabu ishte se shqiptarët gjithmonë reagojnë në mënyrë të dhunshme me armë, se kjo ishte propagandë e cila me 50 vjetë Serbia kish propagandu në botë. Kjo ishte ni befasi shumë e madhe, po ishte shumë vështirë me e mbajtë. Prandaj, çdo aktivitet që u bojke në Kosovë që e rezistojshim, se për ne ishte rezistim, një raportim për dhunën ndaj grave, ishte rezistencë me iu ofru siguri grave ose qytetarëve civilë në Kosovë. Ishte rezistencë me zhvillu sistemin e edukimit, sistemin e arsimit. Ishte rezistencë mos me lon askënd në mes të kosovarëve pa bukë, ishte rezistencë. Ishte një rezistencë e cila nuk ia mbushke syrin Serbisë, dhe nuk e bijke Serbinë në një moment, kur na shifke si të denjë, të dialogojmë për të ardhmen tonë. Prandaj, çdo aktivitet që ndërromrën gratë, krejt popullata, po kryesisht aktivitetet e rezistencës masive jonë organizu prej grave.

Protestat për Drenicën jonë organizu, jonë fillu në Qendrën për Mbrojtjen e Grave dhe të Fëmijëve, osht iniciu. Ne i kemi thirrë grupet e grave edhe të partive politike. I kemi thirrë edhe kemi organizu, idea ka qenë... duhna me e pranu që idea ime ka qenë që të mos shkojmë vetëm me një bukë kur u mbyll Drenica, po t'shkojmë edhe me një paketë të peceve higjenike. Por pasiqë gratë e partive politike kanë bisedu, të nesërmen para se me u nisë thanë, "Jo, nuk bon." Se na shkumë me ble peca higjenike... "Nuk bon, nuk bon!" Se, me folë për "seksualitetin" {bën thonjëzat me duar} ose për reproduksion, ose diçka të grave, ishte gati e turpshme. Prandaj, nuk na lejun, u kriju nifar atmosfere që u mendojke që nëse e bëjmë protestën si të tillë, do t'a tërhekim vërejtjen prej qëllimit primar që osht me liru mbylljen e Drenicës që ish bo.

Mandej, protestat, jo vetëm atje po edhe shumë protesta të tjera, para organizatave ndërkombëtare të cilat punojshin në Kosovë; që ishin kryesisht si Komisariati i Lartë për Refugjatë, i cili nuk i ndihmojke popullatës kosovare edhe pse ishin të zhvendosur prej shtëpive të veta, ato u mirrshin vetëm me refugjatët prej Kroacisë të cilët i kishin pru serbët me trena pas operacionit "Olluja" në Kroaci. Nuk iu ndihmojke popullatës shqiptare, po pse të gjithë ishin nëpër male. Ne grupet e grave shkojshim në malet e Berishës, në Pagarushë, në vendet tjera në Dragobil, dhe iu ofrojshim ndihma me sa mujshim. Prandaj, ka qenë ni situatë mjaft sfiduese... nuk mund të them që ka qenë e vështirë sepse në atë moment, po edhe tash kur ta shiqoj, ka qenë pjesë e natyrshme e punës tonë. Ne jemi pjesë e kësaj popullatës dhe kemi marrë guximin me bo diçka, osht obligim i jonë. Edhe si qendër ishte obligim i joni me iu ndihmu njerëzve, jo vetëm grave dhe fëmijëve, po gjithë njerëzve. Kështu që, kto ishin ato

vitet e '90-ta që ishin, po në t'njejtën kohë prej punës që bojshim këtu, shumë punë bojshim edhe jashtë. Kemi bashkëpunu me të gjitha grupet e grave e ish-Jugosllavisë, por edhe jashtë.

Po në vitin 1992, kur vetëm kisha fillu me kriju një grup të puntorëve që kryesisht punojshin me profesion mjekë, doktora; dhe shkojshim nëpër fshatra anë e mbanë Kosovës dhe jo vetëm me iu ofru servis me mjekë e shëru, por mbajshim edhe ligjerata, në rast të sulmeve të policisë, çka me bo në raste të dhunimeve masive, si me u mbrojtë, si me u mbrojtë mbas.... dhe gjana t'tjera. Promovojshim vaksiminim e fëmijëve, promovojshim mbrojtjen prej helmeve kimike, kishim eksperiencë nëpër shkolla, e paralele si ishin gjujtë helme të ndryshme, kështu që kryesisht u bojke kjo. Në fund të janarit me 1992 dhe në fillim të shkurtit, gratë e Italisë e organizun një konferencë. Konferencë në kuadër të projektit i cili u thirrke "Urat e Grave në të Dy Anët e Adriatikut," "*Ponte di donne acontre confini*," kufijëve, u mendojke dy anët e Adriatikut. Edhe idea gjatë asaj konference në janar që vazhdoi mandej në shkurt, ishte që të krijohen disa qendra, gratë të cilat ishin aktive në shoqëri të krijojnë disa qendra në ish- Jugosllavi.

Atëherë veq ishin nda, një në Zagreb, një në Prishtinë, një në Tuzëll ku ishin shumica e refugjatëve prej Srebrenicës që e kishin mbijetu masakrën, gjenocidin e Srebrenicës, dhe njo në Pançevë, Serbi në Vojvodinë. Kështu që, u vendos që të gjitha së bashku të mbledhim fonde, dhe të krijohen këto katër qendra, të cilat do të jenë si pika referente të bashkëpunimit të grave të ish-Jugosllavisë dhe të cilat do të përkrahen nga *Centro delle Donne di Bologna*. Kështu që u bo edhe donacionet e para i fitum në Bolonjë ku gratë e Bolonjës u mbledhën dhe shitën bileta nëpër qytet dhe ni shqiptar i Shqipërisë i cili ishte pronar i ni kinemasë në Bolonjë, Cine Fossolo, Eqrem Maqi e lshoj kinemanë pa të holla dhe performun artistë të njoftun italianë. E prej atyne të hollave që u mbledhën, ne blemë barna, gjana të nevojshme për me fillu Qendrën, ato ishin donacionet e para që u mbledhën. Pastaj, gratë e Bolonjës u organizun me një organizatë jo-qeveritare italiane e cila merrke donacione prej fondeve europiane që t'i ndihmojnë këto katër qendra. Kështu që mandej kishim një reprezentues italian, i cili punojke në Prishtinë edhe ishte nifar mbrojtje për ne. Kështu që, na vazhdum me punu pa pas ni zyre t'caktume. Po punojshim, u mbledhshim në Nënë Terezë edhe kishim mbrojtje prej Nënës Terezë.

Kjo ishte shkurti i vitit 1992, në shtator të vitit '93, grupit iu bashkangjit edhe ni gru fantastike e Prishtinës, Sevdije Ahmeti e cila filloi me dokumentu punën tonë se çka po bohet. Kështu që tash nuk raportojsim individualisht po bojshim raporte për të drejtat e grave në Kosovë. Dhe ma vonë e gjetëm një objekt ku filloi puna dhe ku fillum me zhvillu aktivitete ma t'gjana jo vetëm shëndetësore, jo vetëm edukimi shëndetësor, por organizum e ushtrojshim, përgatitshim studentët për demonstratat e mëdha. Qysh me u mbrojtë prej helmeve, qysh me u mbrojtë prej sulmeve, u kriju ni vend ku mbledheshin të gjitha grupet e grave; po jo vetëm grupet e grave në Kosovë. Praktkisht si Qendër na ishim thjeshtë e para n'Kosovë si organizatë jo-qeveritare. Motrat Qiriazhi kishin fillu me punu, por Motrat Qiriazhi ishin vetëm për arsim edhe në Has, edhe ishin të përzim gra e burra. Qendra për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve ish grup për gra edhe fëmijë dhe për shkak se ne raportojsim për gjendjen e të drejtave të njeriut, krijum një rrjetëzim të madh ndërkombëtar në krejt botën.

Prej Koresë së Jugut, Filipineve, Japonisë, Afrikës Jugore, Algjerit, Shteteve të Bashkuara të Amerikës normal, Ekuadorit, Kanadës, Norvegjisë, Italisë normal. Gratë italiane për Qendrën kanë qenë si motrat, për çdo nevojë... për shembull ni herë kur në vitin '97, ishin do sulme, kish luftë, kishin sulme në të dy anët, po ishte ni gjendje shumë e randë sidomos në Drenicë. Edhe, kishim raste të shumta të raportimit për dhunime por kishte edhe raste të shumta edhe të raportimit të gjarpërinjëve, paraqitjes së gjarpërinjëve prej disa detonimeve që ndodhën.

Edhe ne ishim blloku komplet, nuk kishim për shembull serum antiviperin, edhe gratë e Italisë në trup kanë ble. Iu lajmrova, kanë ble serum edhe jonë ardhë nga aeroporti i Shkupit, edhe kanë ardhë, jonë hi në Kosovë, edhe na kanë pru. Edhe na shkum mandej në Drenicë, edhe jepshim seruma edhe vaksinojshim të gjitha i bojshim, edhe kishim një ekipë fantastike të grave.

Vetëm gjatë vitit, prej vitit '98, për shembull prej 12 tetorit 1998, që e kemi dokumentu deri me 25 mars 1999. Grupi jonë prej Qendrës për Mbrojtjen e Grave dhe të Fëmijëve ka shku në terren, në territore të luftës 175 herë për dy vjet, nuk ka pas të shtune, të diele. Edhe kemi pas kriju tri qendra të mëdha ku i lejshim barnat edhe mjete të ndryshme: një ka qenë në Sedllar, tash thirret Shalë në familjen Shamolli; një ka qenë në Bellaqevc, në Bardh të Madh në familjen Krasniqi; një ka qenë në Pole, në regjion të Dukagjinit, në kishën katolike (buzëqeshë) te priftët e kishës katolike. Dhe, i lejshim materialet atje mandej kur shkojshim, krejt territori na raportoishin, cili vend ka nevojë, cila familje, ku jonë të mbledhun të zhvendosurit edhe shkojshim aty. Ose na lajmrojshin, ose kishim lindje. Kështu që ka qenë një ekipë fantastike, Sanija, Sevdija, Samka, Meli edhe Fatlumja që ka qenë kontabiliste që i majke librat, praktikisht, edhe Fatlumja vijke në terren se të gjitha duheshin me fotografu, me dokumentu. Mandej, me raportu... Sevdija raportoijke, ajo ka qenë ni punë ekipore fantastike.

Ka pas raste për shembull, shkojshim ni herë në Drenicë, e shkojshim në malet e Berishës e na raportun se kanë djegë një familje krejt edhe kanë mbetë mbetjet e familjes, kanë mbetë jashtë. Një burrë i paralizum edhe ni inxhinier i bujqësisë i cili kishte qëndru me babën, e kishin lon... e shkum na me fotografu, po kish edhe shumë të smutë. Shkum në malet e Berishës, po rrugës t'u shku edhe kishim dy gra që kishin me lind na raportun që kishin me lind. Kështu që, Sanija, Selimja edhe na trija ishim në automobil, edhe prej xhamisë në Komoran, osht ni xhami edhe rrugës për me shku në malet e Berishës, ishin hyp snajperistat serbë në xhami edhe gjujshin. Nuk na gjujshin direkt neve, po gjujshin te gomat afër me na frigu. E po thotë Sanija, "Mori Vjosë, na po shkojmë me i shpëtu, noshta ni njeri a dy njeri, veç na po lojmë bukur do jetima!" Sanija i kish vetë tre fëmijë, Samka kish një, Selimja i kish tre a katër, nuk po m'kujtohet. Tha, "Na po shkojmë me I ndihmu njo a dy, po na po lojmë shumë fëmijë jetima ktu." Po kurrë, kurrë nuk ka thonë "Jo", kurrë.

As nuk e kemi diskutu që duhet me shku ose s' duhet me shku, ose na kemi shku. Kemi shku edhe gjithmonë kemi pas raste t'u shku në Pjetërshticë një herë, n'a lajmrun që një gru ka fillu lindjen edhe ka gjakderdhje shumë të madhe, ishte e zhvendosur diku prej Prekazit. E na t'u shku e kalum Sedlaren edhe po nisem për Pjetërshticë, po na thojnë ushtarët e UÇK-së që osht rrezik, mos shkoni. Osht

gruja t'u vdekë, na duhet me marrë diqysh atë gru me shpëtu.... "Mos shkoni!" Po s'ka qenë ndoshta 50 metra prej ne, na ka pa ushtria serbe edhe e gjujtën ni granatë, edhe u hap ni krater.... po prej frikës, ndoshta nuk ka qenë shumë i madh, po na u shtangëm në automobil. Na gjujtën, na e lam automobilin, e skajum te do drunjë edhe vazhdum n'komë. Edhe shkum, e me ni plaf. Ishim katër, tri edhe Mevlydja prej Sedlare-it, prej Shalës ku i lejshim barnat. Shkum e bajtëm atë gru me... e i kishim edhe njo dy kilometra me mrrri në Pjetërshticë kur na gjujtën, e bajtëm me ni plaf të katërtat. Edhe tash mo s'mujshim në automobil se ka qenë ni pandë e vjetër që na patën falë italianët, edhe ngadalë e çumë në Prishtinë me Selimen edhe Samkën. Edhe e çumë në "Nënë Terezë" edhe shpëtoi, ka shpëtu ajo gru, edhe e ka lind fëminë. Na u kthym në komë deri në Sedlare, Shalë edhe për me pritë, ose me u kthy kerri ose diçka me bo, me ecë n'komë me dalë në rrugë kryesore për me u kthy n'Prishtinë gjithqysh me dalë.

Kemi pas raste të ndryshme por përveç gjatë luftës, efekti i Qendrës ka qenë që jonë ndëgju zanat, jonë ndëgju çka gratë po dojnë. Edhe gratë kanë tregu ni aktivitet jo vetëm si ni pjesë e rezistencës, se ka qenë shumë vështirë me i qitë përpara çashtjet e grave në ni situatë ku të gjithë ishin në represion. Kemi pas raste kur vetë partitë politike na kanë bo problem. Në vitin 1994-1995 patëm ni training me Minnesota Advocates of Human Rights, dhe pas trajnimit me ta në Sofie, organizum ne me i bo 20 punëtori në Kosovë, me i spjegu grave të drejtat e grave.

Edhe pas... në serinë e parë 20 ishin njoftim, në roundin e dytë, në rrethin e dytë të trajnimeve të punëtorive. Pas ni spjegimi iu dhamë do pytsorë diku 1280 grave prej krejt Kosovës, në secilin qytet, fshat, territore të ndryshme të Kosovës me plotësu formularin, me shiqu si osht çashtja e të drejtave të grave edhe dhunës në familje sidomos. Ka qenë e tmerrshëme rezultati, e tmerrshme... gjatë punëtorive çka gratë n'a kanë pytë, "Domethonë, edhe unë me gabu s'ka të drejtë burri me m'rrehë a?" Ka pas gjana të ndryshme, e vetëm në Prizren s'kemi mujtë me marrë, se partitë politike në Prizren, LDK-ja atëhere, zhvilloi praktikisht ni kampanjë kundër ne edhe jo kërcënu, po iu dha vërejtje grave që në këtë situatë kur jemi ne këtë represion, edhe nuk guxojmë me tërhek vërejte prej represionit të përgjithshëm të apartheidit dhe me adresu çashtje të cilat nuk janë primare. Për ne ishin primare, sepse grave nuk iu mundësojke liria e lëvizjes, e fëmitë vdisnin, ose vdisnin gratë prej sëmundjeve të cilat mujshin me u evitu, mujshin me u parandalu, për ne ish ajo e rëndësishme. Për partitë politike në Kosovë, sidomos për LDK-në, ishte nifjar thymje e atij unitetit të mrendshën që u projektojke gjithka edhe fillun me na akuzu.

Bile, nji rast, njëri prej liderëve politikë ma tërheki vërejtjen me nifjar manifestimi tha, "Vjosa, çka je t'u bo me gra nuk osht patriotike." Edhe m'kish thirrë si përfaqësuese t'ni organizate ndërkombëtare, u dasht me ia shpjegu që Qendra për Mbrojtjen e Grave të Fëmijëve nuk osht organizatë ndërkombëtare. Po, osht e regjistru me në Bolonjë sepse ka qenë nifjar mekanizmi mbrojtës ndaj pushtetit serb, e në Kosovë ishte zyrtarisht si pjesë e organizatës Nënë Terezë. Na i kishim dokumentet e nënshkrume prej drejtorit të atëhershëm ekzekutiv Jak Mitës, edhe prej meje si drejtoreshë edhe themeluese e Qendrës për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve.

Kishim dokument të regjistrum me të cilin me nifar mënyre e legalizojshim si degë e “Nënës Terezë”, e mujshim me punu. Në Itali, ishim të regjistrum në Bolonjë si katër qendra, pjesë e projektit. Kështu që, kishim nifar mbrojtje, nifar ombrelle, po ajo nuk thojke shumë te mashkujt tonë. Se, nuk e shifshin si të vlefshme edhe ka pas mjaft raste kur politikisht na thirrshin në përgjithësi. Një herë n’fillim, unë shkojsha kur m’thirrshin, mandej fillova me i injoru komplet.

Sevdija ishte e përshtatshme, se bojke raporte, edhe Sevdija shkojke se ishte ma gru pak ma e vjetër se une, kështu që shkojke dhe bisedojke me ta. Edhe, praktikisht ajo i majke lidhjet me LDK-në. Unë në atë kohë veç komunikojsha, po në baza të ndryshme. Ata pritshin që OJQ-të me lyp leje prej tyne për çfarëdo aktiviteti, jo vetëm për protesta.

Mandej, kur filloi UÇK-ja me dal me asi, e njëjta situatë erdhi. Shkojshim në terren, për shembull na ndalke UÇK-ja e thojshin {ndërron tonin e zërit}, "Ku po shkoni? Hajde t’i kontrollojmë barnat. Kush iu ka dhonë leje me hi n’territor tonin?" Për shembull ni herë në Malishevë na patën ndalë, edhe s’lejshin me shku. Na kishim rastin, kish ndërhy ushtria në Rahovec edhe gjithë u bartshin popullata, u shpërngulshin për Malishevë. Kishim hy në Malishevë, rrugët tona që i dijshim për me i ndihmu popullatës. Atëherë isha vetëm unë me automobil, se nuk dashta me rreziku gratë t’ tjera, po kisha edhe ni aktiviste angleze me veti.

Shkum në spital të Malishevës, edhe praktikisht veç trajtojshim të plagosun me drejtorin e spitalit të Malishevës. Por, ma vonë erdhën do ushtarakë të UÇK-së edhe pa vetë kush jom fillun me, "Kush t’ka leju me hi mrena ty ktu në territor tonin? Ku ki lejen e Adem Demaçit, ku e ki lejen e shkrome?" Derisa m’kërsiti filmi e i thash, "Largohu, unë quhem Vjosa Dobruna edhe nuk po e legalizoj që ti je autoritet ktu. Se sa je ti n’vend tondin edhe unë jom n’vend temin. Sa ki t’drejtë ti, edhe une kom t’drejtë, kështu që mos m’u afro mo". Edhe pse veç sa kishim bo disa lindje, disa fëmijë kishin vdekë, ni gru n’a vdiq... po meno j ish ni situatë katastrof. E ata kishin ardhë e thojshin, "Kush t’ka dhon leje ty me hi në asi?" Domethon, si gra ka pas shumë dyshime.

Më duhet me pranë që në Rrafsh të Dukagjinit, kurrë s’kemi pas problem, kurrë, kurrë, kurrë! Të gjitha kishat që kanë qenë, kanë qenë të hapura për ne. Ne kemi lon barnat aty, kemi lon gratë me lind nëpër kisha. Edhe në Binqë, e kemi pas vendin edhe pse ka qenë... edhe kondoma bile kemi çu. Edhe motrat françeskane i kanë rujtë barnat për ne, i kanë mbledhë pacientat. Edhe kemi shku gratë, të keqtrajtume kemi shku në ni kishë të Binqës i kemi trajtu. Gjithashtu, kishën e Nepoles e kemi trajtu, kishë te Klina e kemi trajtu, në Rrafsh të Dukagjinit kurrë nuk kemi pas problem prej UÇK-së, kurrë. Ramush Haradinaj n’a thirrke me i ushtru, me iu majtë ligjerata grave për sëmundje seksuale. N’a ka thirrë, kemi qenë vazhdimisht atje, po na ka thirrë. Ka qenë në do pjesë të tjera, kishim probleme derisa u msum mandej me ne, derisa u msun, se e dijshin që na hijmë knej kah Guri i Plakës, hijmë në Drenicë ose hijmë kah Napolja, kështu që mas ni kohe i msun rrugët tona. Edhe, ose i hijshim kah Komorani mandej mo nuk mujke me hi mas ni kohe, kur fillum kur u mshel. Gryka e Llapushnikut mo nuk mujshim me hi direkt, veç shkojshim hijshim në rrugë të ndryshme për me mrri deri në malet e Berishës se ka pas popullatë shumë të madhe.

Ka qenë vite që tash kur i mendoj, jo që thom, "Pse s'jemi frigu?" po e mendoj si diçka e natyrshme, pjesë e të jetumit në Kosovë. Edhe mburrna me guximin e grave. Gratë e Qendrës kanë qenë fantastike, i merrshim grupet e grave të tjera, se asni grup tjetër i grave nuk ka dalë në terren me ofru shërbime. Ne i merrshim gratë gazetare me shkru raporte, jo veç Sevdija, po edhe ato shkrujshin, na i distribojshim fotografitë për agjensi të ndryshme. Përveç që ofrojshim shërbime, kanë qenë vite të cilat thjesht i vlerësoj tash që e kanë shpagu veten, edhe nëse 175 herë që kemi shku, e kemi shpëto çdo here një njer, ose e kemi bo me pas ma lehtë jetën një njeri, atëhere ia ka vlejte. Përveç asaj, gjatë këtyre viteve, prej shkurtit të '92-shit, deri me 24 mars, me 25 mo s'kemi dalë në punë atë ditë se natën e parë,¹⁰ i kanë hi Qendrës edhe e kanë demolu edhe kanë vjedhë gjithëçka. Ato vite ne kemi rrjetëzu aq shumë, secila gru e Qendrës ka qenë e lidhur me grupe të ndryshme, jo vetëm me italianë, me austriakë; me gra të Austrisë, Norvegjisë, Suedisë... Kvinna till Kvinna n'a ka ndihmu shumë.

N'a kanë ndihmu gratë amerikane shumë, po meno, osht kriju njifar solidariteti global me gratë e Kosovës, edhe praktikisht e ka ndrru imigjin e luftës. E shih'shin që na jemi si ato gratë e njëjta ftyrë, kjo luftë që ndodhë në Kosovë, nuk osht luftë që jonë msu me pa përpara. Kto janë të vetëdijshme për rolin e vetë në shoqëri, që mujnë më bo diçka për këtë shoqëri, nuk janë gra të paarsimume, të mjera. Po, që e kanë kap momentin edhe me vullnetin e tyre mundohen me i ndihmu të tjerëve. Edhe, u kriju nifar pasqyre krejt tjetër për lëvizjen e rezistencës së Kosovës. Nuk ishte vetëm ajo që e paraqitshin mashkujt, po ishte edhe ni ftyrë tjetër, ftyrë e grave në Kosovë, ishte ftyra e rezistencës të Kosovës e cila nuk ishte agresive, nuk promovojke luftë, as nuk promovojke hakmarrje, po promovojke ni mbijetesë. Edhe promovojke ni rezistencë aktive e cila jo domosdo ishte pushka, edhe pse asgja nuk kom kundër.... {vnon dorën në gjoks}.

¹⁰ Viti duhet të jetë 1999, 24 mars ishte nata e parë e bombardimit të NATO--s.

Kur ka dalë në skenë UÇK-ja, ishte bo tepër, ishte moment i fundit që trupave serbe, jo civilëve serbë, trupave serbe t’iu kthen dikush, se ishte e pamundun me rezistitu edhe me mbetë me mendje t’shnoshë, edhe me jetu me çfarëdo dinjiteti në Kosovë... ishte e pamundun. Ata mujshin me hi n’shpi kur t’dojshin ditën a natën, unë me vite edhe pas luftës, me vite nuk kom mujtë me i mbyllë sytë, se gjithmonë e ndëgjojsha shkallët t’u ecë që po vijnë me m’marrë. Gjatë këtyne viteve, 11 herë kam qenë në stacion të policisë. 11 herë gjatë marrjes në pyetje, që thojshin... 11 herë m’kanë rrafë. Shumë herë kanë ardhë natën me m’marrë, pas luftës kom pas ni kohë shumë të gjatë që s’kom mujtë natën me ndëgju që dikush me ecë shkallëve, nuk kom mujtë. Mandej jom zgju edhe si kom ndëgju dikon t’u ecë shkallëve, jom zgju edhe mo s’kom mujtë me fjetë. Me vite të tana kom pas fobi në disa pjesë të Kosovës me vozitë, se m’u kujtojshin momentet kur na kanë nxerrë prej automobilit, n’a kanë rrafë, n’a kanë malltretu. Me vite të tana kom pas frika të ndryshme, trauma të ndryshme, të cilat nuk kanë qenë vetëm të mijat. T’u bisedu me njerëz të tjerë të Kosovës, thojshin, "Ha Vjosë, edhe ti a, edhe na gjithë kemi menu që ti je ma e fortë." Na gjithë jemi munu me u paraqit të fortë për me iu ndihmu të tjerëve, po jo sepse kemi qenë të fortë, frika ka ekzistitu, ka qenë tmerr.

Për shembull unë e kom pas ni, kurrë nuk e harroj, i kom pas ni parë kpuçë tash po del ni firmë... gjithmonë kom pas merak me ble kpuçë të shtrejta, *Bruno Magli* qivit, teget edhe gjithë tregojshin që kur i marrin në pyetje në polici, përveç që po i rrehin ka ngacmime seksuale. Edhe herën e parë kur m’kanë marrë në polici, i kom pas ato kpuçë veshë, dola prej policisë në qendër të Prishtinës edhe po eci gjatë tanë kohës t’u i kqyrë kpuçët, t’u thonë "Uf, m’kanë sjellë kto kpuçë fat. Kurrë s’kom me i deshë." Edhe sa herë mandej t’u folë me të ndjerin, se ma vonë bisedova me Bajram Kelmendin, edhe m’tha, "Vjosa lajmrom menihere kur të thërrasin mos shko mo n’polici pa mu." Edhe gjithmonë kesh’shim me Bajramin thojke, "A i ki veshë kpuçët Bruno Magli?" Thojsha, "Po." "A t’rrehën?" Se derisa vijke Bajrami, hijshin e qitshin jashtë, kishte raste të ndryshme... thojsha, "Jo, jo shpëtova edhe këtë herë pa ngacmime seksuale, e kpuçët po m’sjellin fat" Edhe kur m’kanë deportu prej Kosovës të njejtat këpuçë i kom pas veshë. Kanë qëndru ato këpuçë për ni kohë shumë të gjatë edhe i rujsa se e kom pas nifar fiksimi që ato po më mbrojnë. Prej frikës krijohen gjithfarë mekanizma me e mbrojtë vetëveten.

Fundi i fundit kanë qenë vite të tmerrshme për popullatën shqiptare të Kosovës, kanë qenë të tmerrshme. Që nëse m’pytë dikush cilat janë andrrat tua t’u kanë realizu, m’duket andrra ma e madhe që mu ka realizu osht që Kosova osht shliku, edhe që Kosova osht e pavarun. Edhe, nuk kom ditë me u gëzu sepse e kom andrru edhe besoj që andrra ka qenë e gjithkujt në Kosovë, s’ka pas njeri që s’e ka ëndërru në Kosovë. Se represioni ka qenë i tillë sa nuk ka fjalë që e spjeron, nuk ka... ka qenë i tmerrshëm. Unë jom pjesë e grupit që thirret Gjqet e Grave ndaj Dhunës ndaj Grave që osht rrjet global. Ishim në Cape Town dhe ndëgjojshim dëshmitë e *comfort women* prej Filipineve, edhe gjatë Luftës së Dytë Botnore se qysh iu kanë shërby me forcë ushtrisë japoneze gratë e Filipineve, gratë e Koresë dhe aziatike. Ndëgjojsha gratë e Bosnjes, gratë e Kosovës, gratë e Afrikës Jugore çka kanë përjetu. Po, ka qenë ni kohë që kanë përjetu edhe me nifar mënyre popullata iu ka ditë. Për gratë e Kosovës, nuk ka pas asi raporti. Edhe sot, 14 vjet mas luftës, gati 20 vjet prej apartheidit, ne ende nuk

kemi ni përmendore që osht ngritë për gratë e Kosovës, për represionin që osht zhvillu ndaj grave të Kosovës; ende nuk kemi ni gjykim që osht bo, e cila e denoncon dhunimet e grave në Kosovë. Domethonë drejtësia edhe kombëtare edhe ndërkombëtare nuk ka qenë e drejtë ndaj grave shqiptare të Kosovës, edhe pse, gratë kanë punu mjaft me denoncu atë dhunë që osht ushtru, por ekziston ni... nuk osht patriarkalizëm mo, kjo osht ni maçoizëm, në raport me gratë shqiptare, që kurrë nuk ka zbritë, nuk osht zbutë ndaj grave.

Ka vazhdu të qëndrojë i tillë edhe mas luftës. Edhe sot, pas gjithë aktiviteteve që i kanë bo gratë, në avokim për të drejtat e tyre edhe në pjesëmarrjen aktive në jetën publike të Kosovës, ende kemi raste kur gratë përfaqësohen vetëm për shkak të kuotave në zgjedhje. Por jo pse osht ni qëndrim, osht ni... nuk osht kriju ende ni shoqni e cila osht mjaft e hapun, e cila e pranon grunë si të barabartë. Edhe pse, unë personalisht besoj se gratë e Kosovës jonë shumë ma të përgatituna edhe ma të afta se burrat e Kosovës. Veç shiqo paramentin, 30 per qind të grave në parlamentin e Kosovës janë shumë ma të mira se 70 per qind të burrave që jonë. Jonë ma aktive, jonë ma të artikulume edhe jonë ma të drejta dhe kanë qasje ma demokratike, dhe ma të hapun ndaj çdo çashtje e cila diskutohet në parlamentin e Kosovës.

Qendra thash u kriju si ni pikë referente për aktivitetin e grave për rezistencë, po njëkohësisht njëfarë qendre e rrjetimit *networking* në botë. Praktikisht, ishim bo pjesë të shumë rrjeteve, kështu që kur u organizu konferenca e grave në Kombet e Bashkume në Beijing na ishim aty.

Por, normal kishim problem me dalë prej aty, Jugosllavisë së atëhershme, kishim problem me shku, s'kishim të ardhuna. Gratë e LDK-së partia i asi... po ne prej shoqnisë civile ka me shku? Nuk kishim të ardhuna. Kështu që, ni ditë m'thirrën prej, atëhere kryetarja e Bundestagu-t gjerman Rita Süssmuth, me bisedu për ni aktivitet edhe po m'pytë, "A po shkon në Beijing?" I thash, "Jo, nuk kom fonde me shku në Beijing. Edhe me marrë vizë prej kinezëve, unë prej Kosovës osht shumë vshtirë." Atëhere ambasadore në OSBE në Bosnje në Sarajevë ishte Angela Koning, një gru tjetër gjermane shumë e fortë edhe "lu rregullojmë" tha, "ne grave të Kosovës, krejt vizat, biletat, të gjitha." Edhe ashtu u bo, kështu që me ndihmën e atyne na shkum në Beijing, po meniher u kriju ni grup në veti, edhe fillum me lobu për të drejtat e grave të Kosovës; njëkohësisht, me u solidarizu me gratë të tjera.

Kështu që kur u shikojshim grupet, unë isha në grupin për të drejtat e grave... të drejtat politike të grave, edhe ish ni grup tjetër të cilët ishin si ma i vogël, edhe i pyta prej kahit jonë, thanë, "Prej Kanadës." "S'po m'duken si prej Kanadës..." Tha, "Jo janë gratë që solidarizohen me gratë e Tibetit." Unë mëniher u bona pjesë e grupit edhe e vnumë shejë ashtu, kur po e shoh që osht ni situatë mjaft e tensionume. Flejshim në disa si banesa i kishin bo kinezët në Huaru, edhe do dhoma ashtu si apartmane, i ndajshim shumë veta. Edhe ni mramje po vjen një gru kineze e cila flitke shqip. Po kërkon me u taku me mu edhe po thotë, "lu kisha lutë që mo mos me iu pa me atë grupin atje të Tibetit, se atëhere nuk je e mirëseardhun në Kinë." Për mu ishte shumë e çuditshme, mas pari u befasova që flitke shqip, mandej u befasova që ishte nifar kërcënimi. Mandej, e vërejta që... unë veç buzëqesha edhe e lash atë punë. Shkova po iu tregoj grupit, që u solidarizojke me gratë e Tibetit çka ndodhi. Po

atë grunë, mandej e vërejsha kur u mbledhshim na shqiptaret e Kosovës edhe Shqipnisë, që ishin grupet e grave të Shqipnisë... e vërejsha që ish mrapa nesh edhe na përcjellke, tash jo vetëm kur ishim me grupin e grave kanadeze që ishin me origjinë nga Tibeti, por edhe që ishim na vetëm shqiptaret.

Mandej, kishim një lokal ku shkojshim me bo strategji të përbashkët gratë e grupeve të organizatave jo-qeveritare të ish-Jugosllavisë. Shkojshim me ni lokal edhe u mbledhshim gjithmonë edhe bashkëpunojshim. Gratë e Kosovës kanë qenë mjaft aktive në çdo grup punus kur osht përgatitë platforma, ne u shpërndamë shumë mirë. Të drejtat reproduktive... unë isha në grupin e të drejtave reproduktive, e ni gru e LDK-së, dy në të vërtetë, ishin në të drejtat politike të grave. Në fillim isha në të drejtat politike, mandej dola se askush nuk ish në grupin e të drejtave reproduktive; pasi unë veç punojsha në të drejtat reproduktive, edhe plus isha mjeke, ish ma e natyrshme. Edhe ishte pjesa, aty ishin aktive edhe një pjesë e një *network* ku unë isha pjesë, *Our Body Ourselves*, isha ma parë pjesë e atij grupi, kështu që aty isha ma aktive.

Na u shpërndamë në të gjitha grupet punuese, gratë e Kosovës u shpërndamë dhe në gjithë platforma ka kontribut tonin. Ne mujshim me komentu, edhe komentet tona u pranojshin sepse ne kishim një eksperiencë të hatashme të rezistencës pasive dhe kishim një eksperiencë të hatashme në rrjetim në botë. Kështu që, kishim një eksperiencë të madhe dhe mujshim me kontribu mjaft, kështu që në njëfar mënyre kur u përgatitë platforma, na të gjitha e ndjeshim si një pjesë tonën. Sepse idetë tona ishin shumë të pranishme edhe të gjitha e shih'shim andërr, që "Ej kur të shlirohem një ditë, ne të gjithë këtë platformë kemi me pas mundësi me e zbatu në një Kosovë të lirë." Osht' e vërtetë që ka pjesë të platformës që jonë zbatu, nuk osht krejt zi. Po ka pjesë që ka mbetë tabu dhe nuk ekziston një vullnet i përgjithshëm edhe një klimë e favorshme që me u adresu, pavarësisht sa avokim bojnë gratë, sepse kemi atë maçoizmin që përmena. Ne ende përqeshemi, gratë e Kosovës nëse kërkojmë një barazi të plotë, ose kërkojmë që të bisedohet për një temë e cila osht tabu. Se nuk mirret si ni çashtje me prioritet nacional në Kosovë.

Prandaj, jemi ku jemi. Kemi edhe mjaft rrugë, mjaft me bo por grupet e grave në Kosovë, të viteve '90-ta, dhe pas viteve të '90-ta, ma pak po sidomos gjatë viteve të '90-ta, kanë hap aq shumë gjana të randësishmë për shoqërinë shqiptare të Kosovës. Kur shiqoj tash, osht fenomenale; osht ni kontribut i madh i zhvillimit të shoqërisë. Edhe besoj që me kohë ka me u vlerësu ma shumë. Ne kemi hap çashtjen e edukimit, edhe jo vetëm në mënyrë aktive që kemi punu, po kemi raportu, kemi animu, kemi punu me nxanës të shkollave të mesme, shkollave fillore. Na kemi fillu bisedat për të drejtat e njeriut, për të drejtat e grave nëpër shkolla gjatë kohës së apartheidit; kemi pas të organizume prej qendrës biseda. Ne kemi përfshi të gjitha shkollat paralele që kanë qenë, të Kosovës në projekt; ne kemi majtë ligjerata në të gjitha shkollat e Kosovës, shkollat e mesme për të drejtat e njeriut; ne kemi kontribu në zhvillimin e kurrikulit gjatë apartheidit për të drejtat e qytetarëve.

Domethonë, osht bo ni punë e hatashme, ka qenë ni punë 25 orë në ditë. (Buzëqeshë). Po ishte nifar *camaraderie* shumë i mirë se na po flasim për shëndetësi, Qendra. Kështu që edhe policia kur vijke, vijke shumë shpesh, n'a shihke t'u ofru shërbime; na e mshefshim ni kompjuter, e majshim te Sevdija

me t'dhana, se mu m'kishin marrë në sy. M'merrshin në polici qaq shpesh sa me majtë në banesë teme nuk kish efekt, se e dijsin që herën e parë që të më marrin, vijnë e kontrollojnë shpinë; kështu që, e majshim te Sevdija. Edhe një paralel, ni kompjuter, një desktop e majshim në zyre, për me i majtë dokumentacionet. E telefonin, e përdorshim, telefonin e prindërve të mijë, deri ma vonë kur fillun telefonat mobilë mandej, kishim telefona mobilë. E unë e kisha fatin që ni organizatë ndërkombëtare ma pagujke telefonin, jo të Kosovës, me *roaming*. Kështu që, mujsha me komuniku ma lehtë, po për qytetarë të Kosovës që më thirrshin prej territoreve të ndryshme të luftës iu kushtojke ma tepër për më m'thirrë. Por, punojke mirë, punojke ma mirë se me qenë ai Mobteli që ka qenë në Kosovë, kështu që mujshim me komuniku ma mirë.

Kjo punë vazhdoi deri atëherë deri me 25 mars '99, unë gjatë gjithë shkurtit... janarit dhe shkurtit kam qenë në Austri. Bile edhe kardinali i kishës katolike të Austrisë, kardinali König ka marrë pjesë me mu në disa kisha, na folshim për represionin në Kosovë.

Kisha katolike në Austri ka dhonë donacione të mëdha për popullatën e Kosovës, jo vetëm në të holla, shumë më pak në të holla, shumë ma tepër në materiale të ndryshme që ishte nifar lirimi për të hollat që i çojke Nënës Terezë. Por, aty për herë të parë fillun me e përkrahë Qendrën, por çka ndodhi, ndodhi Rambujeja në atë kohë, edhe kur u ktheva unë ndodhi bombardimet... Kështu që të gjithë ato ndihma të cilat u mbledhën gjatë atyne javëve në Austri, mandej na prun nëpër kampe të refugjatëve dhe në Qendrën që e formova unë, e themelova në Tetovë, si refugjatë, pasi që na dëbun prej Kosovës... Në të vërtetë me 25 t'a tregoj, na u mshefëm, hyrja e kemi pas ni podrum poshtë, që nuk ka pas dritare jashtë, edhe prej ni banesës hijke. Kishim serbët që ishin të armatosun, civilë ishin shumë të armatosun në hymje. E kishim ni podrum prej banesës në katin përdhesë, përfundi prej banesës u hijke në podrum, kështu që të gjithë shqiptarët e hymjes shkum në atë podrum. Nga ora tre, më thirrën në telefon, po t'thom e kisha telefonin me numër të shtetit tjetër, edhe po m'lajmrojnë që e kanë kallë Çarshinë e Madhë në Gjakovë, edhe kanë vra Doktor Izet... kanë vra një aktivist, në t'vërtetë një punëtor të OSBE-së, e kanë marrë gati të sigurtë Bajram Kelmendin edhe dy djemtë, edhe po m'thirrë ni shoqe e jemja prej Beogradit, Natasha Kandiç.¹¹

¹¹ Aktivistë serbe për të drejtat e njeriut, themeluese e Humanitarian Law Center, Beograd.

Kështu që unë shkova prej podrumit dola edhe shkova në banesë te prindërit e mi, me kqyrë a muj me telefon temin me çu do mesazhe në botë kur, ni kojshi erdh e më tha, "Vjosa, je ka na rrezikon krejt hymjen, po vijnë me t'marrë policia." Ishte krejt terr, edhe babi jem erdhi me mu prej podrumit me më bo shoqni deri në banesë, e i kom thonë babit, "Babi shkova, ika se erdhën!" E pash babin t'u e mbyllë derën, une i pashë dritat që po nalet te hymja, po hymja ishte me interfon, po s'kish rrymë. Dojshin me thy derën, derisa të hijnë anej, une kom kohë me ikë. Kështu që ika nga ballkoni i dhomës së ditës, edhe qëndrova diku njo 5-6 ditë në hymjen tjetër të kojshisë, në ndërtesën tjetër. Mandej erdh burri i ni shoqes më murrë, më mlunë me plaf gjatë ditës, shkum me ni shpi tjetër, mandej ni shpi tjetër. Njëzet e pesë, njëzet e nëntë masdite... mandej shkova me shiqu a i kom prindët gjallë, edhe na zunë në rrugë, mu, motrën edhe burrin e motrës edhe fëminë e tyne njëmbëdhjetë mujsh. Edhe na, si kemi qenë në automobil, n'a rrehën, n'a vjedhën krejt gjanat çka i kemi pas me veti, ari, të hollat, edhe n'a qitën prej Kosovës.

Qëndrum diku pesë - gjashtë - shtatë orë në kufi, që i kom fotografitë, *no man's land*, një herë të kufini, se maqedonët e mbyllën kufinin, mandej në Bllacë. Mandej, vazhdova në Tetovë e themelova ni Qendër me gratë e Qendrës së Prishtinës që ishin refugjitate në Maqedoni edhe fillum me punu nëpër kampe. Edhe në Qendër punojshim, dy rrijshim në Qendër sepse kshim telefon dhe të gjitha gratë dhe burrat prej kampeve kur dojshin me u bashku me anëtarë të tjerë të familjes, se Kryqi i Kuq, dhe asnjë organizatë, nuk u gjetë aq shpejtë, me ndihmu me u bashku, nuk dijshin anëtarët e ndryshëm familjes, ku jonë nëpër kampe. Kështu që u kriju ai vend, të gjitha gratë të dhunume, të malltretume ishin për vizita. Meniherë për nëntë ditë që e themelum Qendrën, e morëm me qira te xhamia e luleve të larme në Tetovë, e morëm një objekt me qira, motra jeme me burrin e vetë arkitekta, edhe vetë punojshin, n'a marun do mure si një lokal, si dyqan, i bonën do mure do sene... edhe të gjithë fillun me na pru, jo kompjutera, jo na prunë barna. U mbledhën gratë të cilat kishin punu në Qendër edhe do gra të tjera erdhën vullnetare me punu, edhe e kriju një Qendër tjetër, e krijum një vend tjetër. Mandej, deri sa jemi kthy në Kosovë ka punu, ka punu me gratë e Tetovës deri në fund të '99-shit.

Na s'kishim e dojshim me fillu Qendrën ktu, e s'mujshim me e përkrahë as Qendrën, s'kishim mjete materiale. Por atyne iu lamë një ultraza, një ordinancë gjinekologjike komplet, një ordinancë pediatrike, kompjutera; gjysën e gjanave iu lamë aty, gjysën e prum me fillu Qendrën ktu mas luftës në Prishtinë. Po ato nuk vazhdun me punu, se atje veç ish sistemi në vend, nuk e panë të domosdoshme që me fillu me punu në çka punojshim na. U kthym në Kosovë, kurrë nuk e harroj ditën e parë kur jom kthy në Kosovë. Ka qenë 16 qershor, u ktheva me përfaqësuesin e USAID-it që ish për Kosovë, Frank Pavich. Frank me kerr m'prun në Kosovë. Edhe meniherë shkova në banesë, kur shkova në banesë, normal kishin vjedhë krejt, e kishin shkatërru krejt, kishin vjedhë gjithëçka. Edhe shkum... qyteti ish i zbrazët, do njerëz të hutum, nuk e njifsha akskond, shkum te qendra "1 Tetori" aty, edhe raportum te Gurkhat¹² se kisha dyshim çka osht, diçka në korridor. Edhe erdhën Gurkhat meniherë, njësia e deminimit edhe shkum me aparaturë edhe e gjetën qit unazë. Edhe e gjetën ni *personal landmine*, ni

¹² Popull indogjen nga Nepali, dhe forcë speciale në ushtrinë britaneze.

minë personale e mbulume me tasha të vjetra, se gjithëçka ishte vjedhë, ishte shkatërru. Banesa ish ni grumbull i teshave të vjetra, kishin metë ishin mbulu, aty ish ni minë; ata e mbyllën banesën edhe thanë, "Mos u dok niherë derisa të deminojmë, ka me shku ni kohë se apartmanet nuk jonë prioritet për ne, rrugët jonë. Thirr mas nji muji." Po unë s'mujta me u duru nji mujë ditë, u ktheva në Maqedoni, mandej me 18 u ktheva prapë ktu, shkojsa e vijsha vazhdimisht derisa praktikisht tek ka mesi i gushtit u ktheva në Kosovë.

Po s'kisha ku me jetu se ish shkatërru krejt, në Gjakovë e kishin djegë natën e parë shpinë, e kishin djegë krejt, edhe mandej e kanë nivelizu, s'kanë lon asgjo. Ktu n'Prishtinë banesën e kishin shkatërru, kishin vjedhë krejt, s'kish as dritare as dyer as... po meno, ishte ni derë e cila u mbyllke me tel jashtë, e me dry por jo derë normale. S'kisha as dritare as kurgjo hiq, ish e shkatërrume krejt, po si krejt Kosova, në Prishtinë u vërejt ma pak se në përgjithësi nuk ka pas asi pamje, po banesat mrena të disa njerëzve kanë qenë krejt të shkatërrume. S'kishin pas lon as fotografi as kurgjo hiq, krejt i kishin pas vjedhë. Osht nifar ftoftësie kur e menon kthimin në vend tonin mas tre muje si refugjat. Përveç që kom punu në Qendër ata tre mujë, shumë kom avoku për intervenim të NATO-s. Se veq ke zbrasë Kosova, ne përveç që punojshim në kampe, mbledhshim edhe dokumentacion për dhunime, edhe forma të ndryshme të dhunës, jo vetëm në Maqedoni po edhe në Shqipni. I angazhum disa vajza të reja me shku në kampë në Shqipni.

Unë kom udhëtu shumë ata tre mujë, kom bo prezentim në Sharp afër Brukselit me aktivista të tjerë, gjendjen e civilëve, se une isha në kontakt vazhdimisht me... prej secilës zonë, kisha numrat e telefonave të tyre satelitorë dhe i thirrsha, vazhdimisht e merrsha raportin, për secilën zonë e kom pas. Mersha raportin, dhe dijsa mjaft për çka po ndodhë dhe si osht gjendja, po flas për popullatë civile, nuk po flas për asi... Kështu që bojsha shumë prezente në Itali, Belgjikë, në Angli, senat italian, senat amerikan, folsha për të gjitha televizionet e randësishme botnore. Jepsa *in interview* prej gazetave izraelite, japoneze, kineze, ruse bile, leje angleze e amerikane. Ish ni pjesë e punës sime të atyne viteve, lufta duhej me u ndërpre, qytetarët duheshin me u kthy në vendet e tyne, nuk u guxoje me iu leju Millosheviçit me regjimin e tij që t'a zbrasë Kosovën plotësisht. Edhe pse mbi nji milion njerëz ishin jashtë, edhe të tjerët që ishin në Kosovë, të gjithë ishin të zhvendosur, Kosova ka qenë krejt e çakordume, po nuk guxojshim me leju atë rezultat. Në fund të shekullit XX me leju, edhe për ni popull i cili për shumë vjet nuk i shkaktoi askujt dam (buzëqeshë) edhe nuk e sulmoi askend, me ardhë në situatë të tillë ka qenë, me të vërtetë ka qenë çashtje morale botnore, nëse ish leju para kamerave televizive të ndodhë ajo çka i ndodhi Kosovës edhe mos të reagoget.

Kur u ktheva në Kosovë, e kisha ni zbrastësi, njerëzit ishin edhe në liri, po me çka jom mburrë unë, pavarësisht çka flitet se ka pas dhunë mas asaj.... Popullata shqiptare osht kthy meniher në Kosovë. Shumë njerëz kanë pas jetë të mirë në Angli, Gjermani, të gjithë jon kthy. Kërkujt nuk i kanë kriju telashe, popullata e Kosovës u ardhë në një vend të shkatërrum komplet, na ashtu kemi jetu me vjet. Popullata e Kosovës e respektojke semaforin, pse e ka ditë ku osht semafori, nuk ka ardh polici me të tregu që, "Ndalu në këtë semafor!" Nuk ka pas semafor, jonë ndal ku ka qenë semafori, edhe

automobili u ndal. Dhuna që flitet tash, që u ushtru mas.... ka qenë për mu jashtëzakonisht e vogël, edhe pse çdo dhunë osht e madhe, po në krahasim me popullatën, me çka ka ndodhë në Kosovë, ka qenë mjaft e vogël. Që s'ka pas policë, kur jemi kthi na në Kosovë, nuk ka pas policë, s'ka pas gjyqe, s'ka pas kurgjo. Popullata osht sjellë, po menoj ka pas raste individuale, po shumica e popullatës osht sjellë aq në mënyrë dinjitoze. Për ni popullatë që osht përdhunu aq shumë, aq gjatë, mu sjellë, me u kthi në vend të vetin edhe me u sjellë me aq dinjitet, kjo veç në Kosovë ka ndodhë.

Jonë raste individuale të cilat, ka ekzistu një propagandë e jashtëzakonshme që i ka zmadhu edhe ka folë për to. Osht shumë jo-njerëzore, me folë për gjana që kanë qenë ma të rralla në krahasim me shumicën e popullatës qysh u sjellë. Ata jonë ardhë s'kanë gjetë shpi, s'i kanë gjetë anëtarët e familjes, i kanë gjetë gratë e dhunume, ose i kanë marrë... jonë kthi. Kanë hupë gjithëçka, edhe ata njerëz nuk jonë shku me iu hakmarrë serbëve. Aty ka qenë ni atmosferë qaq e dinjitetshme, ai kthim i njerëzve, ai optimizëm i njerëzve, ajo madhni e popullatës. Me ardhë në kurgjo, me gjetë kurgjo, mas gjithë atij represioni. Edhe me pas vullnet me fillu prej fillimit, prej zeros; me ardhë me ni vend ku nuk ki mo fotografi tuja, kur s'ki mo shpi, kur s'din kurgjo, kur s'din ka e ki familjen, ku jonë munu me ta shly të kalumen e historinë. Neve nuk na kanë shky dokumentet t'u na deportu. Ai vit ka qenë i dinjitetshëm, pavarësisht çka flitet.

Gjatë kohës thash që gjatë këtyre viteve na kemi përjetu shumë edhe kemi kriju shumë kontakte, une kisha kontakte edhe përpara në Amerikë. Po, mandej gjatë kohës të këtyne viteve nuk punojsha vetëm në Qendër, punojsha në Nënë Terezë, isha anëtare e bordit të SOROS-it në Beograd për Kosovë, aktivitete... kështu që isha pjesë e ni rrjeti të organizatave që më mundësojke mandej me Komitetin e Helsink-ut në Stokholm dhe organizata të tjera, mos të përmeni të gjitha. Edhe kisha marrëdhanie ma heret që raportojshta me Physicians of Human Rights in Boston, mandej me Human Right Watch në New York edhe iu raportojschim atyne.

Këto organizata na mundësun na thirrshin shpesh, që të raportojshta, të bëj prezentime për të drejtat e njeriut në Kosovë, në gjithë botën. Në Amerikë kishin një rrjet shumë të mirë të organizatave te të cilat punojsha me vite, dhjetë vjet e ma shumë. Kështu që ma mundësun me bo ni prezentim në Senat, nji dëshmi në Senat. Takova disa here atëherë zonjën e parë Hilary Clinton, gjatë bombardimeve edhe sekretaren e shtetit Madeleine Albright, që ka qenë si me pa nanën, ajo osht ni gru fantastike! Gratë... populli i Kosovës ka pas aq shumë mbështetje në Amerikë, edhe ka, po veç aq shumë ka pas mbështetje të mirëfilltë për liri, osht e pamundun. Prezentimet, takimet që i kom bo me Hilary Clinton, me Madeleine Albright, me antaret e Senatit, gratë e Senatit, gratë e Kongresit po edhe me burrat, jo vetëm me Caucus-in në krye me Elliot Engel, po edhe me grupe të tjera edhe me senatorë, kongresmenë të cilët nuk jonë pjesë të Caucus-it që ka qenë, shumë unë kurrë nuk e harroj!

Kemi pas ni *interview* në Larry King Show me senatorë amerikanë. Unë edhe senatorët kishim në lidhje edhe ambasadorin e atëherëshëm të ish-Jugosllavisë së përgjysmuar, Serbisë dhe Malit të Zi, në Kombet e Bashkume, edhe unë isha në Larry King Show dhe ai ishte në New York në Kombet e Bashkume. Edhe dialogu që u zhvillu unë besoj që e kom... edhe ai e ka pa me argumentet edhe

eksperiencën që e kisha, po edhe ai e ka prezentu shtetin e vetë edhe normal politikën e shtetit të vetë, po une besoj që ai nuk kish fjalë. Ai dojke vetëm me sulmu, po nuk kishte fjalë me i rrëzu argumentet, argumentet e mia. Përkrahja e Shteteve të Bashkume të Amerikës, nuk ka qenë vetëm përkrahja e administratës amerikane, ka qenë përkrahja e popullit amerikan, ka qenë një ndjenjë e hatashme, një përkrahje e tillë osht... për ni vend që ndoshta nuk kanë mujtë me e gjetë në hartë, ka qenë e hatashme, ka qenë e nivelit njerëzor, me të vërtetë e nivelit njerëzor, edhe une e kom ndi veten shumë mirë, që muj tek e fundit pa urrejtje të iu prezentoj ni situatë.

Unë as atëhere, as sot nuk i urrej serbët. Unë e urrej... une nuk e du, jo urrej kurgjo se osht ndjenjë shumë e fortë me e shpenzu në diçka të keqe. Nuk e du ni politikë shoveniste të tillë, une s’kisha dashtë me pa në jetë që asni popull të zhvillojë një politikë diskriminuese edhe shoviniste të tillë, siç është zhvillu ndaj popullit shqiptar në ish- Jugosllavi. S’kom dëshirë me pa askond në botë, nuk mujnë me më mbushë me urrejtje, nuk e kom. Prandaj, prezentimet e mia kanë qenë jo vetëm në CNN, ABC, NBC, Hard Talk, BBC... gjithkah, nuk kanë qenë të mbushuna me urrejtje, se nuk e kom atë urrejtje mrena. Mu m’vjen keq për popullin serb, mu m’vjen keq që kanë ardhë me ni pozitë që askush, as populli malazes më të cilin kanë të njejtën gjuhë, të njejtën fe, të njejtën kulturë, nuk dëshiron me jetu me ta mo.

Mu m’vjen keq për popullin serb se e kanë pru veten në ni pozitë të tillë, që askush nuk don me jetu me ta. Po unë jom ka jetoj andrrën time me e pa Kosovën të lirë. Edhe jom, unë atë ditë kom thon... atë ditë kur e shpall Kosova pavarësinë, edhe mos me jetu mo, s’osht me randsi. Edhe pse në fillim ni energji e re m’ka ardhë te unë, që unë duhna me bo prapë diçka për qit vend. Kom vullnet, duket patetike, veq edhe arsyeja pse e kom pranu m’u bo ambasadore, osht se unë me të vërtetë mburrna që do t’a prezentoj shtetin tem. Edhe gjithmonë thom, "A ka jetu dikush ni jetë, ku ka jetu në disa sisteme në komunizëm, në nifar socializëm human që osht thirrë, gjatë ligjit marshal edhe represionit, edhe apartheidit në Kosovë, luftës, çlirimit edhe pavarësisë?" Jo shumë njerëz gjatë jetës së tyne kanë fatin me i jetu krejt këto. Po m’duket që kom jetu disa jetna, edhe kur m’kanë emënu për ambasador, qaq e kom marrë si mburrje që kom me prezentu shtetin tem, që thjesht kur m’kanë pytë se, "Si jonë kushtet?" Unë "S’di," "E qysh a s’ki vetë?," "Jo, s’kom vetë." Mu m’kanë bo nder, pavarësisht çfarë, mu m’ka bo nder, unë jetoj ende sot, e jetoj andrrën e Kosovës të lirë (buzëqeshë).

Edhe s’jom ngop ende me atë andërr. Po unë kisha pas qef që, çdo qytetar i Kosovës, t’a jetojë atë andërr. Une kisha pas qef që t’a shoh Kosovën që osht ma shtet social, që Kosova të jetë ma shtet i hapun, jo vetëm nga jashtë, po i hapun si shoqni ndaj të drejtave të gjithëve. Unë kisha dashtë me pa Kosovën ma t’zhvillume ekonomikisht, që i hapë dyert edhe për zhvillim tjetër, për zhvillim social, se nuk ki zhvillim social pa zhvillim ekonomik. Po prapë besoj që të gjithë jemi ka e jetojmë andrrën, edhe i ka ardhë fundi një represioni të tillë, të cilin e kemi përjetu.

Unë kurrë nuk e harroj se si, për shembull kur kom shku unë në specializim në Zagreb me 1986 në klinikën Shallata, ka qenë drejtor i klinikës Prof. Tifembah, edhe na shkum tri mjeke prej Kosovës.. për herë të parë femra shqiptare po shkojnë në pediatri, në specializim atje: Zina Mekuli, Flora Brovina

edhe unë, edhe po shkojmë, profesor Tifembah edhe mandej u gzu që po na sheh, edhe po i thotë motrës kryesore me na caktu dhomat. Kemi me u ndrru dhomat e mjekëve residentë, edhe na shkum e ajo motra... tash na trijat bionde, e Zina pak ma me ten pak ma të mbylltë, po prapë e bardhë. Edhe motrat kryesore, "Uh unë kom mendu se jeni të zi!" Kështu kanë mendu për ne jugosllavët, edhe kështu kanë mendu që të gjithë jemi ambëlorgji, ose shesim në pazar në Kvardiç. Po s'iu hijke n'kry që ka femra shqiptare që janë të shkollime, edhe që vijnë.

Pas luftës, ishte një ambient krejt tjetër në Kosovë, materialisht krejt i kom humb. Po çka ishte ma e rondë, motrat e mia. Unë i kom katër motra edhe gjithmonë kom thonë që kom pas fat në jetë që i kom katër motra, e kom Pranverën motrën e dytë mas meje që osht, e cila osht inxhinierë e elektros, ka qenë drejtoreshë e Kek-ut; e kom Aidën që osht urbaniste; Shkëndinë që osht kirurge e suksesshme e lëkurës; edhe Donikën që osht arkitekte. Edhe të trijat u kthyn, sepse babi jem mas luftës tha, "Unë nuk kom eduku fëmijë, që masi që u çliru Kosova me nejtë jashtë, me kontribu diku jashtë." Edhe në nifar mënyre na obligoi të gjithave me u kthy.

Pranvera ishte në Angli, punojke si inxhinierë, burri i vetë punojkë si anesteziolog; Aida ishte në New York, të dytë punojshin si dizajnera, arkitektë, Shkëndija në Graz në Klinikën Universitare punojke si kirurg i lëkurës, dermatologe edhe në një klinikë private në Vienë punojke si dermatologe e kirurge e lëkurës dhe praktikisht të gjitha u kthym. Unë kisha shanca me nejtë në Amerikë, shancat ma vonë i shfrytëzova, ma vonë shkova në Harvard, një vjet akademik isha në *Fellowship* në Kennedy School of Government të Harvard-it, ku ligjërojsha dhe bojsha hulumtime për të drejtat e njeriut. Të gjitha u kthym në Kosovë, kryesisht me insistim të babit. Babi gjithmonë e ka pas një qëndrim, edhe e ka një qëndrim që këtij vendi i vijnë njerëz edhe që s'guxojnë me kërkun shumë prej këtij vendi, po na duhet me dhonë sa t'mujmë. Edhe për babin tem, me dhonë sa t'mujmë ka qenë me i shkollu fëmijët edhe me i eduku ashtu qysh ai ka menu. Ni pjesë e edukimit ka qenë gjithmonë, unë e mbaj në mend kur kom qenë 15 vjet, i kemi pas të dillën gjatë javës, babi na jepke librat, duheshim me lexu. Edhe për çdo ditë u mbledhshim diku ka ora tre me hongër drekë, por të dillen e kishim në ora një me u mbledhë, kado që jemi të pestat u dashtë me u mbledhë për drekë.

Edhe fillojke me na marrë në pyetje për librat që i kemi lexu. Edhe, tash kur je në pubertet të irritojke. Unë e mbaj në mend në 15 vjet ma ka dhon me lexu në serbisht Ciceron, me lexu edhe tash nuk e lypke mendimin tem, po ma imponojke mendimin e tij, si unë e kom lexu librin. Po në të njejtën kohë më nxitke me i dhonë argumente, jo me u përta, po me i dhonë argumente. Gjithmonë e ka pas atë, në tetor ka qenë Panairi i Librave, çka botojke Rilindja gjatë gjithë vitit, në tetor u bojke Panairi, babi e ka pas zakon gjithë çka u botojke me ble për shpi, edhe një bibliotekë me ia çu shkollës fillore dhe të mesme në Junik, se edhe e ka pas emrin e axhës Hysni Dobruna i cili ka vdekë ditën e fundit të Luftës së Dytë Botnore, Luftës Nacionalçlirimtare; edhe një shkojke atje, një vijke në shpi. Edhe kur e maj në mend mama ime u brengoske pse s'kemi villë në Brezovicë, ose s'kemi shpi të madhe; babi jem thojke une i kom pesë fëmijë të edukum, edhe bibliotekë ma të madhe në Kosovë, private. Edhe thojke fëmijët e mi e kanë lexu çdo libër, edhe s'kemi pas qare pa e lexu çdo libër se e ka pas rend, "Qito ki

me lexu ti, qito ki me lexu ti.” Edhe të dillën u ulshim, edhe tash duhej me diskutu për libra. Na kishim dallim në moshë, po s’ish me randësi, duhej me i lexu librat edhe të dillën bisedojmë. Nëse nuk e kryjmë bisedën gjatë javës, na thirrke veç e veç, "Hajt t’bisedojmë për qat libër.”

Ka qenë kjo gjatë gjithë edukimit, tash pas luftës, me të njejtën atitudë, me t’njejtin qëndrim babi jem, thirrke në telefon... e s’kishim ku me jetu e krejt ishin të shkatërrume. Pranvera, motra e dytë ish ende në Angli, na shkum e ka pas ni banesë të vogël se kur e largun para luftës prej KEK-ut, ia patën marrë edhe banesën, mandej ia dhanë një banesë të vogël, e në atë banesë na shkum me jetu, e vetmja banesë që nuk ish e shkatërrume, derisa u khy ajo prej Anglisë. Babi jem për çdo ditë, e merrke telefonin tem edhe thirrke në telefon, "A u bone gati me u kthy?" E thirrke atë tjetrën në New York, "A je përgatitë me u kthy?" Te gjithave, deri sa u kthym në Kosovë. Përveç motra ma e vogël Donika, ajo vazhdoi me jetu, ajo nuk u kthy asniherë. Ajo është gjenerata që sa e patën regjistru fakultetin edhe u mbyll Univeristet qe i patën qitë ilegal në Maqedoni, mandej prej Maqedonisë shkoi në Angli, mandej atje e kreu fakultetin. Ka qenë ajo gjenerata që gjithë fëmijët tonë, studentët e ri që shkunë në Angli dhe vendet tjera, një valë e azil kërkuesve të cilët gjithë u shkollun, është ni valë e re.

Përpara kanë shku për punë, kanë shku zakonisht mashkuj, kanë lonë gratë edhe femrat kanë nejtë në Kosovë. Kjo ishte gjeneratë me mbylljen e Universitetit në Kosovë në ‘90-’91, të gjithë fëmijët që kanë shku, studentat të gjithë kanë kry fakultet. Në një moment u bo në Angli, vetëm në Londër 7000 vajza dhe djem të Kosovës që studiojshin. Edhe të gjithë kanë kry fakultete, jonë stabilizu, shumë pak prej tyne jonë kthy në Kosovë, e me ta edhe motra ime. Na tjerat u kthym të gjitha në Kosovë. Praktikisht, fillum jetën prej zeros, si 90 perqind e kosovarëve të tjerë, se askush nuk e gjeti lule, shumica e gjetën të shkatërrum. Ai vullnet, ai entuziazëm ka qenë fenomenal. Unë nuk e di a ka qitë dikush në letër, a osht bo ndonji film me përshkru jo shkatërrimin, po atë vullnetin e njerëzve, atë respektin, atë dashninë për vendin si shqiptarët e Kosovës, kur jonë kthy në Kosovë, ajo ka qenë fenomenale. Ajo ka qenë biblike e historike. Për mu ajo osht... une e kom ndjenjën speciale, gjithmonë kur kthehna dhe mendoj dhe m’kujtohet qatëhere jo me 16, po me 18 kur kom ardhë në herën e dytë, dola me ecë rrugëve të Prishtinës, gati askend nuk e njifsha, se kishin ardhë krejt njerëz të ri. Ende u kthejshin njerëzit, edhe shëtisha rrugës me kqyre a po shoh dikon te njofshëm, a po shoh diçka. Po ka qenë njifar ndjenjë speciale, po aty e kom vërejtë njerëzit t’u pritë në semafor...[qeshë]. “Po çka po presin presin, s’ka semafor. Çka jonë ka presin?”[qeshë]. Shkova me pa banesën e motrës, i kom pa njerëzit t’u hi t’u i mbyllë dyrtë e shpiave të huaja. T’a lojmë që ka pas uzurpime... po në fillim të ditëve të para, i kom pa njerëzit t’u shku t’u i mbyllë dyertë e huaja, që e kanë ditë që jonë shpitë e huaja, t’u vnu dryna... ajo ka qenë fantastike, ajo ka qenë fenomenale! Ajo ka qenë me të vërtetë me majtë në mend.

Në qershor në ‘97-tën, n’a thirri Hilary Clinton me shku në Washington e isha me Edita Kelmendin dhe Natasha Kandiq, edhe pasiqë bashkëpunojsha edhe me UNICEF-in, Maureen White që ishte ambasadore e UNICEF-it për Shtetet e Bashkume të Amerikës, n’a thirri në shpinë e vetë në New York.

Në '98-shin paska qenë, në qershor, edhe na shkum në New York; ishte Kati Morton gruja e Holbrooke-ut dhe nana e tij, edhe qysh ekzistojnë paragjykimet për shqiptare; edhe ishim une Natasha po ecim, edhe po shkojmë me u taku me te, e mu ato ditë kish ardhë Holbrooke-u me u taku me UÇK-në në Junik. Edhe nana e Holebrooke-ut tash nuk po din cila jemi e Kosovës, cila jemi shqiptarja, e cila serbja. Po na sheh mu e Natashën e po vjen te unë, po thotë, "Djali jem ka shku me u taku me ata të egrit në male..." Shqiptarët e Kosovës - "të egrit në male." Unë pe kqyri Maureen, ajo, "Çka u bo?" Unë, "qështu plaka m'thotë." Ajo, "T'ka përzi, po menon mos je serbja ti." I thash, "Hiq so me rëndësi, le t'a thotë, nuk po du me përmisu." Po ajo nuk mujti me u duru, mas ni kohe u shku kadale i ka thonë që, "Djali yt ka shku me vullnet, osht ka bon ni *mediation* edhe Vjosa osht diçka tjetër, nuk prezenton UÇK-në, po prezenton shoqininë civile." Kur m'u afru, mandej po më thërret me bisedu, po thotë, "Unë kërkoj falje, veç diqysh s'mu doke si shqiptare e Kosovës." Për mu ka qenë shumë ofendim gjithmonë edhe në ish-Jugosllavi, "Nuk po dukesh si shqiptare." "Pse qysh duken shqiptaret?" Ai paragjykim e ke bartë në tërë botën, e po m'duket veç gratë shqiptare kur kanë fillu me dalë jashtë edhe me avoku e kanë ndrru pak atë paragjykim për shqiptarët. Sidomos për gratë, se diqysh i kanë paramendu ma që s'guxojnë me folë, edhe sot, ishte para dy-tre muje një trajnim për gratë, edhe ish ardhë ni trajnues e po thotë, "A keni pyetje?" Thash, "A bon na me dhonë komente, edhe me dhonë përgjigje? Pse pytje? Nuk po m'duket që ju dini diçka ma shumë se na." Mashkull ke.

Ky paragjykim i cili është së pari, masi po flasim për gratë e Kosovës, njerëzit që vijnë në Kosovë e kanë për gratë e Kosovës, po ekziston paragjykimi për gratë në përgjithësi, por sidomos për gratë e Kosovës osht mjaft prezent edhe sot e kësaj dite. Ka ndrru pak, por jo.

Mandej, qeveritë tona vazhdimisht nuk kanë kriju hapsnië që me pas ma shumë gra në jetën publike. Edhe sot, edhe pse janë ma t'mira, shiqo qeverinë, tri ma të suksesmet e ma të mirat janë gratë. Për mu, trijat jonë ma të mirat se ata burra që jonë aty. Jonë ma të sukseshme, ma të artikulume, e prezentojnë Kosovën në mënyrë ma dinjitoze, edhe jonë ma pak të korruptume (buzëqeshë). Kjo osht argument praktik që tregon, që këtë vend... kjo Kosovë ka me shku përpara, vetëm atëhere kur gratë kanë me marrë gjysmën e përgjegjësisë për këtë vend.

Gjatë gjithë jetës, në njëfarë mënyre, si çdo fëmijë tjetër gjatë gjithë jetës prindët e mi m'kanë influencu mjaft në vendimet e mia. Bile, edhe shumë vonë edhe kur e kom ni veten shumë të rritur gjithmonë kom bisedu me ta, edhe osht ni situatë shumë interesant kur bisedoj me prindët e mi. Nanën e kom shumë të butë, shumë e sofistikume, po shumë e butë, gjithmonë e mërrin qëllimin me atë butësi. Edhe, babin e kom ma të ashpër edhe i ka qëndrimet shumë ma të prehëta. Dhe meniher mas luftës, n'a obligoi të gjithave me u kthy. Nana njejtë me atë butësinë e saj; një qëndrim që, "Unë nuk kom shkollu fëmijë që me qëndru jashtë, tani që u shliku Kosova," kështu që të gjitha u kthym, përveç motrës së vogël. Edhe ish interesant se Aida, motra e tretë u kthy prej New York-ut edhe punojke, ajo edhe bashkëshorti i saj Pranvera motra e dytë u kthy prej Londrës, punojke ajo, punojke burri i saj si anestziolog, fëmijët shkojshin në shkollë. Shkëndija sa e kish kry sub-specializimin në kirurgji të lëkurës në Universitet të Graz-it edhe punojke atje.

Të gjitha u kthym në Kosovë. Dhe une kisha disa opsione. Një opsjon ishte që prapë të kthehena vetëm në mjekësi, të vazhdoj të jem mjekë, të hapi ordinancë private. Të vazhdoj t'a ristartoj Qendrën për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve, t'a zhvillojmë në Kosovë, ose të punoj diçka tjetër. Me qenë mjek, ishte për mu diçka që nuk i plotësojke ato nevojat. Kisha ide të ndryshme. Me vazhdu Qendrën, nuk kisha fuqi se aq shumë kisha dëgju me vjet dëshmi, edhe para apartheidit që nuk kisha mo... Edhe në situatë kur i dëgjojsa gratë, ose vizitojsim në terren, ma shumë qajsha une se anëtarët e familjes që i kishin njerëz të humbur. Po me nifar mënyre, une e lashë ni hapsinë që unë me vazhdu me punu. U zgjodha kryetare e bordit të organizatës që e kisha themelue në '92-shin, dhe e emënum ni gru tjetër që ka punu aty për drejtoreshë. Kështu që isha ende e involvume në diçka që e shihsha si një fëmi timin. Po, nuk mujsha me u marrë çdo ditë me atë dhimbje të luftës, nuk mujsha. Edhe pse në mënyrë paralele vazhdova me u marrë, po jo publikisht, me një grup përkrahës të vajzave të cilat ishin dhunu gjatë luftës. Po me respektu dinjitetin e tyre, se në ambientin tonë kurrë nuk osht diskutu haptaz për atë. Edhe gratë të cilat jonë dhunu, nuk kanë shprehë ni vullnet që me bisedu. Kemi qenë një grup që kemi punu vazhdimisht me to. Kemi qenë për to çdokur, në njëmbëdhjetë të natës me n'a thirrë, në njëmbëdhjetë kemi shku kudo në Kosovë.

Kështu që vazhdova paralel me punu aty dhe në fund vendimi me inkuadrimin e UNMIK-ut, administrimin e Kosovës u kriju. Ishte iniciativa që me u kriju një strukturë të cilën nga aspekti ligjor dhe nga aspekti publik u prezentu si një kuotë më kuotë, si një {bën thonjëzat me duar} edukim, trajnim i lokalëve kosovarëve në qeverisje, në bashkëpunim me komunitetin ndërkombëtar, derisa të bartet përgjegjësia në mënyrë graduale të kosovarëve. Kjo ishte arsyetimi publik. Arsyeya e vërtetë e krijimit të strukturës së përbashkët administrative në mes UNMIK-ut dhe kosovarëve ishte me neutralizu edhe me ç'bë tri qeveritë që ekzistojshin.

Ishte qeveria serbe që me celula të ndryshme edhe me funksionalitet, që ende është në Kosovë edhe 14 vjet mas luftës, qeveria në ekzil e udhëhequr nga Bujar Bukoshi dhe Ibrahim Rugova, dhe qeveria e përkohshme e udhëhequr nga Hashim Thaçi. Arsyeya e vërtetë për këtë ishte me i ç'bë këto trija, e jo bartja graduale e përgjegjësive. Po mirë, pranum që me qenë si e tillë sepse të gjitha këto struktura u inkuadrun nga ana kosovare në këtë strukturë të përbashkët administrative. Ishin... të gjitha partitë politike të atij kishin nga katër departamente, minoritarët, edhe ishte ni departament që ishte e përshkruar që të plotësohej prej një personi i cili nuk i përket asnjë prej këtyne grupacioneve, e ajo isha unë. Edhe e bashkëdrejtova departamentin për qeverisje demokratike e të drejtave të njeriut, e mediave të pavarura profesionale dhe përkrahje për shoqërinë civile. Ish si ni komponentë, si ni byro.

Fillum me ni bashkëdrejtues i cili ishte amerikan, i cili ishte *seconded*, [staf i caktuar nga qeveria] nuk e di shprehjen shqip qysh thuhet, nga OSBE-ja. Unë mund të flas vetëm për këtë departament. Unë besoj se për një vit e gjysë sa kom qëndru në departament, ne kemi bo një punë të madhe se mas pari kemi njoftu me disa principe të qeverisjes së mirë. Edhe departamentet tjera, edhe popullatën, I kemi zhvillu politikat e para në Kosovë për respekt të drejtave të njeriut dhe drejtave minoritare. Mandej, të drejtat e grave, të drejtat e fëmijëve. Domethonë, për secilin grupacion kemi zhvillu politika të cilat ma

vonë u zërtheheshin e u shëndroshin në rregullore. Kemi zhvillu një kohë mjaft të gjatë procedurat me të cilat si pjesë e qeverisjes së mirë me të cilat duhet të përgatitet kushtetuta e re.

Kemi punu edhe në ligje të ndryshme atëhere thirrshin rregullore, domethonë kishim disa obligime. Ne i zhvillojshim politikat, e në ligje merrshim pjesë me anë të ideve ose me anë të... Gjithmonë ligjet ose rregulloret para se me shku në instanca të tjera, kalojshin nëpër departament. Na jepshim komentet tona, në bazë të a jonë të përafuara edhe a i respektojnë të drejtat sipas konventave të ndryshme ndërkombëtare. Kështu që një vit e gjysë ka qenë shumë sfiduese për mu. Ka qenë një kohë mjaft e cila më ka plotësu me atë forcë teme, me atë dijeni teme që unë kom menu që duhna të kontriboj në atë kohë, në themelet e shtetësisë së Kosovës. Edhe pse edhe sot e di që shumë gjana që i kemi bo, vetë UNMIK-u nuk i ka zbatu. Për shembull, UNMIK-u kurrë rezolutën 1244 nuk e ka zbatu në krejt Kosovën. Veriu ka qenë jashtë asaj. Mu për atë se 1244 nuk osht zbatu, ne tash kemi probleme në veri të Kosovës. Sepse, edhe pse e ka marrë obligimin edhe NATO edhe forcat e KFOR-it, në t'vërtetë edhe UNMIK-u, ata kurrë nuk e kanë zbatu.

1244-shin e kanë zbatu vetëm popullata e Kosovës vetëm shqiptarët. Serbët nuk e kanë zbatu kurrë. Kështu që, edhe politikat që i kemi dizajnu, i kemi përgatitë në departament janë zbatu nga popullata shumicë, kur nga popullata pakicë. Që osht për keqardhje, sepse tretmani osht dashtë me u qenë për të gjithë, edhe për ni territor, se u qujke territor, i cili ka qenë një së paku në bazë të kushtetutës, në emër të të cilës ata kanë intervenu. Kështu të '74-tës t'u e marrë parasysh atë kushtetutë, Kosova si territor me ata kufijë, si territor osht administru nga UNMIK-u në bazë të rezolutës 1244. Prandaj, unë gjatë punës me UNMIK-un, edhe pse ka qenë mjaft plotësuese, edhe mjaft sfiduese në t'njëjtën kohë, ka qenë edhe mjaft dëshpruse.

Dëshpruse ka qenë sepse UNMIK-u si strukturë, për herë të parë ka vepru në Kosovë, Kombet e Bashkume nuk kanë zhvillu një intervenim të tillë ku e kanë administru një territor...kjo për herë të parë. Pasi që ka qenë për herë të parë, ka qenë shumë, mos t'thom shumë... t'a zbres pak, ka qenë mjaft e papërgatitur për me bë, edhe s'ka pas ekspertizë. E në t'njëjtën kohë ekspertizën e kosovarëve, nuk e kanë konsideri si të vlefshme.

Ka qenë ni qasje e t'shiqumit nga larg, edhe ka qenë ni mungesë absolute e ekspertizës. E kanë ardhë në emën të {bën thonjëzat me duar} dijenisë e ekspertizës, po në fakt ajo ekspertizë, nuk ka ekzistë. Prandaj, ndaj përgatitjes së ligjit bazik, kushtetutës së parë të Kosovës që e boni... ajo ishte jo-resepekt i vlerave dhe vullnetit të popullatës shumicë të Kosovës, e skajshme. Edhe, u aprovu ni ligj bazik në kushtetutë, i cili as në atë kohë nuk i plotësojke nevojat bazike për ni Kosovë ma demokratike. Kështu që kërkova me u largu prej departamentit, me të njejtin arsytim, "Nëse ju nuk do të bashkëpunoni me popullatë kosovare, e bini vendime të tilla, une nuk e shoh vlerën time me qenë aty, vetëm si figurë, e me nifar mënyre po e arsyejoj keq-qeverisjen e ju, prandaj nuk do të qëndroj. Iu shkruva ni letër edhe dola prej atyhit."

Edhe mas një muji kom shku në Universitet të Harvardit, në Fellowship një vjet në Kennedy School of Government, case study of Human Rights. Kom ligjëru për të drejtat e njeriut dhe drejtësinë tranzicionale, edhe kom bo hulumtime sidomos në adresimin e gjyqit dhe të drejtave të njeriut, dhe lami të cilat janë qendër të interesimit tim për shumë vjet. Kur u ktheva prej Harvard-it... në t'vërtetëtë sa isha në departamanet përgatitshim dokumentacione për zgjidhjet e para. T'u e përgatitë dokumentacionin, vëreja se shumë pak gra janë të inkuadrueme në atë proces. Unë isha në kapacitet se udhëheqësja një departament dhe departamenti kish edhe një obligim administrativ: ajo ishte regjistrimi i partive politike që dojshin të konkurrojshin për zgjedhjet e para. Kështu që, u njoftova me të gjitha partitë, edhe partitë e reja që u bënë edhe e shkruam një dokument më të cilën kërkojshim që kuota gjinore të jetë një {bën thonjëzat me duar} risi, në ligjin zgjedhor. M'është dashtë diku shtatete mujë me të gjithë liderët, kryesitë e partive politike, me të gjithë për me i pru deri në atë pikë ku ata janë bindë se kuota osht diçka e domsdoshme, kuota gjinore edhe pse thirret kuota e grave, ka qenë gjinore që gratë t'a kenë atë privilegj me u prezentu në jetë publike, në zgjedhje këtu.

Edhe pse në masë këtu e ka bo OSBE-ja... OSBE-ja, askush nuk e ka bo, e kanë bo gratë e Kosovës, e kemi mendu, mu veç m'ka rastisë me e udhëheqë atë departament ku kom pas obligim, kom qenë e mandatume me zhvillu politika të tilla, edhe e kom bo. Roli im ka qenë me negociu, me i bindë partitë politike, e munesh me paramendu pas luftime, pas ni luftë të gjatë, ku vlera numër një edhe për zgjedhje ishte, kush ka bajtë armë. Se ai që ka bajtë armë iu ka mbojtë jetën njerëzve, une e kuptoj atë, por si me pas bajtë armë kanë qenë edhe gratë se kanë bajtë armën e familjes, kanë bajtë armën e sigurisë së Kosovës, prandaj u realizu.

Normal që OSBE-ja ishte shumë instrumentale, se i organizoi zgjedhjet e para që kuota me u realizu, e praktikisht ishte një hapje e rrugës për zgjedhje të tjera e edhe kuota osht pjesë e sistemit gjedhor të Kosovës çka osht e mirë. Nuk osht e mirë se osht diskriminuse se osht 30 perqind, po për ni popullatë pas një traume të tillë si apartheid, lufta, në esencë popullatë rurale, patriarkale, 60 perqind e popullatës jeton në fshat, kuota ka qenë e domsdoshme.

Përndryshe, shiqoni rastin e vendeve përreth që nuk kanë pas kuota, nuk kanë as 7-8 përqind jo në parlament, po as në jetë publike. Kështu që, unë me nifar mënyre mburrna që e kom shty punën e kuotave e që e kom njoftu. Në fillim kur e kom përmen, kuota ka qenë një forum i quajtur "Forumi i partive politike." E kur e kom përmen dhe e kom shpjegu çka osht puna e kuotës për herë të parë, nuk e harroj kurrë atë shiqim, atë çudi, atë përçmim, edhe buzëgazin "Qe gratë tash po dojnë me u përzi edhe në këto punë." Edhe e di që disa ishin ma naivë edhe arrogantë edhe e thanë. Disa të tjerë, nuk e thanë por e menoishin, shih'sha prej shiqimit. Të tjerët bojshin pyetje të tilla që m'vyjke forcë me u përmbajtë. Ishte punë disa mujore për me e realizu këtë projekt, e në këtë projekt me të vërtetë kom pas mbështetje prej komunitetit ndërkombëtar.

Kur u ktheva prej Harvard-it, ke kriju parlamentin e parë pas zgjedhjeve të përgjithshme qenë aty. E sidomos për një popullatë që mendohet se ka qenë i çrregullum, i poshtërum, s'po di fjalë me gjetë, i mungum nga jashtë për një kohë shumë të gjatë, dhe për popullatën e Kosovës, fjala dinjitet edhe për ne grupin që punojshim në atë pjesë, ka qenë shumë me randësi. Po e jap veç një shembull, shembuj të tjerë ishin nenet. Po çka bonëm na, grupi jonë kishim çasje në... na nuk e zbulum ujin e nxehtë, po na kishim çasje në dokumentat e Lisbonit që u përgatitshin edhe ato ishin aprovu.

Ishte koha kur çdo shtet, parlamentet e shtetit e aprovojshin. Po ende pa dalë parlamenti, ne kishim lidhjet tona prej *network*-ut tonë të njerëzve që ishin pjesë e draftimit të Lisbona Court. Kështu që na dërgun atë pjesë, dhe ne e përpunum pjesën e të drejtave të njeriut nenet të cilat më së miri i përshtatën nevojave të Kosovës. E përdorëm mjaft fjalorin, gjuhën e cila e përshkojke Marrëveshjen e Lisbonit, dhe atë e dorëzom për kushtetutë të Kosovës. Po, edhe pjesën e diskutimit publik për të drejtat e njeriut Xhyljeta Jetishi edhe unë i zhvillum nëpër krejt Kosovën. I njoftojshim popullatën, po na nuk kishim gjana të tjera. Ilish qajo pjesa e të drejtave të njeriut, me shumë ma pak të drejta minoritare, sepse osht ni kapitull tjetër. Por, edhe kjo ishte ni eksperiencë, ni involvim, ni kontribut i imi jashtë institucioneve në zhvillimin e shtetit të Kosovës.

Tash po presim që me shku me një shtet i cili na ka ftu. Po unë tash e kom sitautën pak ma ndryshe për shkak se jom emnu ambasador i Republikës së Kosovës në Holandë, edhe nuk di sa kom me pas mundësi me vazhdu me bo edhe atë punë. Vjet kemi intervenu në Sudanin Jugor dhe në Sudan Khartoum. Kemi intervenu në Pakistan, po jo tu shku në Pakistan, po Pakistan- Afganistan konflikt kemi intervenu prej një vendi të tretë përreth, kështu që planifikohet sivjet të intervenohet... të shkojmë jo të intervenojmë në Indonezi, edhe të shqyrtojmë mundësitë e bisedave në Mindanao. Jonë disa projekte që jam pjesë e projekteve, po edhe nëse nuk veprojmë në formë aktive me shku në vend të konfliktit, atëhere iu ndihmoj me shkrime me mundësi të tjera që kom prej asaj pozitës. Osht diçka që mu m'intereson edhe të cilën e besoj. Kështu që nuk e kom lodhje, nuk e kom si brengë të madhe. Brengë e kom problemin, po nuk e kom brengë punën. Nuk e kom mundim të madh punën me bo për atë në Kosovë.

Por, na e shihshim që ato gratë të cilat i kemi zgjedhë me kuota nuk bojshin kurgjo, as nuk komunikojshin. Kështu që unë e zhvillova prej *network*-ut tem, i ftova në njëfarë mënyre, prezentova, thash, "Nuk po nihna mirë, me çka osht ka ndodhë." Edhe ni gru e madhe Swanee Hunt e cila na ka ndihmu shumë gjatë luftës, ka qenë ambasadore e Shteteve të Bashkume në Austri, ishte ligjëruese në Kennedy School of Government tha, "Hajde Vjosa, qe unë t'a bi një ekipë, pe bojmë një punëtori i marrim të gjitha gratë e parlamentit i ushtrojmë. Po bojmë një trejning të mirë tre-katër ditor edhe si rezultat po krijojmë Caucus-in e grave në parlament." Edhe ashtu u bo, erdhën këtu qëndrun një javë. Tri ditë kishim takim intensiv me gratë, po kishim edhe takime të tjera se na vyjke edhe një përkrahje e burrave në parlament, edhe lidereve të partive politike. Edhe u kriju Caucus-i i grave.

Njëkohësisht Ambasada Amerikane i ofroi një grant në emën të ish-sekretares së shtetit Madeleine Albright e cila e kishte kry mandatin. Edhe u kriju fondi për me i përkrahë Caucus-in dhe i ofroi 20 mijë

dollarë për vitin e parë. Aty ishin fillet e Caucus-it, mandej tash thirret “Grupi jo-formal i grave në parlament.” Edhe për mu vitet e para kanë qenë jo edhe aq të sukseshme. Qëllimi ka qenë që me i marrë çashtjet e grave të fokusohen dhe të adresohen në nivel të parlamentit. Edhe të ketë bashkëpunim në mes grave në baza gjinore, jo që dallimet partiake të iu pamundësojnë që të adresojnë çashtjet gjinore. Edhe, kështu që qito dy-tre vjetët e fundit, duhet me pranë që Grupi i Grave në parlament osht aktivizu ashtu si unë e kom pas vizionin kur unë e kom iniciu këtë punë. Në vitet e para puna ka qenë mjaft shkel e shko, mjaft konfliktuoze. Gratë prej PDK-së edhe LDK-së kanë qenë në një konflikt të tillë që ka qenë i paparamendueshëm. Mu personalisht, kurrë s’kom mujtë me kuptu pse ekzisotn një konflikt i tillë, kur baza ishte shumë e shnohtë se interesi ishte i përbashkët. Nuk ishte vetëm interes i grave edhe kishte mirë më qenë interes i parlamentit çashtjet të cilat u adresojshin.

Paramendone dje për herë të parë ministri i financave me pjesë të shoqërisë civile dhe me anëtarë të parlamentit, e ka adresu çashtjen e buxhetimit gjinor. Ne trejnimin e kemi bo me 2002-2003 për buxhetim gjinor, në 2005 prapë, 2007 edhe 2008, seri të trejnimeve për buxhetim gjinor për herë të parë në nivel administrator, dje me 9 apo 10 kur kemi qenë korrik 2013. Kështu që këto jonë vetëm do hapa që menoj që s’i kom veç unë, po edhe kanë bo edhe shumë gra në Kosovë e pak ma pak burra... që me trasu një rrugë që në këtë shoqni të dy gjinitë të kanë mundësi dhe shanca të barabarta për zhvillim.

Unë me të vërtetë besoj se pa qytetëri të barabartë nuk ka zhvillim demokratik, nuk ka një shoqëri edhe si shtet i pavarun gjithmonë, nëse një forcë çfarëdo ose në bazë gjinore ose në faza të tjera mbizotëron mbi forcat e tjera pamundëson pabarazinë, edhe njëkohësisht krijon atmosferë për konflikte. Kështu që për mu barazia gjinore dhe barazia e qytetarëve është një parakusht për paqe. Prandaj, edhe besoj në atë çka boj, se kështu duhet me vepru. Kështu që me këto episoda në njëfarë mënyre e absolvova atë vullnetin që të jetë pjesë e qeverive ose administratës në fillim, dhe t’a jep atë çka unë mendojsha që osht kontribut i jemi në shtet- formimin e Kosovës. Por edhe kur dola prej asaj strukture, asnjëhere nuk kom nejtë krejt jashtë. Në kapacitete të ndryshme jom inkuadru, në projekte të ndryshme. Për shembull, kom bashkë-drejt grupin punues kur e kemi përgatitë strategjinë për zhvillimin e Kosovës 2007- 2013 po nga pjesa e shoqnisë civile.

Përgatitjet... kur ka fillu me u draftu kushtetuta e pavarësisë, atëherë kom qenë ekspert i thirrun nga grupi prapë për shoqni civile, për me draftu pjesën e të drejtave të njeriut të kushtetutës së Kosovës. Bile kemi punu mjaft edhe preambullë edhe pjesa preambullës që kemi insistu, kemi qenë tre vetë që kemi punu. Ka qenë çashtja e inkorporimit të fjalës “dinjiteti” se gjithë debati ka qenë që dinjiteti nuk osht kategori kushtetuse, prandaj s’guxon me qenë aty. Argumentet tona ishin që kushtetuta nuk osht ligji *per se*, por osht baza për ligjet e ardhshme. Kështu që kategoritë si dinjiteti i cili mendohet që osht bazë, duhet me qenë aty.

Shumë pak kom interesim me qenë këto gjana publik për Kosovën. Më intereson, që nëse shkoj diku, sado pak me bo ni ndryshim, jo veç asaj po me pas ni qasje pak ma inklusive. Eksperienca në Kosovë, eksperienca jo aq shumë e imja po e shumicës së qytetarëve që ka qenë qasja pas intervenimit, ka

qenë mjaft *condescending* që thojnë anglisht, paternaliste. Për atë, çdo punë që e kom bo, konsulltant, Kolumbi me grupet vendase; në Republikën Dominikane, në Sudan, në Oman me qeverinë e Irakut; në Irak kur i kom ndihmu grave me zhvillu platformën nacionale të aksionit të grave. Në Indonezi kur kom ndihmu kriju qeverinë, me kriju lidhje me grupe civile për zgjidhjen e konfliktit t'u i respektu obligimet ndaj shtetit dhe të drejtat e shoqnisë civile, mandatet. Edhe në gjitha këto vende dhe shumë vende tjera kom mendu gjithmonë e kom pas qasjen që ma shumë unë e kom ndëgjju se çka dojnë njerëzit në ato vende ku kom shku. E shumë pak jom mundu me i imponu qëndrimin tem, mu për shkak të eksperiencës në Kosovë. Gjithmonë interesi i njerëzve ku t'shkojnë çkado që punon, duhet me qenë primar.

Edhe tash, nëse vazhdoj me qenë noshta jo në linjën e parë me *Resolution to Act*, po në prapavijë, prapë të njejtin qëndrim kom me pas, se osht bo pjesë e imja, pjesë e qëndrimit tem ndaj intervenimit. Dhe, si intervenimi duhet të jetë në vende ku ka nevojë na shkojmë atje si kanë ardhë në Kosovë se kemi pas nevojë. Nuk kemi pas nevojë me na sundu dikush, as nuk kemi pas nevojë me na tregu dikush çka me bo. Për ekspertizën që ka qenë, ka qenë nevoja që me qenë pro-aktiv në identifikimin e ekspertave dhe ekspertizës në Kosovë. E jo neglizhimi, ose injorimi i asaj ekspertize, osht bo një seleksionim jo adekuat në Kosovë. Ai seleksionim i ekspertizave në Kosovë vazhdon edhe me qeverinë tonë. Ti m'pyte, "A osht Kosova ashtu qysh...?"

Gjithmonë andrrat jonë ma t'bukura sesa realiteti dhe thash në pjesën e parë të *interviews*, kur u shpallë Kosova e pavaun kom mendu që edhe mos me ekzistu mo, e kom pas mjaft. Kom jetu me e pa, qato ka qenë e madhe. Muj me thonë çka unë kom prit. Unë kom prit, noshta pak naive, patetike... njerëzit që kanë vujtë kaq gjatë, kom prit që do t'a vlerësojnë ma shumë lirinë edhe pavarësinë. Njerëzit të cilët e kanë marrë votën e qytetarit, kom mendu që kanë me qenë ma të përgjegjshëm ndaj qytetarit dhe t'i realizojnë vullnetin e tyne. Unë kom besu që me popullatë të re Kosova relativisht e shkollume, me vullnetin edhe energjinë që ekziston, me resurset që ka Kosova, ka mjaft për ni territor për afër 11 mijë kilometra katror, që na kemi me u zhvillu ma shpejtë.

E njëkohësisht kemi me pas një qasje ma gjithëpërfshirëse edhe ma demokratike masi nuk ekziston një formë tjetër ma e mirë. Nuk osht perfekte, por nuk ekziston një formë tjetër ma e mirë për demokraci. Prandaj unë kom besu, kom pa andrra ma t'mdhaja edhe kom pas plane ma t'mdhaja. Thojnë, "n'dash me shti Zotin me keshë, tregoja andrrat e planet tuja." (Qeshë) Jo, nuk osht kjo çka kom prit, por unë prapë jom optimist që ne do të punojmë pak ma shumë, edhe me të vërtetë do ta dojmë këtë vend. Jo veç me thonë me fjalë që do ta dojmë, po me punë edhe kemi me qenë, une prapë besoj.... Na jemi popullatë e re, ka qenë shoku i pas luftës që na ka hutu, edhe kemi pas me të vërtetë një fat të keq. E kemi pas një lidhshirë me një vizion mjaft të limitum, e cila nuk e ka çu vullnetin e qytetarëve në vend në mënyrë të duhun. Ka dëshpërim, po unë jom optimist për Kosovën... për dy gjana: gratë kanë fillu me u faktorizu edhe me qenë ma publik. Dy: shqiptarët në përgjithësi janë faktorizu në Ballakan. Edhe fatmirësisht për herë të parë janë faktorizu për stabilizues

të situatës, jonë faktorizim për paqe. Kështu që kjo është ajo pjesë, e asaj andrrës time që është realizu. Ka pjesë të tjera që unë pres që do të realizohen. (Buzëqeshë)

Mimoza Paçuku: A e konsideron veten feministe?

Vjosa Dobruna: Po {pohon me kokë} unë e konsideroj veten feministe, por pa hy në definicionin e feminizmit. Mos me bo të vështirë si në seancë akademike, besoj që jom feministe, se së pari e ndjej veten mirë në lëkurë si femër dhe besoj se nuk ka kufizime në atë se çka unë du me bo si femër, nuk ka. Unë personalisht, nuk kom kufizime pse jom femër dhe kurrë nuk dyshoj se për shkak që jom femër, nuk kom të drejtë me bo diçka. Që mashkujt kanë të drejtë me bo gjithëçka, domethënë e ndjej veten mirë në lëkurë teme. Pres edhe prej grave të tjera me ndi veten mirë në lëkurë. Kjo është feminizmi! Edhe pres që nëse diçka i mohohet për atë se është femër me bo, atëhere duhet me luftu. Nuk duhet me prit prej të tjerëve, po vetë duhet me marrë punën në dorë. Në këtë kuptim, unë jom feminist. Unë nuk jom feminist në kuptim që besohet që feministet janë kundër mashkujve, unë nuk jom. Unë jom për barazi.

Edhe unë besoj që gratë, e sidomos feministet duhet me iu ndihmu mashkujve, burrave, se zhvillimi i grave është pjesë e zhvillimit të shoqërisë. Shoqëria nuk mund të zhillohet nëse vetëm një pjesë e shoqërisë zhillohet, po duhet të zhillohen edhe mashkujt. Mashkujt lindin edhe rriten prej grave prandaj nanat së pari, edhe shoqëria duhet me iu ndihmu. Mandej, edhe të tjerët duhet me iu ndihmu me i zhvillu. Kështu që, feminizmi im është liberal, është post-modern, nuk është feminizëm radikal i viteve '70-ta, '80-ta, bile edhe i viteve '90-ta. Unë besoj që në Kosovë ka mjaft feministe, gra feministe, ka edhe burra feministë. Unë besoj se ka hapsinë për me u zhvillu ma tepër. Edhe unë besoj se ekziston një lëvizje e grave, unë jom pjesë e asaj lëvizjeje, e cila është ma shumë e institucionalizime. Kur them institucionalizime nuk menj për se e institucionalizime si strukturë me anë të organizatave të ndryshme të grave, po edhe organizatave të tjera ose grupet e interesit në shoqëri civile të cilat prezantojnë të njëjtat interesa, ose promovojnë të njëjtat interesa. Ka lëvizje, nuk është perfekte. Pse nuk është perfekte? Se është pak ma e vështirë, në fazat në të cilat kemi kalu me pas prioritet barazinë.

Në seancën e kalime të *interview* iu tregova çka ka ndodhë në vitin '95 kur na promovojshim dhe avokojshim për të drejtat e grave kundër dhunës në familje, si reagun shoqëria jonë, partitë politike në atë kohë. Ka qenë situata edhe pas luftës, edhe tash. Gratë e kanë pas prioritet, gratë në përgjithësi po flas, me rifillu jetën me kriju diçka, e tek mandej me bo jetën publike e me qenë publik. Nuk kanë mendu në të njëjtën kohë se edhe prezenca e njëjtë publike i ndihmon me fillu jetën. Po, e kanë ni start ma të mirë. Të gjitha këto janë ato variacionet. Të gjitha gratë nuk janë të njëjta, të gjitha janë të ndryshme dhe kanë prioritete të ndryshme.

Prandaj në këtë e bazoj unë se lëvizja është shumë ma e madhe sesa që prezentohet. Çdo grup ose ni grup i interesit të grave e cila promovon një lami, ose një interes që e bjen atë grup me qenë në pozitë të barabartë, është ni organizatë edhe është ni grup feminist, edhe pse e thërrasin si të tillë ose jo.

Shumë femra, shumë gra në Kosovë hezitojnë me thirrë veten feminist se egziston një stigmë. E stigma osht se feministet janë kundër burrave. Po s'jonë feministet kundër burrave, jonë për vetëvete. Edhe jonë që gjininë e vetë, lëkurën e vetë e marrin si të natyrshme, edhe nuk dojnë me u bo burra. Prandaj kjo osht ai feminizmi të cilin unë e besoj që e ka edhe bazën teorike të cilën nuk e kisha elaboru këtu. Por osht pak ma e vështirë se në vende të tjera, por osht e mundshme, edhe mundesh me thonë [jom feministe]. Unë e thom publikisht sa herë të më vesin, dikush m'bon pyetje me ndonjë emision, po unë thom "po jom feminisit." E elaboroj ashtu si e elaborova, n'varet prej pyttes së gazetarit, por kryesisht kështu. Kryesisht me fjalë shumë të thjeshtë, une jom gru edhe e ni veten shumë mirë në lëkurë teme. Edhe luftoj që çdo gru me pas mundësitë e njejta, edhe me ndi veten mirë në lëkurën e vetë, ose në lëkurën e gjinisë së vetë. Kjo osht ai feminizmi im të cilin une e pranoj. Tjetër...

Mimoza Paçuku: Çka konsideron se janë arritjet ma të mëdha tuajat në jetë, deri tash?

Vjosa Dobruna: Nuk jom ende në moshë që muj me kqyrë mrapa edhe me vlersu, me shkru autobiografi ose me vlersu. Nuk kisha ditë çka me thonë, thjeshtë çka osht arritje. Po osht që thojnë, e natyrshme. Nuk e di. Unë jom njeri që jetoj për me punu, edhe jom njeri që s'e nij obligim por pjesë e imja pjesë e kulturës, pjesë e si m'ka rritë Hydajet me Musanë. Edhe Qazim Aga gjyshi jem, edhe axhat e mi, edhe me motrat e mija, jom pjesë e ni kulture ku osht e natyrshme me iu nihmu të tjerëve. Kështu që nuk e marr si obligim, e marr si pjesë time. Nuk e di a osht e arritun, a osht religjion, për mu osht edukatë që vjen natyrshëm. Nuk e di a osht e arritun, çka osht, kjo jam unë. Ndoshta mas disa vjete, kur duhna me plotësu formularë edhe me kqyrë, ndoshta do të shoh diçka që ka me m'pëlqy që e kom bo, e diçka me siguri s'ka me m'pëlqy, s'ka me qenë krejt. Po diçka që do ta boj gjithmonë osht... do ta artikuloj publikisht edhe privatisht atë çka e besoj dhe do të munohna me e realizu, mos ta përmeni fjalën do të luftoj. S'po gjej fjalor, fjalë ma adekuate, do të avokoj.

Mimoza Paçuku: Cilat janë andrrat e tua për të ardhmen?

Vjosa Dobruna: Thash, "Tregoja andrrat Zotit, shtine me keshë" (Qeshë). Kom qef me jetu çka shoh andërr, me jetu me një shoqni e cila ka një vizion edhe një shoqni ku njerëzit e nijnë veten mirë edhe të barabartë. Dhe nuk ka limitime personale ose grupore, përveç limitimeve të cilat jonë ligjore. Po normal me jetu me ni shtet, i cili i mundëson krejt këto. Atëherë kur e ke atë, secili individ ka mundësi me realizu andrrat e veta, nuk munesh me m'pytë mu se cila osht andrra jote. Andrra ime s'mundet me u realizu në një ambient në të cilin andrrat e shumicës nuk jonë të parashikume. Prandaj, s'di qysh me t'u përgjegjë në këtë pyetje. Vetëm nëse shoh andërr në një shtet të tillë, atëhere andrrat e secilit person mujnë me u realizu. (Buzëqeshë).